



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**  
**MBI**  
**“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË**  
**PËRPUTHSHMËRISË”**  
**NË BASHKINË HIMARË**

**Tiranë, janar 2022**

	<b>EMËRTIMI I KAPITUJVE</b>	<b>FAQE</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>4 – 11</b>
<b>1.</b>	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimití í í í í í í í í í í í í í í í í í	<b>4</b>
<b>2.</b>	Përshkrim I gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveí í í í í í í í í í í í í	<b>5 – 7</b>
<b>3.</b>	Konkluzion I përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimití í í í í í í í í í í í .	<b>7 – 9</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>10 – 13</b>
	a. <i>Objektivat e auditimit.....</i>	
	b. <i>Qëllimi i auditimit.....</i>	
	c. <i>Identifikim i çështjes.....</i>	
	d. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	f. <i>Kriteret e vlerësimit .....</i>	
	g. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	h. <i>Metodat e auditimi .....</i>	
	i. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....</b>	<b>13 – 156</b>
<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....</b>	<b>13 – 15</b>
<b>2.</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....</b>	<b>15 – 156</b>
2.1.	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditim e brendshëm.	17 ó 23
2.2.	Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	24 ó 36
2.3	Vlerësim i raportimit financiar	36 ó 112
2.4	Auditim mbi prokurimet publike	113 -135
2.5	Planifikimi i territorit	135 -156
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>157 – 169</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE.....</b>	<b>170 - 187</b>

## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>OE</b>	Operatori Ekonomik
<b>IMTV</b>	Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
<b>DAV</b>	Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Delvinë
<b>IMTV</b>	Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendorë

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim* KLSH), në periudhën nga data 01.06.2021 deri në 26.11.2021 realizojë auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike të subjektit Bashkia Himarë, sipas programit të auditimit nr. 594/1, datë 31.05.2021 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga data 01.10.2019 deri më 31.05.2021, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxheteve; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, etj.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 2020, mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimit me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 ÷pagaö; 401-408 ÷Furnitorë e llogari te lidhura me toö; 467 ÷Kreditore te ndryshëmö; 602 ÷Shpenzime operativeö dhe 230- 231 ÷Investimeö, si dhe me zgjedhje procedurat e prokurimit zbatimi i kontratave të ndërtimit.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, mungesë të të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore/administrative.

Me shkresën nr. 120/5, datë 17.01.2022 (*prot KLSH nr. 594/9, datë 20.01.2022*), nga subjekti Bashkia Himarë janë paraqitur vërejtjet e Projekt Raport Auditimit, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 3 drejttimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

## I.2. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Mungesa e një kuadër të plote rregullash dhe procedurash të shkruara për mirëfunksionimin e institucionit.	I lartë	Bashkia Himarë, të marrë masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollit të ndryshuar, për identifikimin e aktiviteteve me risk dhe menaxhimin e tij.
2	NJAB funksionon me numër të reduktuar punonjësish.	I lartë	NJAB, të marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi plotësimin e vendeve të NJAB, me minimumin 3 persona përfshirë drejtuesin e njësisë.
3	NJAB nuk ka kryer analizë dhe vlerësim të riskut në hartimin e planit vjetor si dhe për vitin 2019 mungon plani dhe raporti i auditimit.	I lartë	NJAB, gjatë realizimit të planit vjetor të auditimit të marrë parasysh analizimin dhe vlerësimin e riskut për përzgjedhjen e fushave të auditimit.
4	NJAB nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna.	I lartë	NJAB, të hartojë program të veçantë mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.
5	Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019, 2020 dhe 2021 programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve	I lartë	Bashkia Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.
6	Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019-31.08.2021, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.	I lartë	Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Himarë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime në vlerën 32,752,293 lekë, duke ndjekur radhën e pagesave dhe Drejtoria Financës të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët.
7	Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.	I lartë	Nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Bashkia Himarë, të marrin masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, dhe arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë për <b>59 persona</b> me vlerë <b>3,851,173 lekë</b>
8	Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit në mospërputhje me dispozitat ligjore	I lartë	Bashkia Himarë, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës <b>8,000,000 lekë</b> .
9	Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga të ardhurat nga	I lartë	Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës <b>5,375,850 lekë</b> ,

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Rekomandimi
	dhënia me qira e Aseteve për vendosjen e antenave të telefonisë celulare për periudhën objekt auditimi.		
10	Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa për vitet 2019, 2020 dhe 10/mujori 2021, mungesë të ardhurash për Bashkinë.	<b>I lartë</b>	Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën <b>287,712 mijë lekë</b>
11	Nxjerrja e pasqyrave financiare, shkeljet të parimeve kontabël për evidentimin e detyrimeve kreditore dhe mos rakordimi I llogarive të pasqyrave financiare me rezultatet e gjendjes fizike nga mos kryerja e inventarëve fizikë për vitin 2020.	<b>I lartë</b>	Bashkia Himarë, të marrë masa për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël, ku për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara si <i>oToka, troje, terreneo, oNdërtime konstruksioneo oRrugë rrjete vepra ujoreo</i> etj., të krijojë komisione me specialistët e nevojshëm për verifikimin në terren të këtyre Aseteve dhe për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemin e llogarive kontabël.
12	Bashkia Himarë ka lëshuar certifikatën e përdorimit për objektin oNjësi akomoduese, hoteleri dhe bujtina 2, 3, dhe 4 kate dhe 3 kate nëntokë, pishinë, në adresën Potam, Bashkia Himarë, me zhvillues oB.o sh.p.k		Të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues oB.o SHPK dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.
13	Bashkia Himarë ka lëshuar certifikatën e përdorimit miratuar me vendimin Nr. 70, Prot.1371/1, datë 16/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin oShtesë 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 katë, në adresën Livadh, Bashkia Himarë, me zhvillues E.K. dhe R.M.		Të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues <b>E.K. dhe R.M.</b> dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të vitit 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **oOpinion të kualifikuar**, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2020 ó 30.6.2020, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e

subjektit Bashkia Himarë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë jo të plotësuar, që janë baza për dhënien e një “Opinion të kualifikuar”, duke çuar në përdorimin pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet (3-E), të fondeve të prokuruar në vlerën 39,585 mijë lekë.

## **OPNIONI I AUDITIMIT**

### **I. Opinioni i pasqyrave financiare për vitin 2020.**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Himarë për periudhën ushtrimore 01.01.2020 ó 31.12.2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Si pas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kualifikuar për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Himarë duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020.

#### **Baza për opinionin:**

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë edhe faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të vitit 2020 dhe/ose në këtë periudhë nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, është përgjegjësi e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive. Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2020, i referohen faktit që disa llogari të detyrimeve kreditore dhe të drejtave mbi debitorët, nuk pasqyrojnë gjendjen reale në vlera materiale,-Ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre, ndërkohë që konstatohet se nga bashkia nuk është bërë inventarizim fizik i Aktiveve të Qëndrueshme për të saktësuar vlerat në pasqyrë.

-Për vitin 2020, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 ÷Kreditorë të ndryshëm, për 5 raste në vlerën 16,378,087 lekë.

-Për vitin 2020, llogaria 466 ÷Kreditorë për mjetet në ruajtje është raportuar më pak vlerën 178,152 lekë.

-Për vitin 2020, llogaria 468 ÷Debitorë të ndryshëm është raportuar më pak vlerën 112,415,990 lekë.

#### **II. Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë:**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë për periudhën në auditim 31.10.2019ó31.5.2021, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti ÷Bashkia Himarë, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan në përgjithësi zbatimi tyre, por në disa raste u konstatuan devijimeve nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret/vlerësim).

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Himarë rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e ÷Bazës për Opinionin të cilat janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

#### **Baza për dhënien e opinionit:**

Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit dhe materialitetin (2%), përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë

materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara. Ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e një **opinionit të kualifikuar**.

- Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të lartë, u konstatua se në 8 procedura me vlerë kontrate 231 milionë lekë, operatori i shpallur fitues nga KVO paraqet mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, si dhe për 19 procedurat u konstatuan mos argumentim i kriterëve të DST, veprime në mospërputhje me dispozitat e ligjit të Prokurimeve Publike (LPP) dhe akteve të dala në zbatim të tij.

- Në auditimin e procedurave me vlerë të lartë, u konstatua se në 51% e procedura të zhvilluara (55 gjithsej), janë realizuar me pjesëmarrjen të vetëm një operatori ekonomik.

- Janë zhvilluar procedura prokurimit, pa u konfirmuar më parë në Degën e Thesarit Himarë urdhër prokurimet, për garancinë e fondeve, dhe mos krijimin e vlerave të papaguara në përfundim të kontratave blerje mall/ shërbime/ investime.

- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, si dhe personat që kanë kontratë qiraje, nuk është ndjekur e plotë procedura për arkëtimin e debitorëve në vlerën **287,712 mijë lekë**.

- Në fushën e kontrollit dhe planifikimit të territorit, nga ku është konstatuar se në 3 raste është aplikuar gabim taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja në vlerën prej **9,915,388 lekë**.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë.**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Himarë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullative në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Himarë janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>1</sup>, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

<sup>1</sup> ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/ saj.



## I. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSHë, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 594/1, datë 31.05.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 01.06.2021 deri në datë 26.11.2021, në subjektin Bashkia Himarë, për periudhën nga 01.10.2019 deri në 31.05.2020, u krye auditimi i Mbi Auditimin financiar dhe përputhshmërië nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- 1.R.XH., *Përgjegjës Grupi*
- 2.P.GJ., *auditues*
- 3.E.K., *auditues*

### a-Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### b-Objektivat e auditimit synojnë:

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e **përputhshmërisë**, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

- Nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- Verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;
- Auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

### c-Identifikimi i çështjes:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Himarë janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin

për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

#### **d-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Himarë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

#### **e-Përgjegjësitë e Audituesve.**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Delvinë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

#### **f-Kriteret e vlerësimit.**

- Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit;
- Ligji organik i KLSH-së nr.154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Rregullore e Brendshme òMbi organizimin dhe funksionimit administrativ të KLSH-së, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme òMbi Procedurat e auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi òAuditimin e përputhshmërisë", Manuali e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes Vendore;
- Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 òPër buxhetin e vitit 2017, ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 òPër buxhetin e vitit 2018, ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 òPër buxhetin e vitit 2019, ligji nr.88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020, ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "Për buxhetin e vitit 2021 dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 òPër procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, òPër disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 òPër Prokurimin Publikë i ndryshuar; VKM nr.914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 òPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogël"; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.

#### **g-Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.

ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI 400 *“Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 *“Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”*; si dhe ISSAI 4200;

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;

Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; etj.

**gj- Metodatat e auditimit:** Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtuar skepticismit profesional nga ana e Audituesve.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

**I- Dokumentimi i auditimit:** Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit Përputhshmërisë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 *“Dokumentimi i Auditimit”*.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; *kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.*

### III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

#### - Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në Bashkinë Himarë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës por jo të përhapura si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e përdorimit të fondeve publike.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve. Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit mbi problemet e konstatuara ka mbajtur akt-konstatime për çdo problematik të konstatuar, kopjet e të cilave u dorëzuan në zyrën e protokollit Bashkia Himarë deri me datë 25.11.2021, datë e mbylljes së punës audituese në terren.

Nga subjekti Bashkia Himarë në momentin e përgatitjes së Projektraportit të Auditimit nuk u paraqitën kundërshtitë mbi problemet e konstatuara nga grupi i auditimit dhe të reflektuara në akt-konstatime. Subjekti i audituar Bashkia Himarë me shkresën nr.1984/35, datë 03.12.2021 të protokolluar në KLSH me nr. 594/7, datë 06.12.2021 bën me dije se observacionet do sillen në fazën e Projektraportit të Auditimit.

Nëpërmjet shkresës së Bashkisë Himarë nr. 120/5, datë 17.01.2022 (*prot KLSH nr. 594/9, datë 20.01.2022*), janë paraqitur kundërshtitë e Projekt Raport Auditimi, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion mbështetës. Ndërsa për mangësitë e tjera të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjore gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimit, i cili përcillet subjekti për marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

Bashkia Himarë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *oPër Vetëqeverisjen Vendoreë* dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *oPër financat e vetëqeverisjes Vendoreë*, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Himarë.

1.Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik: Bashkia Himarë bën pjesë në Qarkun e Vlorës. Zona Gjeografike: Bashkia e re e Himarë kufizohet në veri me bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në lindje me bashkitë Tepelenë, Gjirokastër dhe Delvinë, në jug me bashkinë Sarandë dhe në lindje me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është Himara.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Himara ka 7818 banorë, ndërsa sipas Regjistrisë Civil kjo bashki numëron 27049 banorë. Me sipërfaqe prej 571.94 km<sup>2</sup>, densiteti i popullsisë në bazë të censurit rezulton vetëm 13.7 banorë/ km<sup>2</sup> ndërsa sipas regjistrisë civil, densiteti është 47 banorë/ km<sup>2</sup>.

Njësitë administrative përbërëse janë: Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht. Himara dhe Horë-Vranishti i përkasin rrethit Vlorë ndërsa Lukova i përket rrethit Sarandë. Bashkia e re do të ketë nën administrim një qytet dhe 24 fshatra.



**Profili i bashkisë.** Himara është një bashki që shtrihet përgjatë të gjithë bregut të Jonit si dhe në malet e Labërisë në pjesën e ish-komunës Horë-Vranisht. Ajo është një bashki e pasur me burime ekonomike me përqendrim te turizmi, peshkimi, blegtoria e ullishte, të gjitha produkte dhe shërbime me vlerë të lartë të shtuar. Por pavarësisht kësaj, kjo bashki është bashkia e dytë me densitetin më të ulët të popullsisë në Shqipëri pas Dropullit si pasojë e largimit të pjesës dërrmuese të banorëve për në Greqi ose në qendrat e mëdha urbane në vend.

Bashkia e re ndahet në dy territore shumë të ndryshme: zona bregdetare si dhe zona e ish-komunës Horë-Vranisht, një zonë e thyer malore. Bashkia e Himarës përveç burimeve të mëdha të turizmit detar disponon resurse të mëdha edhe në turizmin kulturor apo të natyrës.

Bashkia e re ka mundësi të konsiderueshme ekonomike dhe në përgjithësi infrastrukturë të zhvilluar në drejtim të rrugëve dhe ujit të pijshëm ndërsa bregdeti i saj konsiderohet nga më të pastrit në vend për shkak të distancës së banesave nga bregu i detit.

Ndërkohë, resurset bujqësore dhe blegtorale të zonës janë shumë pak të shfrytëzuara për shkak të largimit masiv të popullsisë apo tërheqjes së popullsisë së mbetur në aktivitete me më shumë të ardhura si turizmi.

Në mbarë krahinën e Himarës mbisundon klima Mesdhetare. Nga verilindja vargu i Karaburunit dhe i Çikës (malet Akrokeravne) e mbrojnë atë nga murrllani dimëror. Me këtë pozicion klimaterik krahina e Himarës, ne tërësi me toka te pakta bujqësore, ka kultivuar kurdoherë, përveç blegtorisë, dy kulturat kryesore mesdhetare: ullinjtë dhe agrumet, pa përjashtuar vreshtat. Pozicioni gjeografik i ka detyruar banoret e krahinës të lidhen nga pikëpamja ekonomike jo vetëm me token, por edhe me detin o me detin jo aq me peshkimin se sa me lundrimin.

Himara ndodhet ne faqen e vargmalit te Çikës dhe peizazhi i saj karakterizohet nga kurrizi ujëndarës dhe erozioni i kreshtës.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në Bashkinë Himarë është gjithsej 5920 ha, nga e cila sipërfaqe tokë arë 1315 ha, pemëtoje 1200.1 ha, vreshtari 149.6 ha dhe ullishte 2910.6.

Ndarja e tokës sipas ligjit nr. 7501, duhet të merrnin tokë bujqësore 5627 familje për sipërfaqen 5920 ha, por aktualisht sipas të dhënave të Bashkia Himarë janë ndarë 4390 ha për 4812 familje, dhe pjesa tjetër është shtet por që nuk është ajkoma e regjistruar në ASHK në pronësi të Bashkisë Himarë.

Megjithëse këto sipërfaqe janë kaluar me VKM në pronësi të Bashkisë Himarë, nga strukturat përgjegjëse nuk është bërë asnjë veprim për regjistrimin e tyre në ASHK, kjo për mungesë fondesh.

#### **Parimet e auditimit financiar:**

Në punën tonë jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

#### **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:**

*Përkatesia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

*Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

*Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

*Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

*Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

*Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

### **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

*Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

*Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

*Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

*Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumatat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

### **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.**

*Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

*Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

*Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

*Saktësia dhe vlerësimi:* Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

**Objekti i këtij auditimi,** është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitin 2020. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit në procedurat e prokurimit.

**Qëllimi i auditimit,** është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)<sup>2</sup>.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

**Fushëveprimi i këtij auditimi,** përfshin të gjithë aktivitetin e Bashkisë Himarë. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Himarë.

**Misioni,** për njësinë që auditohet është kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme

---

<sup>2</sup>Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

**Objektivat**, burojnë nga ligji òPër vetëqeverisjen vendore.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni* ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

## **1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditim e brendshëm.**

Testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Vlerësimi si janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nëpërmjet veprimtarive efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollit, grupi i auditimit testoi disa nga komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm:

**a. Mjedisi i kontrollit.** Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

*Vendosja e objektivave.*

Menaxhimi me filozofinë dhe qasjen e tij ndaj punës tregon dhe promovon kompetencë, angazhim personal në realizimin e objektivave të institucionit duke inkurajuar edhe punonjësit që të respektojnë kontrollet ekzistuese. Mbështetur në ligjin nr. 139/2015, òPër vetëqeverisjes vendore, vendimin e Këshillit të Bashkisë Himare nr.111, datë 31.12.2020 òPër miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Himare, Ligjit Nr.152/2013 òPër nëpunësit civilë, Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, me ndryshime, Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003 òPër rregullat e etikës në administratën publike, Ligjin Nr.9154, datë 06.11.2003 òPër arkivat, Ligjin Nr. 119/2014 òPër të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, Ligjin Nr.8517, datë 22.07.1999 òPër mbrojtjen e të dhënave personale, me ndryshime; Ligji Nr.10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", i azhurnuar me Ligjin Nr. 22/2013, Ligji nr. 110/2013, datë 01.04.2013, Ligjit Nr.7674, datë 23.02.1993 òPër shërbimin dhe Inspektoriatin veteriner, i azhurnuar, Ligjit Nr.8756, datë 26.03.2001 òPër emergjencat civile; Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin e ndërtimit, VKM Nr.511, datë 24.10.2002 òPër kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore, VKM

Nr.390, datë 06.08.1993 òPër rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare është miratuar rregullorja me urdhrin ekzekutiv të Kryetarit Nr.507 datë 20.02.2020 òRregullore e përgjithshme dhe struktura e Administratës së Bashkisë Himarë". Në rregullore janë përcaktuar objektivat e përgjithshme, organizimi i punës struktura dhe funksionet përkatëse.

*Etika personale dhe profesionale.*

Nëpunësit e njësisë duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 òPër rregullat e etikës në administratën publikeò, rregulla të cila janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë dhe gjithashtu është përcaktuar procedura për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

*Struktura organizative.*

Bashkia për viti 2019 institucioni ka funksionuar në bazën e strukturës organizative me urdhër të titullarit të institucionit nr. .98 datë 30.08.2019.

Për vitin 2020, institucioni ka funksionuar në bazën e strukturës organizative me urdhër të titullarit të institucionit nr. .45 datë 02.03.2020.

Për vitin 2021, institucioni ka funksionuar në bazën e strukturës organizative me urdhër të titullarit të institucionit nr. .111 datë 31.12.2020.

Struktura e Bashkisë është e përshtatshme për të arritur objektivat e saj. Është e mirë përcaktuar ndarja e punës dhe e përgjegjësiave. Struktura mbulon të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë dhe bën të mundur qarkullimin e informacionit. Koordinimi dhe bashkëpunimi i drejtorive bëjnë që të jetë strukturë e decentralizuar duke respektuar shkallën hierarkike. Secili sektor, drejtori ka të përcaktuara qartë detyrat dhe përgjegjësitë e saj dhe të nëpunësve në përbërje të tyre, të mirpërcaktuara në përshkrimet e punës, sipas kërkesave të përcaktuara në Vendimin e KM nr. 142, datë 12.03.2014 òPër përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavaruraò dhe Udhëzim nr.2, datë 07.04.2014 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

*Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.*

Punonjësit e njësisë i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe Kodit të Punës. Në bazë ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor, ligjit për prokurimin publik, ligjit për kontabilitetin, ligjit për statusin e nëpunësit civil, si dhe të dispozitave ligjore të kodit të punës etj., Titullari i njësisë, në rast të shkeljes së normave ligjore apo, të rregullave ka të drejtë të ndër marrë hapat e duhura, duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit, deri në largim nga puna. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se, punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga, drejtuesit dhe ajo është e përshtatshme për realizimin e objektivave të caktuara.

*Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.*

Në rregulloren e brendshme të institucionit, njësia ka miratuar përshkrimin e punës për çdo pozicion pune në institucion ku përfshihen detyrat që duhen kryer nga çdo strukturë dhe për çdo vit është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Trajnimet janë kryer në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të **Administratës Publike** (ASPA).

**b. Menaxhimi i riskut.** Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Pas planifikimit të fondeve buxhetore institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve hap pas hapi të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore dhe ka hartuar regjistrat e risqeve për drejtoritë dhe në bazë të nenit 21, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 òMenaxhimi i riskutò, njësia ka



hartuar strategjinë e riskut. Gjithashtu është hartuar dhe òPlani i veprimit për Menaxhimin financiar dhe Kontrollinò.

**c. Aktivitetet e kontrollit.** Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave dhe të misionit të saj. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave. Nëpunësi autorizues në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë. Nga momenti i krijimit të sektorit të auditit janë kontrolluar:

**Në vitin 2019,** nuk është parashikuar asnjë auditim.

**Për vitin 2020** janë parashikuar gjithsej 4 auditime por me shkresën nr. 2425 prot., datë 30.07.2020 drejtuar Ministrisë së Financave dërgohen ndryshimet e planit ku do të përfshihen 8 Auditime Tematike mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku janë realizuar 5 Auditime

1. Drejtoria e shërbimeve
2. Drejtoria e Financës
3. Drejtoria e Policisë
4. Drejtoria Juridike
5. Drejtoria e të Ardhurave

**Për vitin 2021** janë parashikuar në planin vjetor 3 auditim të cilat janë në proces auditimi.

1. Sektori i PMNZSH
2. Drejtoria e Financës
3. PMNZSH

**d. Informim komunikimi.** Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësi. Menaxherët e njësisë zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin ka funksionuar në njësi dhe në strukturat vartëse. Titullari dhe nëpunësi autorizues informohen nga drejtuesit e programeve me anë të mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Drejtoria e Financës, raporton tek nëpunësi autorizues me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin, raporteve të monitorimit çdo 3-muaj. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet e mundshme. Për realizimin e objektivave institucionale dhe për të plotësuar nevojat e domosdoshme të punonjësve, është specialisti i IT-së, brenda Drejtorisë së Burimeve Njerëzore i cili ofron informacion të nevojshëm për realizimin e detyrave. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, postë elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme pa përfshirë komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

**e. Monitorimi.** Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të afrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Titullari informohet vazhdimisht nga drejtorët mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve, informacioneve apo, raporteve të ndryshme. Drejtuesit nën mbikëqyrjen e Titullarit, raportojnë realizimin e çdo objektivi në përgjegjësinë e gjithsecilit. Krahas arritjeve analizohen dhe shkaqet e mosrealizimeve. Bashkia në përbërje të strukturës ka dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm i cili është miratuar në Strukturën e Bashkisë në vitin 2019. Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, garanton objektivitetin dhe pavarësinë e Drejtorisë të Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Himare. Në bazë të ligjit Drejtoria e Auditit të Brendshëm varet dhe raporton direkt tek titullari i njësisë.

Procesi i monitorimit më shumë konsiston në realizimin e menaxhimit financiar. Drejtoria e Auditimit të brendshëm për vitin 2020 dhe 2021, ka kryer auditime mbi bazë sistemi, kryesisht për sistemin e proceseve organizative, sistemin e programimit, sistemin e pagesave, sistemin e prokurimeve, sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, si dhe sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të njësisë dhe sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, sipas kërkesave të ligjit dhe manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**1. Titulli i gjetjes:** Mungesa e një kuadër të plote rregullash dhe procedurash të shkruara për mirëfunksionimin e institucionit.

**Situata:** Sistemi aktual i komunikimit të institucionit nuk është eficient. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave

**Kriteri:** Pika 15, germa b, të UMF nr.28, datë 15.12.2011 òMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publikeò.

**Ndikimi/efekti:** Mos identifikimi dhe menaxhimi i gabimeve/ankesave, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për zhvillimin e sistemit të komunikimit, ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit.

**Shkaku:** Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollitò i ndryshuar, për identifikimin e aktiviteteve me risk dhe menaxhimin e tij.

Të analizohen shkaqet e mos funksionimit të sistemit të komunikimit, të nxirren përgjegjësitë më qëllim që të kryejë funksionet e veta.

Bashkia Himarë, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të hartohet procedurë e veçantë mbi mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve/ankesave dhe kryerjen e analizimit i tyre në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò dhe UMF Plotësues nr. 28 datë 15.12.2011 òMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publikeò

### **Mbulimi me auditim i aktivitetit të Bashkisë. Rezultatet dhe efienca e strukturave të ngritura për realizimin e Auditit të Brendshëm.**

Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Himarë është e organizuar si Njësi e Auditimit të Brendshëm si pjesë përbërëse e Strukturës Organizative të Bashkisë.

**Për vitin 2019,** deri më datë 01.03.2019 Njësia e Auditimit të Brendshëm ka funksionuar vetëm me një drejtues zj. M. B e cila me anë të urdhrit nr. 35 datë 01.03.2019 kalon me detyrë në Këshilltare e Kryetarit të Bashkisë. Nga kjo datë e deri më 10.09.2019 Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk ka funksionuar pasi në përbërje të saj nuk ka pasur asnjë punonjës, ku më 10.09.2019 me anë të urdhrit nr.111 datë 10.09.2019 bëhet transferimi i punonjësës znj.Suzana Demaj si specialiste e Auditit të Brendshëm.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual	Arsimimi	Certifikimi si AB, (viti i certifikimit)
1	M.B.	Drejtuese	Ek. Agrare Plan	2008
2	S.D.	Specialiste	Adm. Biznesi	2019

**Për vitin 2020**, Njësia e Auditimit të Brendshëm vazhdon të mbetet me një specialist deri në muajin korrik. Në muajin korrik bëhet emërimi i znj. Mimoza Breçani si drejtuese e njësisë në fjalë.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual	Arsimimi	Certifikimi si AB, (viti i certifikimit)
1	M.B.	Drejtuese	Ek. Agrare Plan	2008
2	S.D.	Specialiste	Adm. Biznesi	2019

**Për vitin 2021**, struktura e Njësies së Auditimit të Brendshëm vazhdon të mbetet vetëm me një punonjës, znj. M. B. në pozicionin Drejtuese e njësisë.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni Aktual	Arsimimi	Certifikimi si AB, (viti i certifikimit)
1	M.B.	Drejtuese	Ek. Agrare Plan	2008

Nga të dhënat si më sipër rezulton se Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitet 2019, 2020, 2021, ka funksionuar me burime njerëzore të kufizuara, maksimalisht 2 e cila është në pajtueshmëri me pikën 3 të VKM nr.83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar.

*-Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor, analiza sipas llojeve dhe gjetjeve.*

Në zbatim të nenit 14, pika b, të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 për Auditimin e brendshëm në Sektorin publik dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministria e financave, me shkresën nr. 100, datë 25.10.2016, Bashkia Himarë:

Për vitin 2019 nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB), **planin Strategjik** dhe atë **vjetor**.

Për vitin 2020 nuk ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB), **planin Strategjik** dhe atë **vjetor**.

Për vitin 2021 ka dërguar në Ministrinë e Financave, në Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (NJQHAB), **planin Strategjik 2021-2023** dhe atë **vjetor** për vitin 2021 me shkresë nr.3351/2, datë 19.10.2020.

**Për vitin 2020** janë parashikuar gjithsej 4 auditime por me shkresën nr. 2425 prot., datë 30.07.2020 drejtuar Ministrisë së Financave dërgohen ndryshimet e planit ku do të përfshihen 8 Auditime Tematike mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku janë realizuar 5 Auditime si më poshtë:

Nr	Subjektet	Niveli vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objektet të pa audituara mbi 2-vjet	Realizimi
1	Drejtoria e shërbimeve	ska	Tematik	jo	Po
2	Drejtoria e Financës	ska	Tematik	jo	Po
3	Drejtoria e Policisë	ska	Tematik	jo	Po
4	Drejtoria Juridike	ska	Tematik	jo	Po
5	Drejtoria e të ardhurave	ska	Tematik	jo	Po

**Për vitin 2021** janë parashikuar në planin vjetor 3 auditim të cilat janë në proces auditimi.

Nr	Subjektet	Niveli vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Objektet të pa audituara mbi 2-vjet	Realizimi
1	Spektori i PMZSH	ska	Përputhshmëri	jo	proces
2	Drejtoria e Financës	ska	Përputhshmëri	jo	proces
3	PMZSH	ska	Përputhshmëri	jo	proces

Nga auditimi në lidhje me raportimin e NJAB, rezulton se:

Për vitin 2019 nuk është hartuar dhe dërguar në NJQHAB e Ministrisë së Financave, raporti periodik dhe vjetor të shoqëruar këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e Auditit të Brendshëm, në kundërshtim me ligjin nr. 114, datë 22.10.2015, ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri i Financave, me Urdhër nr. 100, datë 25.10.2016, ÷Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm, ndërsa për vitin 2020 janë dërguar me shkresën nr. 226/1 prot., datë 14.02.2021.

Për periudhën objekt auditimi, për auditimet e kryera rezulton se janë rekomanduar masa sipas sektorëve si më poshtë:

**Për vitin 2019**, nuk ka raport auditimi.

**Për vitin 2020**, janë rekomanduar gjithsej 39 masa nga këto:

-Masa Organizative 39 (tridhjetë e nëntë) për subjektet si më poshtë:

- Në subjektin Drejtoria e Shërbimeve, 4 masa;
- Në subjektin Drejtoria e të ardhurave, 18 masa;
- Në subjektin Drejtoria e Financë Buxhetit, 17 masa;

**Për vitin 2021**, janë akoma në proces auditimi.

-Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga NjAB Bashkia Himarë për gjetjet si më sipër dhe rekomandimet e lëna për masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masa disiplinore, u realizuan 5 auditime për verifikim e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në Drejtorinë e Shërbimeve, Drejtorinë e të Ardhurave, Drejtorinë e Financë Buxhetit, Policinë Bashkiake, Drejtoria Juridike. Konkretisht paraqitet situata si më poshtë:

Nr	Subjekti audituar	I	Rekom. /nr. KLSH	Rekom. /nr. AB, Bashkia Himarë	Pranuar	Zbatuar	Process zbatimi	Pa zbatuar
1	Drejtoria e Shërbimeve		4	4	4	4	1	
			4		4	3		
2	Drejtoria e të ardhurave		18	18	18	9	7	2
			41		41	-	28	13
3	Drejtoria e Financës		17	17	17			17
			16		16			
4	Policia bashkiake							
			5		5		1	4
5	Zyra Juridike							
			5		5		5	
	<b>Totali</b>		<b>71</b>	<b>39</b>	<b>110</b>	<b>15</b>	<b>42</b>	<b>36</b>

*Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.*

Nga auditimi rezulton se në shumicën e rasteve nuk janë respektuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB) miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, dt.25.10.2016 ÷Per miratimin e Manualit të Auditimit të brendshëm në sektorin publik.

**2. Titulli i gjetjes:** NJAB funksionon me numër të reduktuar punonjësish.

**Situata:** NJAB funksionon duke pasur në përbërje të njësisë maksimumi dy punonjës dhe jo minimumi 3 persona duke përfshirë dhe drejtuesin e njësisë.

**Kriteri:** Pika 3 e VKM nr.83, datë 03.02.2016 ÷Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e burimeve njerëzore çon në mos realizimin e planit vjetor të auditimit dhe në mos realizimin e objektivave të institucionit.

**Shkaku:** Mosnjohje e plotë e koncepteve VKM nr.83, datë 03.02.2016 për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** NJAB, të marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi plotësimin e vendeve të NJAB, me minimumin 3 persona përfshirë drejtuesin e njësisë.

**3. Titulli i gjetjes:** NJAB nuk ka kryer analizë dhe vlerësim të riskut në hartimin e planit vjetor si dhe për vitin 2019 mungon plani dhe raporti i auditimit.

**Situata:** Për periudhën objekt auditimi nuk kemi plan auditimi dhe raport për vitin 2019, plani i auditimeve për vitin 2020 nuk është realizuar në masën 100% (për vitin 2020 janë parashikuar gjithsej 8 auditime dhe janë realizuar 5 auditime, ose në masën 62.5 %), ndërsa për vitin 2021 janë parashikuar në planin vjetor 3 auditime dhe akoma janë në proces auditimi. Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Himarë nuk ka kryer një analizë dhe vlerësim të riskut në hartimin e planit vjetor dhe atë strategjik të auditimit si dhe gjatë realizimit të auditimit nuk ka kryer etapat dhe procedurat e auditimit.

**Kriteri:** Ligji nr.114/2015 datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB) miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave me nr. 100, dt.25.10 2016 për miratimin e Manualit të Auditimit të brendshëm në sektorin publik.

**Ndikimi/efekti:** Mungesa e analizimit dhe vlerësimit të riskut çon në zgjedhje të gabuar të fushave të auditimit si dhe në mos përmbushje të objektivave të auditimit.

**Shkaku:** Mosnjohje e plotë e Ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** NJAB, gjatë realizimit të planit vjetor të auditimit të marrë parasysh analizimin dhe vlerësimin e riskut për përzgjedhjen e fushave të auditimit.

**4. Titulli i gjetjes:** NJAB nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

**Situata:** Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Himarë, nuk ka një vlerësim të riskut, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit.

**Kriteri:** Neni 6 rregullorja e auditimit të brendshëm germa oio dhe oço, të ligjit nr. 114 date 22.10.2015 për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik të Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar nga Ministri i financave me Urdhër nr.100, datë 25.10.2016 për miratimin e Manualit të Auditimit të brendshëm.

**Ndikimi/efekti:** NJAB nuk e realizon plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

**Shkaku:** Mosnjohje e plotë e Ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** NJAB, të hartojë program të veçantë mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

## **2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit**

*-Programimi i PBA 2019-2021*

Nga Bashkia Himarë, janë miratuar treguesit e buxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën e viteve 2019-2021.

PBA, është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 212 datë 21.12.2019 dhe me shkresën nr. 1757, datë 01.06. 2018 i është përcjellë Ministrisë Financave drejtoria e

Financave të pushtetit vendorë. Treguesit e miratuar të PBA sipas llojeve të projekteve, janë sipas pasqyrës **Aneks nr. 1**, bashkëngjitur.

Në programimin e buxheteve afat mesëm (PBA) për periudhat 2019-2021, konstatohet se përgjithësisht janë zbatuar procedurat ligjore, treguesit e buxhetit afat mesëm. Konkretisht, janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, me VKB nr. 175 datë 31.5.2018 protokolluar me Nr. 1807 datë 5.06.2018.

a) Kalendarit i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor është miratuar brenda datës 31 Dhjetor të vitit paraardhës, në zbatim të kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreë me VKB nr. 213, datë 21.12.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2597/1, datë 04.01.2019.

b) Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm janë miratuar brenda datës 20 Korrik (të vitit paraardhës), në zbatim të kërkesave të nenit 37 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreë.

c) Janë miratuar Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve, kërkesë në zbatim të kërkesave të nenit 34 të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreë. Me shkresën nr. 1757 prot., datë 01.06.2018 i është dërguar Ministrisë së Financave tabelat e plotësuara dhe relacioni shpjegues për PBA 2019-2021.

**5. Titulli i gjetjes:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019, 2020 dhe 2021 programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

**Situata:** Për vitin 2019 buxheti është miratuar me VKB nr. 212 datë 24.12.2018.

Për vitin 2020 buxheti është miratuar me VKB nr.30, datë 20.12.2019.

Për vitin 2021 buxheti është miratuar me VKB nr.66, datë.21.12.2020.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Himarë për vitin 2019, 2020 dhe 2021 paraqiten sipas pasqyrës **Aneks nr. 2**, bashkëngjitur.

Nga të dhënat rezulton se nga totali i të ardhurave që do mbulojnë shpenzimet e buxhetit për vitin 2019, të ardhurat e veta zënë 44% ose në vlerën 274,164 mijë lekë ndërsa 56% janë grante specifike dhe grante konkurruese ose në vlerën 346,701 mijë lekë.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, nuk janë programuar si zë më vehte, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2018, janë në shumën totale 42,438,210 lekë nga të cilat:

37,428,574 lekë, llogaritë 401-408 - *Furnitorë e llogari të lidhura me to*,

5,009,636 lekë, llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm*.

Për vitin 2020, të ardhurat e veta zënë 43% ose në vlerën 265,825 mijë lekë ndërsa 57% janë grante specifike dhe grante konkurruese ose në vlerën 354,535 mijë lekë.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2020, nuk janë programuar si zë më vehte, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2019, janë në shumën totale 9,050,344 lekë nga të cilat:

9,050,344 lekë, llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm*.

Për vitin 2021, të ardhurat e veta zënë 78% ose në vlerën 669,196 mijë lekë ndërsa 22% janë grante specifike dhe grante konkurruese ose në vlerën 190,972 mijë lekë.

Në buxhetin e miratuar për vitin 2021, nuk janë programuar si zë më vehte, likuidimi i të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguara nga viti paraardhës që sipas pasqyrave financiare për vitin 2020, janë në shumën totale 75,170,102 lekë nga të cilat:

75,170,102 lekë, llogaria 467- *Kreditorë të ndryshëm*,

Sa më sipër konstatohet se nuk janë programuar si zë më vehte në buxhetet 2019,2020 dhe i detyrimeve të vitit paraardhës, veprim në **kundërshitim** me kërkesat e nenit 101 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat Standard të zbatimit të buxhetit".

Krahasuar plani i buxhetit me planin e PBA, për vitet 2019, 2020 dhe 2021 paraqitet sipas pasqyrës **Aneks nr. 3**, bashkëngjitur.

Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Për të gjithë periudhën e audituar, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

**Për vitin 2019** buxheti fillestar është për **vlerën 620,865 mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për **vlerën 628,055 mijë lekë** me rritje për **vlerën 7,190 mijë lekë**,

Gjatë vitit, buxhetit të miratuar në fillim të vitit, i janë bërë ndryshime të miratuara me vendime të Këshillit të Bashkisë, të cilat janë si vijon:

-Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 03 datë 22.02.2019 dhe i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. 341/1 datë 07.03.2019, ku shtesat janë 4,310,695 lekë si të ardhura të trashëguara nga viti 2018.

-Vendimi nr. 4, datë 22.2.2019 për miratim pjesëmarrje në projektin "Reviving Authenticity and Preserving Heritage through Technological Solutions in Himara and Lefkada me Acronim APHeTeSö.

-Vendimi nr. 17 datë 6.5.2019 Për miratimin e 12 punonjësve sezonal në Bashkinë Himarë periudha Maj Shtator 2019.

-VKB nr. 9, datë 20.09.2019 dhe VKB nr.10, datë 20.9.2019 të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 1415/1, datë 17.10.2019, janë bërë ndryshime brendapërbrenda buxhetit fillestar duke kaluar fonde nga një nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli në një tjetër.

**Për vitin 2020** buxheti fillestar është për **vlerën 620,360 mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për **vlerën 727,105 mijë lekë** me rritje për **vlerën 106,745 mijë lekë**.

Për vitin 2020 me VKB nr. 18, datë 31.03.2019 dhe VKB nr.31, datë 26.6.2019 të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresën nr. 717/1, datë 14.7.2020, janë bërë ndryshime mbi të ardhurat dhe shpenzimet

*Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësisia vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.*

Është rakorduar çdo muaj me degën e Thesarit Vlorë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Vlorë duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitet respektive të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuar nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës ***Aneks nr. 4***, bashkëngjitur.

**Për vitin 2019**, buxheti është realizuar në total në masë 66% ose nga 628,055 mijë të programuara, është realizuar 416,642 mijë lekë, nga të cilat nga granditë e të ardhurat e veta në vlerën 349,236 mijë lekë ose 84 % të totalit të buxhetit dhe nga grandet specifike në vlerën 67,406 mijë lekë ose 16% e totalit.

Në zërin paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në masën 90 % ose nga 114,254 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 102,749 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 99,936 mijë lekë ose 97 % të totalit të pagave, në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike 601, është realizuar në masën 83 % ose nga 20,633 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 17,105 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 16,807 mijë lekë ose 98. % të totalit të sigurimeve, shpenzime operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën 83 % ose nga 167,676 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 139,951 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 139,578 mijë lekë ose 99 % të totalit të shpenzimeve operative dhe në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masë 40 % ose nga 190,529 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 75,389 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 66,991 mijë lekë ose 89 % të totalit të investimeve.

Për vitin 2019, nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore.

Për periudhën 01.10.2019 deri me 31.12.20219, janë zhvilluar pesë procedura prokurimi për investime të dhënat sipas pasqyrës *Aneks nr. 5*, bashkëngjitur.

Likuidimi i tyre është bërë për vitin 2019 në vlerën 4,950 lekë, për vitin 2020 në vlerën 24,174 mijë lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 20,178 mijë lekë.

Për periudhën si më sipër investimet nga grandit e të ardhurat e veta janë në vlerën 16,305 mijë lekë, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2020 dhe nga Ministritë e linjës dhe FZHR në vlerën 40,992 mijë lekë të cilat likuidimi është planifikuar në vite. Diferenca e pa likuiduar për shumën 3,334 mijë lekë ngelet për tu likuiduar gjatë vitit 2022.

**Për vitin 2020,** buxheti është realizuar në total në masë 66% ose nga 727,102 mijë të programuara, është realizuar 478,814 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 362,911 mijë lekë ose 76 % të totalit të buxhetit dhe nga grande specifike në vlerën 115,903 mijë lekë ose 24% e totalit.

Në zërin paga llogaria ekonomike 600, është realizuar në masën 88 % ose nga 115,400 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 101,065 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 99,256 mijë lekë ose 98 % të totalit të pagave, në zërin sigurime shoqërore llogaria ekonomike 601, është realizuar në masën 86 % ose nga 19,543 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 16,879 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 16,577 mijë lekë ose 98 % të totalit të sigurimeve, shpenzime operative llogaria ekonomike 602, është realizuar në masën 69 % ose nga 183,135 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 127,016 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 127,016 mijë lekë ose 100 % të totalit të shpenzimeve operative dhe në zërin investime llogaria ekonomike 231, është realizuar në masë 48 % ose nga 284,402 mijë lekë të programuar, realizuar në masën 135,732 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 92,708 mijë lekë ose 68 % të totalit të investimeve.

Për vitin 2019, nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2020 janë bërë procedura prokurimi për investime dhe janë lidhur kontrata me Operatorë ekonomik gjithsej për vlerën 448,821 mijë lekë nga grantit e të ardhura e veta në vlerën 153,147 mijë lekë dhe nga fondet e Ministrisë së linjës dhe FZHR në vlerën 295,674 mijë lekë.

Nga auditimi në lidhje me likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura për vitin buxhetor 2020, rezulton se për objekte të cilat do financohen nga grandit dhe të ardhurat nga 16 kontrata të lidhura në vlerën 153,147 mijë lekë me TVSH, janë financuar gjatë vitit 2020 në vlerën 73,024 mijë lekë ose 47.6 % e vlerës së kontratave, pasi këto kontrata janë lidhur në fund të vitit sipas pasqyrës *Aneks nr. 6*, bashkëngjitur.



Objekte të cilat do financohen nga fonde të Ministrisë së linjës nga 4 kontrata të lidhura në vlerën 295,674 mijë lekë me TVSH, janë financuar gjatë vitit 2020 në vlerën 28,661 mijë lekë ose 9.6% e vlerës së kontratave sipas pasqyrës **Aneks nr. 7**, bashkëngjitur.

**Për 8/mujorin 2021**, buxheti është realizuar në total në masë 32% ose nga 986,237 mijë të programuara, është realizuar 316,358 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 313,109 mijë lekë ose 99 % të totalit të buxhetit,

Nga auditimi në lidhje me likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura për periudhën 01.01.2021-deri 30.06.2021, rezulton se nga 16 kontrata të lidhura në vlerën 308,840 mijë lekë me TVSH, janë financuar gjatë periudhës 2021 në vlerën 24,162 mijë lekë ose 7.8 % e vlerës së kontratave sipas pasqyrës **Aneks nr. 8**, bashkëngjitur.

*Fondet e shpenzuara nga njësitë vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.*

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Himarë ka përfituar ndihma ushqimore, për shkak të periudhës së pandemisë COVID-19, **në vlerën gjithsej 160,295 lekë**. U auditua procesi që ka ndjekur bashkia për administrimin e ndihmave ushqimore të përfituara nga DPRMSH Tiranë, të cilat janë dokumentuar për çdo rast furnizimi, ndërsa janë administruar në magazinë me fletëhyrje të rregullt, bashkëlidhur së cilës është edhe fletëdalja e furnitorit. Fletëdalja e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Himarë, rezulton se Fletëdalja nr. 234, datë 22.09.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.22, datë 24.09.2020 për ushqimet në vlerën 77,906.42 lekë dhe Fletëdalja nr. 235, datë 22.09.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.23, datë 24.09.2020 për ushqimet në vlerën 82,388.52 lekë.

**Kriteri:** Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 32, neni 65; UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 për procedurat standard të zbatimit të buxhetit i ndryshuar pika 101; ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes Vendore, neni 46.

**Ndikimi/efekti:** Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të Bashkisë Himarë dhe performancës në përgjithësi.

**Shkaku:** Zbatimi i legjislationit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor, mos zbatimi i kërkesave ligjore për kontabilitetin dhe rritja e detyrimeve kreditore nga viti në vit, dhe mos programimi si zë më vete në buxhet për shlyerjen e tyre.

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

**6. Titulli i gjetjes:** Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019-31.05.2021, programimi i pagesave për faturat e pa likuiduara, vendimet gjyqësore dhe vendimet e shpronësimeve.

**Situata:** Nga të dhënat, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2020, të llogarisë (401-408) për Furnitor e llogari të lidhura me toë, detyrime të tjera në llog (467) për Kreditorë të ndryshëm, paraqitet në vlerën 75,170,102 lekë, ose 9.6% e vlerës së buxhetit të vitit 2020 dhe vendime gjykate në vlerën 436,972 lekë.

Në mënyrë analitike detyrimet për fatura të pa likuiduara me datë 31.12.2020, paraqiten në sipas pasqyrës **Aneks nr. 9**, bashkëngjitur.

Me datë 31.08.2021, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara, të llogarisë (401-408) për Furnitor e llogari të lidhura me toë, detyrime të tjera në llog (467) për Kreditorë të ndryshëm, paraqitet në vlerën 32,752,293 lekë, në totalin e tyre Vendime Gjykate janë për vlerën 436,972 lekë, sipas pasqyrës më poshtë.

Në mënyrë analitike detyrimet për fatura të pa likuiduara me datë 31.08.2021, paraqiten në sipas pasqyrës **Aneks nr. 10**, bashkëngjitur.

**Kriteri:** Moszbatim i plotë i kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë në nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitò i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 òPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 òPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò neni 40, 48.

**Ndikimi/efekti:** Në treguesit ekonomikë dhe financiare të Bashkisë Himarë.

**Shkaku :**Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor, mos zbatim i kërkesave ligjore për kontabilitetin dhe rritja e detyrimeve kreditore nga viti në vit, dhe mos programimi si zë më vete në buxhet për shlyerjen e tyre.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Himarë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime në vlerën 32,752,293 lekë, duke ndjekur radhën e pagesave dhe Drejtoria Financës të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr120/5, datë 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë,ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Mbi konstatimet e grupit të KLSH për planifikimin në buxhet si zë më vete të detyrimeve për fatura të palikujduara, ku sqarojmë se Bazuar në ligjin nr. 68/2017 òPër Financat e Vetëqeverisjes Vendoreò, neni 2, pika 6, e cila citon si më poshtë: Të vendosë rregulla që sigurojnë disiplinë fiskale, politika të qëndrueshme dhe transparente për menaxhimin e fondeve publike. Veprimtaria e sektorit të Financës është kryer në përputhje me udhëzimin e cituar nga audituesit me nr.2, datë 06.02. 2012 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò neni 101, përcakton se *“Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim.”* i cili përcakton mbulimin e detyrimeve nga viti i mëparshëm dhe jo pasqyrimin analitike të tyre. ose siç sugjeron akt konstatimi nr. 1 fq.3.

Gjithashtu referuar udhëzimit të Ministrisë së Financave për vitin ushtrimor objekt auditimi nr.2, date 20.01.2020, òPer zbatimin e buxhetit te vitit 2020ò mbi të cilin ka vepruar sektori i financës për vitin ushtrimor objekt auditimi neni 106 ku citohet: *Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që jo më vonë se data 10 Prill 2020 për tremujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5.* Korrespondenca për sa më sipër me Ministrinë e Financave e kryer sipas shkresës nr. 1900 prot. datë 20.05.2021 për vitin 2021, shkresës 3246 prot datë 08.10.2020 për vitin 2020.

**Sqarimi i grupit të KLSH:** Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit në lidhje me planifikimin si zë më vete në buxhet të detyrimeve për fatura të palikujduara nuk merret në konsideratë ndërsa përsa i përket raportimit të detyrimeve në Ministrinë e Financës ato qëndrojnë dhe merren në konsideratë nga grupi i KLSH.

## **2.1. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhës së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore fuqi dhe nxjerrja detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.**

Në strukturën e Bashkisë Himarë, ka funksionuar *Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social* ku për të ardhurat ka funksionuar Sektori i të Ardhurave, me një Përgjegjës Sektorial dhe 8 specialistë të Taksave dhe tarifave vendore.

Paketat fiskale për vitin 2019 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë nr. 201, datë 23.11.2018, për vitin 2020 është punuar me paketën fiskale të vitit 2019 dhe për vitin 2021 me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 59, datë 27.11.2020.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, për vitin 2019, kanë ushtruar aktivitet 833 subjekte (749 subjekte të biznesit të vogël, 84 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione), për vitin 2020, kanë ushtruar aktivitet 694 subjekte (617 subjekte të biznesit të vogël, 77 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione) dhe për vitin 2021(deri në 31.08.2020 , kanë ushtruar aktivitet 749 subjekte (676 subjekte të biznesit të vogël, 73 subjekte të biznesit të madh dhe subjekte të tjera institucione).

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizimi i të ardhurat për taksat dhe tarifatat vendore paraqiten sipas ***Aneks nr. 11***, bashkëngjitur.

Nga të dhënat e *Drejtorisë së Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social*, Sektorit i të Ardhurave për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 280,400 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 247,096 mijë lekë ose 88%, **me një mosrealizim në vlerën 33,304 mijë lekë.**

Për vitin 2019 me mosrealizim më të madh janë, Taksa mbi kalimin e Pronësisë në vlerën 2,679 mijë lekë, Taksa e Ndërtimit në vlerën 11,917 mijë lekë dhe Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë në vlerën 29,652 mijë lekë.

Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, nga 222,875 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 310,643 mijë lekë ose 139 %, **me një tejkalim në vlerën 87,768 mijë lekë.**

Për vitin 2020 me tejkalim më të madh paraqiten, Taksa e ndikimit në Infrastrukturë në vlerën 79,057 mijë lekë dhe Tarifë e Zënies së Hapësirave Publike në vlerën 28,770 lekë. Kjo si rezultat i planifikimit të tyre me rezervë dhe mospasja e një databazë të dhënash në lidhje me kërkesat e subjekteve për leje ndërtimi dhe për përdorimin e hapësirave publike në zonën e plazhit.

Për 8/mujorin e vitit 2021, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore gjithsej, janë realizuar në vlerën 408,181 mijë lekë.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë mosrealizimi dhe tejkalimi, të dhënat paraqiten sipas ***Aneks nr. 12***, bashkëngjitur.

Përsa më sipër tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët e kalojnë xhiron vjetore dhe në zbatim të ligjit kanë paguar Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Himarë, taksa e kalimit e të drejtës në pronësi është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më përpara dhe të ardhurat nga Tatimi mbi të ardhurat personale rezulton të mos jetë planifikuar për periudhën objekt auditimi.

Sa më sipër planifikimi i këtyre llojeve taksave është bërë pa u mbështetur në dokumentacion ligjorë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 për Sistemin e Taksave Lokale dhe ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

**7. Titulli i gjetjes:** Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**Situata:** Të ardhurat nga Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja, nga të dhënat që disponon *Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social*, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas listave të sjella nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Vlorë sot ASHK Vlorë me shkresë, të destinuar për regjistrim në ASHK Vlorë, konstatohet se për periudhën e auditimit, sipas listave për leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë **59 persona dhe subjekte me vlerë 3,851,173 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë, sipas Aneks nr. 13, bashkëngjitur.**

**Kriteri:** -Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për Sistemin e Taksave vendore të ndryshuar, neni 27 të Taksa e ndikimit në infrastrukturë”*, pika 3.

VKM nr.860, datë 10.12.2014 *“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”*, pika 5.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për realizimin e të ardhurave.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Bashkia Himarë, të marren masa që të zbatohen procedurat ligjore për realizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, dhe arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë për **59 persona me vlerë 3,851,173 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Himarë, sipas Aneks nr. 13, bashkëngjitur.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr120/5, datë 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Mbi konstatimet e grupit të KLSH për vlerësimin e mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, ku sqarojmë Referuar gjetjes, mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, DPZHT ka përllogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e reja dhe është njoftuar subjekti/individit për kryerjen e pagesave për vijimin e procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Si përcakton dhe VKM Nr. 954, datë 25.11.2015, në përputhje me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, i ndryshuar neni 27 mbi Dokumentacionin tekniko-ligjor për legalizimin e objektit pika ç) vërtetimin për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi; Pra DPZHT dhe DTTV duke qenë se: barrierrë ligjore për regjistrimin e pasurive të paluajtshme është pikërisht pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke qenë se në ligjet funksionale respektive udhëzime apo VKM: qeverisja vendore, nuk mund të pezullojë procesin e regjistrimit pasi nuk është kompetencë e NJQV.*

**Sqarimi i grupit të KLSH:** Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit në lidhje me vlerësimin e mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në

infrastrukturë, drejtoria e të ardhurave nuk ka vetëm detyrë ta përlllogarisë por duhet të ketë korrespondencës të rregullt me ASHK për subjektet të cilat pajisen me leje legalizimi, pra kundërshtitë nuk merren në konsideratë.

**8. Titulli i gjetjes:** Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit në mospërputhje me dispozitat ligjor

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurat e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë dhe arkëtimin e detyrimeve për këtë tarifë rezultoi se: Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, për periudhën objekt auditimi nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në nenin 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë, i ndryshuar, përsa i përket arkëtitimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Himarë.

Sipas evidencës së paraqitur nga Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Himarë, u audituan procedurat e dhënies dhe pagesat për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, për periudhën objekt auditimi, mbështetur në legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të këshillit bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (Autorizim), u konstatua se:

Në bashkinë Himarë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 8 subjekte, të cilët nuk janë pajisur me licencën dhe nuk kanë likuiduar **vlerën prej 8,000,000 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë**, sipas *Aneks nr. 14*, bashkëngjitur.

**Kriteri:** Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa òbö, dhe pika 9, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbö dhe pika 9, si dhe pika 15.1, 15.2 të këtij akti normativ.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e **vlerës 8,000,000 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas *Aneks nr. 14*, bashkëngjitur.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr120/5, datw 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritit dhe

Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë,ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Mbi konstatimet e grupit të KLSH për vlerësimin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit në mospërputhje me dispozitat ligjor, ku sqarohet Për sa më sipër i bëjmë me dije audituesit se bazuar Vendimin Nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò Seksioni 2 pika 2 citon se: 2. Për marrjen e licencave për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete e vajrave lubrifikante, personi juridik duhet të paraqesë, pranë organit që ka të drejtën e dhënies së licencës, këto dokumente: a) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrimit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës bruto; b) Projektin teknologjik të depove dhe të linjave, të miratuar nga organet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi të mjedisit dhe të mbrojtjes nga zjarri. Projekti teknologjik për depot dhe linjat që përdoren për depozitimin dhe shitjen e gazit të lëngshëm të naftës duhet të jetë i miratuar edhe nga organet përkatëse të kontrollit të pajisjeve nën presion; c) Certifikatën e përdorimit të objektit, të lëshuar nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit; ç) Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës; d) Certifikatën e kalibrimit të rezervuarëve, të vendosur në stacion, dhe të matjes së aparateve të shitjes së karburanteve dhe gazit të lëngshëm të naftës, nga DPM-ja ose organet e autorizuara për këtë qëllim; dh) Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin; e) Autorizimin hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës; ë) Regjistrimin e markës tregtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave; f) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore;

g) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, përfshirë sigurimet shoqërore Subjektet e cituar që janë pa licence kane patur mangësi në dokumentacion për pasojë **Drejtoria e Shërbimeve** nuk ka mundur qe te lëshojë Autorizim pa patur sigurinë sikurse e përcakton dhe VKM e mësipërme që këto subjekte plotësojnë te gjitha normat për sigurinë. Ashtu si përcaktohet ne paketën fiskale për Bashkinë Himarë *Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës për dhënie dhe përsëritjen e licence për tregtim karburanti, lende djegëse e vajra lubrifikant është Sektori i te Ardhurave pas marrjes së Lejes për Ushtrimin e Aktivitetit, nga Drejtoria e Shërbimeve që jep edhe lejet për ushtrim aktiviteti në Bashkinë e Himarës. Kjo strukturë kryen dhe llogaritjen e detyrimit për lejen përkatëse. Sektori i të Ardhurave nuk dispononin leje, autorizime të dhëna nga Bashkia Himarë dhe duke qenë që subjektet nuk kanë plotësuar dokumentacionin sipas kërkesës së VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò Seksioni 2 pika 2.*

**Sqarimi i grupit të KLSH:** Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit në lidhje me vlerësimin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit, drejtoria e të ardhurave sipas paketës fiskale planifikon të ardhura dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve duhet të bëjë të mundur arkëtimin e të ardhurave për subjektet të cilët tregtojnë karburant, lende djegëse e vajra lubrifikant, pra kundërshtitë nuk merren në konsideratë. Përsa i përket përgjegjësisë për procedurën e dhënies së kësaj licence merret në konsideratë fakti që nuk është përgjegjësi e Drejtorisë së të Ardhurave.

**9. Titulli i gjetjes:** Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga të ardhurat nga dhënia me qira e Aseteve për vendosjen e antenave të telefonisë celulare për periudhën objekt auditimi.

**Situata:** Bashkia Himarë për periudhën objekt auditimi ka lidhur 11 kontrata për dhënie me qira të Aseteve pyje dhe kullota për vendosjen e antenave të telefonisë celulare, nga auditimi në lidhje me pagesat e detyrimeve të kontratave u konstatua se nuk kanë likuiduar detyrimet në vlerën **5,375,850 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Himarë**, sipas *Aneks nr. 15*, bashkëngjitur.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, VKM nr. 391, datë 21.06.2006 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò, i ndryshuar, lidhja 2, pika 7.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

**Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që dispijlojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **5,375,850 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas *Aneks nr. 15*, bashkëngjitur.

**10. Titulli i gjetjes:** Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa për vitet 2019, 2020 dhe 10/mujori 2021, mungesë të ardhurash për Bashkinë.

**Situata:** Nga auditimi i të dhënave, të paraqitura nga Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, rezulton se më datën 31.10.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë 914 subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 252,053 mijë lekë dhe familjarët për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën gjithsej prej 35,659 mijë lekë, **gjithsej në vlerën 287,712 mijë lekë**.

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Në 000/lekë

Emërtimi	Viti 2019		2020		Viti 2021	
	Vlera	Nr. Subjekte	Vlera	Nr. Subjekte	Vlera	Nr. Subjekte
<b>Debitorë progresiv ne total</b>	<b>53,941</b>	<b>502</b>	<b>103,574</b>	<b>652</b>	<b>252,053</b>	<b>914</b>
Biznesi i vogël	43,444	460	82,000	600	183,619	855
Biznesi i Madh	10,497	42	21,574	52	68,434	59

Në vlerën e mësipërme për periudhën objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël e biznesit të madh me datë 31.10.2021, **për 914 subjekte në vlerën 252,053 mijë lekë** sipas të dhënave në CD bashkëlidhur.

*Drejtoria Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social*, Sektorit i të Ardhurave në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimin të detyrimeve në zbatim të kreut XI-*“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”*, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimoreò, me ndryshime.

Për periudhën objekt auditimi, kanë bllokuar llogaritë e subjekteve debitorë me urdhër bllokime në bankë për 14 subjekte debitorë për një vlerë prej 17,701,029 lekë, nga të cilat kanë paguar detyrimet 5 subjekte debitorë ose 36% e subjekteve me vlerë 6,859,911lekë dhe kanë njoftuar për detyrimet 144 subjekte debitorë për vlerën 62,817 mijë lekë ose 15% të subjekteve debitorë, kjo tregon për punë të pamjaftueshme pasi nga të dhënat rezulton subjektet të cilat janë debitorë vazhdojnë të jenë aktiv.

Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, ku thuhet se: *Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit*,

administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Pagesa e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë\ të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar, dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematik debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Ndërsa vlera prej 35,659 lekë në mënyrë progresive janë debitorë me datë 31.10.2021, për mos pagesën e detyrimeve për taksë toke për 5012 familje për vlerën 5,819 mijë lekë sipas pasqyrave si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr	Njësit Administrative	Sipërfaqe Tokës në ha	Numri i familjeve	Debitorë 31.12.2019 000/lekë	Debitorë 31.12.2020 000/lekë	Debitorë 31.10.2021 000/lekë
1	Himarë	82.1	2175	1,433	1,538	1,492
2	Lukova	1397	1598	3,370	3,420	3,420
3	Hor -Vranisht	802	1239	971	873	907
	<b>Totali</b>		<b>5012</b>	<b>5,774</b>	<b>5,831</b>	<b>5,819</b>

Dhe për mos pagesën e detyrimeve për taksë ndërtese dhe tarifa vendore për 5852 familje për vlerën 29,840 mijë lekë sipas pasqyrave si më poshtë

Në 000/lekë

Nr	Njësit Administrative	Numri i familjeve	Debitorë 31.12.2019 000/lekë	Numri i familjeve	Debitorë 31.12.2020 000/lekë	Numri i familjeve	Debitorë 31.10.2021 000/lekë
1	Himarë	1664	10,160	2064	11,522	2037	11,890
2	Lukova	2771	14,806	2763	14,800	2779	14,788
3	Hor -Vranisht	842	2,925	782	2,909	1036	3,162
	<b>Totali</b>	<b>5277</b>	<b>27,891</b>	<b>5609</b>	<b>29,231</b>	<b>5852</b>	<b>29,840</b>

**Kriteri:** Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore, të ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Veprime në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën 287,712 mijë lekë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i procedurave të plota në arkëtimin e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në R.SH, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën 287,712 mijë lekë, si më poshtë vijon:



*a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 öPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 öPër procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë me ndryshime.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 öMospagimi taksave dhe tatimeveö.*

*Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme, mbajnë përgjegjësi, L.M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social dhe K.K. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave.*

### **3. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë.**

**11. Titulli i gjetjes:** Nxjerrja e pasqyrave financiare, shkeljet të parimeve kontabël për evidentimin e detyrimeve kreditore dhe mos rakordimi I llogarive të pasqyrave financiare me rezultatet e gjendjes fizike nga mos kryerja e inventarëve fizikë për vitin 2020.

**Situata:** Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2019.

**Për vitin 2019,** Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Himarë me shkresën Nr. 563 prot., datë 26.02.2020.

Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2020.

**Për vitin 2020,** Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 öPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Vlorë me shkresën Nr. 1214 prot., datë 30.03.2021, (Bashkëngjitur Aktivi dhe Pasivi i bilancit **Aneks 16**

#### **Baza ligjore (për të dy vitet)**

Hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në legjislacionit në fuqi.

#### **Mbajtja e kontabilitetit (Për të dy vitet)**

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale, pa program elektronik.

#### **Për vitin 2020:**

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

**“Disponibilitete në thesar”** në pasqyrat e pozicionit financiar të periudhës ushtrimore, paraqitet më datë 31.12.2019, në vlerë **181,883,794 lekë** e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm për:

-Gjendjen e mjeteve në ruajtje në vlerën 38,357,480 lekë,

-Grande dhe të ardhura të papërdorura 143,526,314lekë.

dhe më 31.12.2020 në vlerën **265,286,349 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e fondeve që trashëgohen në vitin e ardhshëm për:

-Gjendjen e mjeteve në ruajtje në vlerën 21,037,938 lekë,

-Grande dhe të ardhura të përdorura 244,248,411 lekë.

Kjo llogari rakordon me akt akordimin i mbajtur me Degën e Thesarit Vlorë për gjendjen e fondeve në fund të periudhës ushtrimore

Gjendja e llogarisë 466 *ōKreditorē për mjetet në ruajtjeō* në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël **21,037,938 lekë** dhe është sipas rakordimit me Degën e Thesarit, pakësuar gjatë vitit për diferencën (38,357,480 -21,037,938) = 17,319,542 lekë. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar për 79 objekte për vlerën **20,859,786** lekë.

Në këtë rast, për diferencën 21,037,938 ó 20,859,786 = **178,152** lekë pasqyruar më pak në llogaritë e fund vitit 2020 se sa janë me dokumente sipas subjekteve dhe objekteve të ngurtësuar për të cilat janë ngurtësuar fondet në formë garancie. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde në vite. Konkretisht në 51 raste për vlerën e ngurtësuar 11,445,558 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë, në 9 raste për vlerën 2,780,421 lekë u përkasin ngurtësimeve për vitin 2019 dhe 19 raste për vlerën 6,633,807 lekë u përkasin ngurtësimeve të vitit 2020.

Nga Bashkia Himarë, nuk janë marrë veprimet e nevojshme për ngurtësimin e fondeve të cilave u ka kaluar afati i garancisë me qëllim përdorimin e tyre për interes publik. (*Më hollësisht të dhënat sipas Aneks 17, bashkëngjitur*)

### **Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik:**

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi procedurat e inventarizimit, konstatohet se:*

**Për vitin 2019** Inventarizimi i aktiveve të Bashkisë, është kryer nga komisionet të ngritura me urdhër të Titullarit të Bashkisë, konkretisht: Urdhri i Kryetarit nr. 160 datë 4.11.2019 për ngritjen e komisionit të inventarizimit në Njësinë Administrative Lukovë, nr. 165 datë 13.11.2019 për ngritjen e komisionit të inventarizimit në Njësinë Administrative Horë ó Vranisht dhe nr. 164 datë 13.11.2019 për ngritjen e komisionit të inventarizimit në Njësinë Administrative Himarë, u konstatua se është kryer inventarizimi fizik vetëm për aktivet e llogarive 218- *Inventar ekonomik* si dhe llogarisë 327- *Objekte inventar*.

***Nuk është kryer inventarizimi për aktivet e tjera.***

Në përfundim të procesit të inventarizimit, është përgatitur nga P/Financës gjendja kontabël e aktiveve si dhe gjendja fizike sipas rezultateve të inventarizimeve fizike për llogaritë 218 dhe 327, të cilat kanë rezultuar për shumat:

-Llogaria 218 gjendja fizike 9,153,253 lekë, gjendja fizike 8,098,083 lekë plus të propozuara për jashtë përdorimit 1,037,170 lekë.

-Llogaria 327 gjendja kontabël për 1,499,256 lekë, gjendja fizike 1,383,858 lekë plus të propozuara për jashtë përdorimit 115,398 lekë.

Nuk ka vendim të KB për miratim jashtë përdorimit, nuk ka komision të vlerësimit për nxjerrjet jashtë përdorimit.

Konstatohet se kartelat e inventarëve nuk janë firmosur nga personi që ka në ngarkim të inventarëve por vetëm nga komisioni i inventarizimit për Njësinë Administrative Lukovë.

**Për vitin 2020** Inventarizimi i aktiveve të Bashkisë, është kryer nga komisionet të ngritura me urdhër të Titullarit të Bashkisë, konkretisht:

Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 140 datë 13.10.2020 *ōPër ngritjen e grupit të inventarizimit të aktiveveō* në Njësinë Administrative të **Himarës** për vitin 2020.

Për inventarizimin e aktiveve në Njësinë Administrative Lukovë si dhe për Njësinë Administrative Horë-Vranisht, nuk kanë dalë urdhra nga Titullari i Bashkisë por janë të njëjtat komisione si në vitin 2019.

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit u konstatua se është kryer inventarizimi fizik vetëm për aktivet e llogarive 218- *Inventar ekonomik* si dhe llogarisë 327- *Objekte inventar*.

***Nuk është kryer inventarizimi për aktivet e tjera.***

Në përfundim të procesit të inventarizimit, është përgatitur nga P/Financës gjendja kontabël e aktiveve si dhe gjendja fizike sipas rezultateve të inventarizimeve fizike për llogaritë 218 dhe 327.

Për aktivet është paraqitur përmbledhëse që të krahasuara me gjendjen kontabël të aktiveve sipas të dhënave të pasqyrave financiare të vitit 2020, konstatohen diferenca. *(Më hollësisht të dhënat sipas Aneks 18, bashkëngjitur)*

Me VKB nr. 27, datë 28.05.2021 ka miratuar nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e aktiveve sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Social pranë Bashkisë Himarë.

Vendimi i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me nr. 425/1 datë 08.06.2021.

Bashkëngjitur vendimit është lista e inventarëve për llogaritë 218 dhe 327 ***por nuk është lista për mjetet e transportit të nxjerra jashtë përdorimit.***

Nuk ka komision për vlerësimin e nxjerrjeve jashtë përdorimit.

Nuk janë debituar personat përgjegjës përse janë konstatuar mangët vlera inventariale shuma 472,698 lekë.

Vlerat e nxjerra jashtë përdorimit gjithsej 8,811,652 lekë nuk janë shkarkuar nga kontabiliteti dhe nuk ka veprim kontabël.

***Përse më sipër, inventarizimi i aktiveve afatgjatë për vitin 2020, nuk është kryer sipas kërkesave ligjore, nuk është i plotë, nuk është i saktë dhe as i dokumentuar me dokumente ligjorë e kontabël për rrjedhojë; llogaritë e pasqyrave financiare, për këto llogari, nuk janë të besueshme, janë shkelje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004*** Për kontabilitetin dhe pasqyra financiareë i ndryshuar, Kreu II, neni 7 ku citohet: *“1. Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një here në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse.*

*2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore.”*, të ***UMF Nr. 8, datë 9.03.2018*** *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” Kreu III, pika 30 ku citohet: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.ö*

*-Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë: 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2020.*

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

-Llogaria 202 *öStudime dhe kërkime* për vlerën kontabël historike në vlerën 122,092,960 lekë, e cila është e pa analizuar.

Në debi të kësaj llogarie, është kontabilizuar edhe vlera e Planit të Përgjithshëm Vendor në shumën 47,454,000 lekë.

Nuk është kryer inventarizim mbi gjendjen fizike të këtyre studimeve dhe projekteve në ngarkim të personave që i administrojnë këto studime dhe projekte.

-Llogaria 210 *öToka, troje, terrene* për vlerën historike 28,563,121 lekë. Kjo llogari është e analizuar në kontabilitete për 4 objekte ku 1 prej të cilëve është trashëguar nga ish Komuna Lukovë, pa e analizuar në përmbajtje. ***Në analizën kontabël, mungojnë të***

***dhëna mbi përmbajtjen e kësaj llogarie në trojeve, terrene dhe objekteve të investuara etj.***

-Llogaria 212 *ōNdërtime konstruksioneō* për vlerën historike 1,043,693,693 lekë. Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet sipas objekteve si; Shkolla, Qendra Shëndetësore, mure rrethues etj.

-Llogaria 213 *ōRrugē rrjete vepra ujoreō* për vlerën historike 799,475,042 lekë. Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet sipas objekteve si; rrugē, rrjete, ujēsjellēs etj. *Ndērkohē qē nē kēto analiza, ēshtē kontabilizuar edhe vlera 89,964,196 lekē si “transferim kapitali tek Ujēsjellēsi SHA” Himarē (Pakēsim kapitali).*

Nuk na u paraqitēn tē dhēna kontabēl nēsē ēshtē bērē kalim i kapitalit për Ujēsjellēs Kanalizimet sha si ēshtē akti i dorēzimit tē kētyre Aseteve etj.

-Llogaria 214 *ōInstalime teknike, makineri pajisje, vegla puneō* për vlerën kontabēl 13,878,553 lekë. Kjo llogari është e pa analizuar në kontabilitet. Kētu janē pērfshirē edhe pērça janē marrē nga ish Komuna Lukovē asete nē vlerēn 6,973,512 lekē dhe nga ish Komuna Vranisht pēr vlerēn 200,009 lekē tē cilat janē tē pa analizuara nē pērmbajtjen e tyre.

-Llogaria 215 *ōMjete transportiō* për vlerën historike 42,502,084 lekë.

Pēr llogarinē inventariale 215 *“Mjete transporti”* me vlerēn kontabēl historike 42,502,084 lekē, nuk ēshtē e analizuar nē kontabilitet, nuk u paraqitēn kartelat dhe nuk ēshtē kryer inventarizimi fizik i tyre.

Nga Drejtori i Shērbimeve dhe Mirēmbajtjes u paraqitēn aktet e marrjes nē dorēzim tē mjeteve nē pērdorim pēr personat si mē poshtē:

1-Akti i marrjes nē dorēzim tē Autoveturē Mercedes-Benz, Targa AA mē datē 15.04.2016, marrēsi J.G.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

2-Akti i marrjes nē dorēzim tē Autoveturē Tip. Chevrolet, Marka Spark, Targa AA mē datē 15.04.2016, marrēsi R.H.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

3-Akti i marrjes nē dorēzim tē Autoveturē Tip. Chevrolet, Marka Spark, Targa AA mē datē 15.04.2016, marrēsi B.A.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

4-Akti i marrjes nē dorēzim tē Autoveturē Marka Mitsubishi, Targa AA mē datē 14.06.2018, marrēsi G. B.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

5-Akti i marrjes nē dorēzim tē Autoveturē Marka Mitsubishi, Targa TR 24 52 U mē datē 14.06.2018, marrēsi A.B.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

6-Akti i marrjes nē dorēzim tē Skrap i Ri tip. Volvo EC mē datē 20.10.2018, marrēsi I.M. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

7-Akti i marrjes nē dorēzim tē Skrepit Marka JCB, Targa P mē datē 15.05.2019, marrēsi N.M.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

8-Akti i marrjes nē dorēzim tē mjetit Tip TOYOTA CRUISER, Targa AA mē datē 17.01.2020, marrēsi K.B.. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

9-Akti i marrjes nē dorēzim tē mjetit Tip IVEKO MAGIRUS, Targa ska mē datē 15.05.2019, marrēsi A.LL me detyrē Pērgjegjēs i Zjarrfikēsēs. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

10-Akti i marrjes nē dorēzim tē mjetit Tip IVEKO, Targa ska mē datē 15.05.2019, marrēsi A.LL. me detyrē Pērgjegjēs i Zjarrfikēsēs. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

11-Akti i marrjes nē dorēzim tē mjetit Tip Benz MERCEDES, Targa AA mē datē 15.05.2019, marrēsi A.LL me detyrē Pērgjegjēs i Zjarrfikēsēs. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

12-Akti i marrjes nē dorēzim tē mjetit Tip VOLVO Veturē, Targa ska mē datē 15.05.2019, marrēsi A.LL me detyrē Pērgjegjēs i Zjarrfikēsēs. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

13-Akti i marrjes nē dorēzim tē mjetit Tip Fugon Benz MERCEDES, Targa ska mē datē 15.05.2019, marrēsi A.LL. me detyrē Pērgjegjēs i Zjarrfikēsēs. Çmim nuk ka dhe kartelē inventariale nuk ka.

14-Flet dalje nr.310, datë 22.12.2020 në dorëzim të mjetit Tip Benz Atego, Targa ska më, marrësi A.B.. Çmim 5,923,854 lekë.

15-Akti i marrjes në dorëzim të Autoveturë Tip. TOYOTA, Targa ska më datë 15.04.2016, marrësi B.A. Çmim nuk ka dhe kartelë inventariale nuk ka.

Si dhe lista e Mjeteve të cilat nuk janë në përdorim Si më Poshtë

Nr	Emërtimi i Mjetit	Vendndodhja
1	Hyundai VL 2716 C	Bashkia Himarë
2	Mercedes Benz	Nj/Administrative Vranisht
3	Mercedes Benz AA 596 FR	Nj/Administrative Lukovë
4	Mercedes Benz	Nj/Administrative Lukovë
5	Opel AA251 IU	Bashkia Himarë

-Llogaria 218 ÷ *Inventar ekonomik* për vlerën historike 44,163,077 lekë. Kjo llogari është e analizuar sipas rezultatit të inventarizimit fizik, për vlerën 31,496,365 lekë ose më pak se në pasqyrat financiare për vlerën 12,666,712 lekë.

-Llogaria 31 ÷ *Materiale* për vlerën kontabël 3,819,406 lekë.

-Llogaria 32 ÷ *Inventar i imët* për vlerën kontabël 11,117,197 lekë.

#### **Analiza e llogarive debitorë**

Në pasqyrat financiare të vitit 2020, gjendja e llogarisë debitorë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet me vlerë kontabël 137,747,839 lekë. Gjendja e kësaj llogarie për këtë vlerë është e pa ndryshuar nga viti 2019.

Kjo llogari është e analizuar si vijon:

-76,423,839 lekë debitorë nga auditimet e KLSH-së e analizuar për 65 subjekte juridike dhe persona fizike.

-324,000 lekë për gjoba të vendosura nga APP dhe

-61,000,000 lekë janë debitorë për tatim taksat e subjekteve taksapagues lokalë sipas akteve të rakordimit me Drejtorinë e Tatim Taksave Vendore të Bashkisë Himarë.

(Nga auditimi i kaluar) është konstatuar se veç këtyre debitorëve, ***nuk janë kontabilizuar debitorë të tjerë për 14 raste të gjobave të vendosura nga APP për shumën totale 3,240,000 lekë si dhe debitorë të tjerë sipas rekomandimeve të KLSH-së për 54 subjekte fizikë dhe juridikë për vlerën totale 80,145,955 lekë*** (Më hollësisht të dhënat sipas Pasqyrës që vijon) bashkëgjitur në fund.

Në këtë rast, ***vlera totale e debitorëve të pa kontabilizuar*** në pasqyrat financiare, ***është për shumën totale 83,385,955 lekë*** (Gjë që është konstatuar edhe në auditimin e kaluar).

Nuk janë kontabilizuar dhe detyrimet e auditimit të periudhës 2017 deri 30.09.2019, në vlerën **29,030,035 lekë**.

Nuk janë kontabilizuar debitorët e taksave e tarifave vendore me datë 31.12.2020, për 652 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, **në vlerën 103,574,000 lekë**.

*Nga Bashkia Himarë, nuk është proceduar sipas kërkesave ligjore duke bërë kërkesë padi në gjykatë, për arkëtimin e shumave debitorë.*

*(Më hollësisht të dhënat sipas **Aneks 19**, bashkëgjitur)*

#### **Analiza e llogarive kreditore**

Gjendja e llogarive kreditore, sipas pasqyrave financiare, është si më poshtë vijon:

Llogaritë 401-408 ÷ *Furnitorë e llogari të lidhura me to* për vlerën 0 lekë dhe llogaria 467 ÷ *Kreditorë të ndryshëm* për vlerën 75,710,102 lekë. Këto llogari janë të analizuar për 17 subjekte dhe detyrimet janë krijuar gjatë vitit 2020 (Më hollësisht të dhënat sipas **Aneks 20** bashkëgjitur)

Nga auditimi, u konstatua se pagesat për detyrimet ndaj subjekteve të kryera në vitin 2021, disa fatura të paguara gjatë këtij viti për shërbime nga të tretët i përkasin viti 2020, ***nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për 5 raste në vlerën totale 16,378,087 lekë, konkretisht:***

-Me urdhër shpenzimi nr. 58 datë 16.02.2021 është paguar Subjekti S. ShPK shuma 5,611,147 lekë ÷ Rikonstruksion për përshtatjen e godinës së shkollës në Eko- Museum

Projekti Co.CO Tuor. Llogaria ekonomike 230. Referuar fatura tatimore nr. 261 datë 31.12.2020.

***Për vlerën 5,611,147 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i pa paguar nga viti 2020.***

-Me urdhër shpenzimi nr.160 datë 29.03.2021 është paguar Subjekti S. ShPK shuma 9,372,268 lekë òRikonstruksion për përshtatjen e godinës së shkollës në Eko-Museum Projekti Co.CO Tuor. Llogaria ekonomike 230. Referuar fatura tatimore nr. 158 datë 02.10.2020.

***Për vlerën 9,372,268 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i pa paguar nga viti 2020.***

-Me urdhër shpenzimi nr. 38, datë 09.02.2021, janë paguar shpenzime për energji elektrike për muajin Dhjetor 2020, referuar aktit të rakordimit me OSHEE Vlorë në muajin Dhjetor 2020 për shumën e paguar 1,229,537 lekë.

***Për vlerën 1,229,537 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i pa paguar nga viti 2020.***

-Me urdhër shpenzimi nr. 15 datë 7.01.2021, është paguar B.I. ShPK për 13,000 lekë vendime gjyqësore urdhër ekzekutimi nr. 841 datë 23.09.2020, protokolluar me nr. 3063 datë 28.09.2020.

***Për vlerën 13,000 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim i pa paguar nga viti 2020.***

-Me urdhër shpenzimi nr. 168, 169, 170 datë 18.03.2021 janë paguar detyrime për OSSHE për lidhje linja të re ndriçim rrugësh përkatësisht në shumët 50,745 lekë, 50,745 lekë dhe 50,745 lekë referuar faturimeve të datave respektive 9.12.2020; 26.11.2020 dhe 27.11.2020.

***Për vlerën 152,135 lekë, nuk është pasqyruar si detyrim në llogarinë 467 të viti 2020***

Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh dhe kryerje investimesh e si rrjedhojë mospërfshirjen e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre dhe të tjera në bilancin vitit ushtrimor, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2020 për vlerën **16,378,087** lekë, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të PF të vitit 2020 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve.

#### **Kriteri:**

UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kap. III, pika 34;

VKM nr. 248, datë 10.04.1998 òPër miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyreò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyra financiareò i ndryshuar, Kreu II, neni 7;

UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò i ndryshuar, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap. IV, pika 73 dhe 74.

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 òPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò, Kap. II, pika 1 dhe UMF nr. 8 datë 9.03.2018, Kap. III, pika 30.

**Ndikimi/Efekti:** Në përpilimin e opinionit mbi pasqyrat financiare, në performancës e Institucionit Bashkia Himarë dhe treguesit ekonomikë dhe financiarë.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kërkesave ligjore.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masa për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël, ku për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara si òToka, troje, terreneò, òNdërtime konstruksioneò òRrugë rrjete vepra ujoreò etj., të krijojë komisione me specialistët e nevojshëm për verifikimin në terren të këtyre Aseteve dhe për diferencat eventuale të konstatuara nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masat për sistemimin e llogarive të cilat nuk pasqyrojnë vlerën reale të tyre, regjistrimin kontabël të detyrimeve debitore dhe kreditore.

Për të pasqyruar saktë treguesit financiarë të burimeve dhe detyrimeve financiarë, në fund të periudhave ushtrimore, të rakordohet me Degën e Thesarit lidhur me të dhënat e Sistemit Informatikë të Thesarit.

#### **4. Auditim mbi prokurimet publike**

##### **Auditim mbi prokurimet publike për periudhën 01.10.2019-31.12.2019**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2019 ó 31.12.2019;

Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;

DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;

Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;

Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);

Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/mallrave dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secila përfituese e investimit apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka Bashkia Himarë, referuar në disponimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, nenet 23 dhe 28; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.10.2019 ó 31.12.2019, auditoi 4 procedura me vlerë nga 3.5 milion deri në 35 milion lekë.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varjon nga 1 deri në 4 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesim të pakët të OE kjo edhe për faktin se kriteret që aplikohen nga AK, përgjithësisht nuk janë në përputhje me ligjin.

-Nga auditimi i 4 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 òObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 òParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ò Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveò, ku;

a- Në 4 (katër) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b- Në 1 (një) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

Procedurat e audituara janë:

1-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Blerje Makine*", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 4,125,000 lekë, ose më pak se fondi limit prej 41,667 lekë dhe OE fitues "MMö SHPK.

2-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë, ose më pak se fondi limit prej 543,028 lekë dhe OE fitues "Jö SHPK.

3-Është audituar procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam*", me vlerë të prokuruar

34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë, ose më pak se fondi limit prej 708,057 lekë dhe OE fitues "GJö SHPK.

4-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Rikonstruksion i Qendrës Tërbac", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë, ose më pak se fondi limit prej 169,717 lekë dhe OE fitues "Aö SHPK.

Për çdo procedurë të audituar, kemi si më poshtë vijon:

**I-Tenderi me objekt: òBlerje makinë”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje makinë		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.44 dt.13.09.2019	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.45. Dt 13.09.2019
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	1.E.M. - Ing 2. K.K. - Ekonomist 3. B.R.- Jurist	1.A.B.Kryetar -(Dr shërbimesh) 2.U.D. Anëtar (Financier) 3. O.V. Anëtar (Jurist)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4.166.667 leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 4,125,000 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 41,667 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 01.10.2019	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 1 OE b) Sëkualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE òM.M..ò ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 13.09.2019 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 13.09.2019, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

- Operatori ekonomik duhet të ketë eksperiencë mbi 10 (dhjetë vjeçare në tregun e automjeteve), *(kjo me qëllim për të dëshmuar seriozitetin dhe besueshmërinë e Operatorit ekonomik)*
- Eksperiencë mbi 10 (dhjetë vjeçare) për importin/eksportin e pjesëve të këmbimit Bazuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar dhe nenin 27 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ò 4.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.ò Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me ligjin, përvojën e mëparshme e ka lidhur me vitet



e regjistrimit të subjektit, duke diskriminuar operatorët ekonomikë dhe duke ulur konkurrencën.

- Sistem Menaxherial të cilësisë ISO 9001:2015/ S SH EN ISO 9001:2015
- Çertifikatë ISO 28000:2007 (Pikë servisi. Tregti me shumicë dhe pakicë e makinave dhe pjesëve të tyre. Tregti e mjeteve lundruese të çdo lloji dhe riparimi i tyre. Transport mallrash për vete dhe të tretë. Ndryshime konstruktive të mjeteve motorike tokësore dhe mjeteve ujore të çdo lloji.)
- Dëshmi aftësie Profesionale për përgjegjësin teknik të aktivitetit të autoriparimit (Kodi VII.3.B.1)
  - a) Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të motorit
  - b) Riparim dhe mirëmbajtje karrocierie
  - c) Riparim dhe mirëmbajtje impianti elektrik
  - d) Riparim dhe mirëmbajtje e gomave
  - e) Blerje dhe shitje e mjeteve me motor dhe rimorkiove
- f) Mbledhje, depozitim, shkatërrim i mjeteve rrugore ose i pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.
  - Dëshmi aftësie profesionale për përgjegjësin teknik të veprimtarisë së mjeteve rrugore me motor dhe/ose rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi (Kodi VII.3.B.2)
  - Dëshmi aftësie profesionale për përgjegjësin teknik të veprimtarisë së tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ ose rimorkiove (Kodi VII.3.B.3/a,b)
  - Shërbim karotreci 24 orë
  - Karotreci në pronësi të subjektit

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Përderisa Autoriteti Kontraktor sipas specifikimeve teknike është duke blerë një automjet me 0 (zero) kilometra dhe nuk parashikon as periudhë garancie apo mbulimi të shërbimeve të mirëmbajtjes, kërkesat për servis dhe të lidhura me to nuk kanë asnjë lidhje me objektin e kontratës. Vendosja e këtyre kriterëve thjesht ka shërbyer për kufizimin e konkurrencës, që vërtetohet nga pjesëmarrja e vetëm një operatori ekonomik.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP; Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratësò, **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe B.R. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën*

është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NHJDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe B.R. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

**-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 01.10.2019 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 03.10.2019 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se ska operator ekonomik te skualifikuar dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 04.10.2019. Vendimi i titullarit të AK datë 11.10.2019.

Njoftim fituesi datë 11.10.2019.

Kontrata me OE fitues nr. 222 prot, datë 15.10.2019 për vlerën **4,125,000** lekë pa TVSH dhe vlera 4,950,000 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues OE “M.M.” SHPK, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.**

**-Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të Kryetarit, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të kryer nga òM. M.ò SHPK, kontrata nr. 222, datë 15.10.2019. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatua se malli i kërkuar nga AK, ofruar dhe ai i lëvruar nga OE ishte sipas specifikimeve dhe dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

**II-Tenderi me objekt: òMirëmbajtje shkollash”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Mirëmbajtje shkollash</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.39 dt.30.08.2019 1.E.M. - Ing 2. K.K. - Ekonomist 3. O.V.- Jurist	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.43. Dt 30.08.2019 1 A.B..Kryetar -(Drejtor shërbim) 2.B.R.. Anëtar 3. U.D. Anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim		
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4.133.768 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,590,740 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>543,028</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 23.09.2019	<b>9.Burimi Financimit</b> <b>Te ardhurat e veta</b>	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 3 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE òJò ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 23.08.2019 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 30.08.2019, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

2.3.2 Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, e lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore duhet te përmbajë kategoritë e mëposhtme:

N.P.1 - Klasifikimi A

NP. 4 - Klasifikimi A

NP. 12 - Klasifikimi A

Dhe

N.S.1 - Klasifikimi A

N.S.12- Klasifikimi A

N.S.13- Klasifikimi A

N.S.19 - Klasifikimi A

VENDIM nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò

N.P. 1 Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale...

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik...

N.S 01 Punime për prishjen e ndërtimeve Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike...

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre...

N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë...

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Këto pika licence nuk janë të domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që përfshihen në këto pika licence. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Po ashtu kërkesa

N.P. 2- Klasifikimi B

N.P.3 - Klasifikimi B, është në kundërshtim me parashikimin ligjor sepse sipas vlerës së kontratës duhet të ishin klasifikimi A.

2.3.5 Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë të përfshirë në licensën e shoqërisë:

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo më pak se 10 Vjet, i cili të disponojë licence individuale në zbatim .

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi

teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij teknik të përfshirë në listëpagesat 1 (një) inxhinier të pajisur me Çertifikatën e Auditimit të Energjisë, sipas ligjit nr. 124/2015 "Për efikasitetin e energjisë", për të cilin duhet të paraqitet Certifikata e Auditimit të Energjisë, Diplomën e Inxhinierit dhe CV.

2.3.13 Mjetet dhe Pajisjet:

- Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Eskavator me zinxhir	1 cope	Ne pronësi ose me qira
Autovinç	1 cope	Ne pronësi ose me qira
Rrul ngjeshës	1 cope	Ne pronësi ose me qira

Në nenin 46, pika 1/b të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues.” b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, neni 26 “Kontratat për punë publike, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. “* Disa nga mjetet e mësipërme të kërkuara, nuk janë në përputhje me zërat dhe volumet e parashikuara në preventiv. Nuk ka asnjë argument teknik mbi disponueshmërinë e tipologjisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrata si p.sh. të mjeteve Eskavator me zinxhir, Autovinç, Rrul ngjeshës.

Referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 *“Për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta*

të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 23.09.2019 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 3 (tre) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 23.09.2019 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 03.10.2019. Vendimi i titullarit të AK datë 03.10.2019.

Njoftim fituesi datë 03.10.2019.

Kontrata me OE fitues nr. 221 prot, datë 15.10.2019 për vlerën **3,540,740** lekë pa TVSH dhe vlera 4,308,888 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “J” SHPK, oferta e vetme ekonomike e kualifikuar, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.**

#### **-Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të Kryetarit, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të punës të kryer nga òJò SHPK, kontrata nr. 221, datë 15.10.2019. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatua se puna dhe malli i kërkuar nga AK, ofruar dhe ai i lëvruar nga OE ishte sipas specifikimeve dhe realizuar/dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

**III-Tenderi me objekt: òNdërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.40 dt.19.08.2019	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.41. Dt 19.08.2021
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E HAPUR</b>	1.E.M.. - Ing 2 K.K. - Ekonomist 3 O.V.- Jurist	1 A.B. .Kryetar -(Drejtor shërbimesh) 2. B.R. Anëtar (Financiere) 3. U.D. Anëtar (Financier)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b>  34,868,272 leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b>  34,160,214.70 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b>  708,057.3 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 23.09.2019	<b>9.Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 2 OE b) Søkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/ GJ ShPK

#### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 19.08.2019 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 19.08.2019, nga anëtarët e NJHD.

#### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

#### **Në DT është kërkuar:**

**2.3.2** Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën **100 (njëqind)** punonjës **me kohë të plotë** pune për periudhën **Qershor 2018 - Qershor 2019**, e vërtetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2018 - Qershor 2019**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2018 - Qershor 2019**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuaranga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit tëprokurimit; dhe/ose dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicionoperatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.*

Referuar vlerës së kontratës, preventivit të punimeve, volumit të punimeve që do të kryhen, natyrës së punimeve, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm, që në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme i të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra si dhe grafiku i punimeve. Për këtë qëllim, AK duhet të hartojë për çdo zë punimi, analizë teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore dhe mjetet/ makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse, duhet të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, kërkesa për disponimin e 100 punonjësve të pasqyruar në listëpagesate shoqërisë, është një kërkesë joproporcionale dhe e pajustificuar nga autoriteti kontraktor, si dhe jo në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave òPërmiratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar ku parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Gjithashtu,

referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht nevojën mbi kërkesën për disponimin e një numri prej 100 punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore. Po ashtu kjo kërkesë nuk është në proporcion me kërkesat e tjera të autoritetit kontraktor, për sa kohë që në pikën 4 kërkon vetëm 11 specialistë + 5 inxhinierë+ 6 Manovratorë = në total 22 punonjës.

5. Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit të paktën 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, ku nga këta të jone të paktën:

c) Grupi I- 5 (pese) punonjës

d) Grupi II-5 (pese) punonjës

e) Grupi III- 3 (tre) punonjës

f) Grupi IV- 2 (dy) punonjës

g) Grupi V- 2 (dy) punonjës

Bazuar në Ligjin Nr.8734, datë 1.2.2001 ÷Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike o i ndryshuar , neni 9 ÷Formimi i punëmarrësve o : ÷Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej sajë. Në dokumentet standarte të tenderit nuk është kërkuar inxhinier elektrik, është kërkuar vetëm një elektrikistë, ndërkohë që kërkohen 17 punonjës të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik elektrik dhe madje me kategoritë IV, V që bazuar në rregulloren e dhënies së dëshmisë mundet ta marrë tekniku elektrik dhe inxhinieri elektrik. Kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet dhe vlerat e punimeve elektrike të kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës.

8. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Liçensë profesionale nga Qendra Kombëtare e licencimit (QKB) Kodi 1.2.A. për Mbrojtjen nga Zjarri.

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 ÷Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta o ndryshuar, në të cilin parashikohet që: ÷KATEGORIA I.2 SHËRBIMEVE EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE TË MBROJTJES CIVILE o.

I. Ndarja e kategorisë dhe rregulla të përgjithshme

1. Veprimtaria ÷Shërbimeve ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile o është kategoria I.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 ÷Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë o

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) ÷Shërbime ekspertize o me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit;...o vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jone në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosija e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

9. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licence nga QKB me kod III.2.A (1+2) (për shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis).

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta e ndryshuar, në të cilin parashikohet që: ÷Veprimtaria e ÷shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ÷ është kategoria III.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë[12]. 2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon: a) ÷veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis me kodin III.2.A; b) ÷veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.A 4. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2. 5. Një subjekt mund të pajiset me një licencë të kategorisë III.2.A, për një apo të dyja veprimtaritë specifike në përputhje me masën e plotësimit të kriterëve të detajuara respektive, në të njëjtën kohë ose në kohë të ndryshme.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ekspertiza në lidhje me ndikimin në mjedis të projektit është e zaturuar në fazën e projektimit. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues", për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.*

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 23.09.2019 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 3 (tre) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 04.11.2019 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se është skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Njoftim fituesi datë 04.06.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 230 prot, datë 21.11.2019 për vlerën **34,160,214.7** lekë pa TVSH dhe vlera 40,992,257.64 lekë me TVSH.



Nga 1 (një) OE pjesëmarrës ka pasur ankesa dhe konkretisht:

Ankesa nga Operatori òHò SHPK, me adresë: Bajram Curri, paraqitur nëpërmjet postes në datë 25.08.2029 dhe protokoll nr.50, datë 25.08.2020 pas së cilës ka marrë përgjigje kur sqarohet që ankesa e dërguar nuk qëndron dhe nuk është konformë ligjit.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues OE “GJ” SHPK**, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**IV-Tenderi me objekt: òRikonstruksioni i Qendrës Terbaç”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: RIKONSTRUKSIONI I QENDRES TERBAC</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.36 dt.16.08.2019	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.37. Dt 16.08.2019
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	1.E.M.. - Ing 2.K.K. - Ekonomist 3O.V. - Jurist	1. A.B. Kryetar 2. U.D. Anëtar 3. B.R. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,166,667 leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,996,950 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 169,717 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 02.09.2019	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 2 OE b) Sëkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues BOE òA.LL.ò_ShPK

#### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 16.08.2019 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 16.08.2019, nga anëtarët e NJHD.

#### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

#### **Në DT është kërkuar:**

##### **2.1.3 Drejtues teknik i pajisur me:**

- Çertifikatë 5 hapat për vlerësimin e rrezikut ne pune;
- Çertifikatë Ekspert Zjarrfikës Privat;
- Çertifikatë Auditues i brendshëm i Sistemit te menaxhimit te mjedisit;

Kërkesa që eksperti zjarrfikës privat të jetë drejtues teknik/ inxhinier është në kundërshtim me parashikimet ligjore. Referuar nenit 3, pika 29, të ligjit nr. 152/2015 òPër shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtiminò, parashikohet se: *“Ekspert zjarrfikës privat” është personi fizik dhe juridik, i certifikuar, i cili harton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kryen aktin e ekspertizës për zjarrin e rënë, kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas dispozitave të këtij ligji”, dhe nenit 49, pika 4 e këtij ligji òDrejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministritò. Gjykojmë se autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri duhet të mbante në konsideratë përcaktimet e këtyre dispozitave ligjore. Me vendosjen e këtij kriteri në kundërshtim me parashikimet ligjore është kufizuar*

konkurrenca.

**2.3.4** Operatori ekonomike duhet te këtë (5) Manovratore me Dëshmi Aftësisë Profesionale (DAP) për përdoruesit e makinerive te renda te ndërtimit dhe punimeve ne toke. te siguruar dhe te figuroj ne listëpagesat e shoqërisë për periudhën e mësipërme;

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Kërkesa për 5 Manovratore sipas pikës 2.3.4 të dokumenteve standarte të tenderit është e ekzagjuar, e barabartë me e numrin e mjeteve që si rregull këta Manovratore duhet të drejtojnë, ndërkohë që jo të gjitha mjetet do kryejnë punime në të njëjtën kohe, dhe ndikon drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT të përbërë nga NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., K.K. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.*

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 02.09.2019 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 (katër) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 13.09.2019 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 13.09.2019. Vendimi i titullarit të AK datë 24.09.2019.

Njoftim fituesi datë 24.09.2019.

Kontrata me OE fitues nr. 218 prot, datë 14.10.2019 për vlerën **3,996,950** lekë pa TVSH dhe vlera 4,796,340 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “A.LL.” SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:**

Bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publik ò i ndryshuar :ò Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si

një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit. ÷ Bazuar në nenin 74 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar : ÷ Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. ÷

Në kontratën e bashkëpunimit nr.1911 rep.nr.700/2 kol. Datë 31.08.2019 , në pikën 2. Përcaktohet përqindja e punime (50% secila) që do të kryejë secili operator, por nuk përcaktohen elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Ndarja e punimeve nuk i është bashkëlidhur as si Aneks kontratës, rrjedhimisht kjo kontratë bashkëpunimi është e pavlefshme referuar dispozitave sa më sipër.

Edhe në Formularin e Ofertës të paraqitur nuk është specifikuar cilat punime do të kryeje secili nga operatorët. Edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem mungon ky dokument edhe si dokument i veçuar. Nisur nga ky fakt, në bazë të paragrafit 3 të nenin 74 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar : ÷ Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. ÷, si është realizuar vlerësimi i kapaciteteve teknike të secilit anëtar ????

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷ Për prokurimin publik, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*, ( Nuk janë plotësuar kushtet e veçanta)

Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të LPP, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Operatori ekonomik A SHPK dhe operatori ekonomik LL. SHPK nuk e ka plotësuar saktë Shtojcën 1/1 duke klikuar alternativën 6 .a edhe pse ka marrë pjesë si bashkim i operatorëve ekonomik dhe duhet zgjedhur alternativa 6.b.

Dokumentacioni i paraqitur si punë e ngjashme është i pasaktë dhe i paplotë.

Kontrata e Sipërmarrjes e lidhur me Bashkinë Roskovec nr.1522 prot. Datë 03.07.2021 me objekt ÷ Sistemi i fshatrave ÷ është e lidhur vetëm me operatorin ekonomik A SHPK, ndërkohë që aktet e tjera përmendin si palë bashkimin e operatorëve A SHPK dhe LL SHPK. As në Kontratë, as në Aktin e Kolaudimit dhe as në Formularin e vlerësimit nuk

evidentohet përqindja dhe elementët konkretë të realizuar nga secili operator, duke bërë të pamundur gjykimin mbi punën e ngjashme. Mungojnë faturat tatimore të shitjes.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE "A.LL.", SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*".

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë "A.LL. KONSTRUKSION", nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK zhvillimin e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe U.d. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe Titullarin e Autoritetit Kontraktor J.G..

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr120/5, datw 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Mbi konstatimet e grupit të KLSH për procedurat e prokurimit të realizuara në vitin 2019

**Sqarimi i grupit të KLSH:** Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit pjesërisht qëndrojnë dhe kanë argumentim dhe pjesa tjetër nuk qëndron, duke mos u marrë në konsideratë. Konkretisht për çdo procedurë kundërshtimet që janë marrë apo jo në konsideratë, duke mos u bërë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten:

-Për procedurën e prokurimit *Blërje makineö*, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për eksperiencën prej 10 vjet, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për Licencën Kod VII.3.B.1, si dhe kriteret e shtojcës nr. 9.

-Për procedurën e prokurimit *Mirëmbajtje shkollashö*, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri për inxhinier mjedisi me eksperiencë pune mbi 10 vjet, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për numrin e punonjësve të kërkuar dhe pajisur me certifikata dhe dëshmi kualifikimi.

-Për procedurën e prokurimit *Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe stacioni i pompimit, lagjja Potamö*, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për numrin e përgjithshëm të punonjësve prej 100 veta, si dhe kriteri për 17 punonjës më dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për 2 punonjës teknik ndërimi, kriteri për kategorinë e licencës Kodi III.2.B dhe III.1.A, si dhe kriteri për dëshminë për mjetet dhe pajisjet teknike

-Për procedurën e prokurimit *Rikonstruksion i Qendrës Tërbaçö*, është marrë në konsideratë vendosja e kriterëve sipas DST për rastin e bashkimit të OE, si dhe nuk është marrë në konsideratë pretendimi i KVO për kontratën e bashkëpunimit ndërmjet OE nr. 1991 rep dhe 700/2 kol, datë 31.08.2019, pasi dokumenti i paraqitur në cilësinë e provës është i pjesshëm, duke mos vërtetuar pretendimin se ai ka të përcaktuar përqindjen e bashkëpunimit dhe zërat e punës.

## **Auditim mbi prokurimet publike për periudhën 01.01.2020-31.12.2020”**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2020 ó 31.12.2020;

Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;

DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;

Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;

Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);

Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/mallrave dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secila përfituese e investimit apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka Bashkia Himarë, referuar në disponimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, nenet 23 dhe 28; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.01.2020 ó 31.12.2020, auditoi 17 procedura me vlerë nga 3 milion deri në 170 milion lekë.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varjon nga 1 deri në 3 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesim të pakët të OE kjo edhe për faktin se kriteret që aplikohen nga AK, përgjithësisht nuk janë në përputhje me ligjin.

-Nga auditimi i 16 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 òObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 òParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ò Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveò, ku;

a- Në 11 (njëmbëdhjetë) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b- Në 5 (pesë) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

Procedurat e audituara janë:

1-Është audituar procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "*Blerje karburanti*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë, me marzhë fitimi 7.8% dhe BOE fitues "E.D.ò SHPK.

2-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse*", me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë, ose më pak se fondi limit prej 345,640 lekë dhe OE fitues "Cò SHPK.

3-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve rurale*", me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë, ose më pak se fondi limit prej 74,703 lekë dhe OE fitues "Aò SHPK.

4-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Mirëmbajtje Shkollash", me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë, ose më pak se fondi limit prej 416,558 lekë dhe OE fitues "Jö SHPK.

5-Është audituar procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "Ndërtimi i postit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil", me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë, ose më pak se fondi limit prej 35,000 lekë dhe OE fitues "Aö SHPK.

6-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Ndriçim i rrugës Dhrale", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 6,466,820 lekë, ose më pak se fondi limit prej 199,847 lekë dhe BOE fitues "GJ. & A SHPK.

7-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Ndriçim Led Himarë", me vlerë të prokuruar 8,328,400 lekë dhe vlerë kontrate 7,895,200 lekë, ose më pak se fondi limit prej 433,200 lekë dhe OE fitues "Iö SHPK.

8-Është audituar procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "Përmirësim I sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë", me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë, ose më pak se fondi limit prej 2,368,314 lekë dhe OE fitues "GJ.ö SHPK.

9-Është audituar procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "Rikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë", me vlerë të prokuruar 41,666,379 lekë dhe vlerë kontrate 40,613,118 lekë, ose më pak se fondi limit prej 1,053,261 lekë dhe OE fitues "GJ.ö SHPK.

10-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Rikonstruksion i Kopshteve", me vlerë të prokuruar 4,164,160 lekë dhe vlerë kontrate 3,911,660 lekë, ose më pak se fondi limit prej 252,500 lekë dhe OE fitues "Jö SHPK.

11-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë, ose më pak se fondi limit prej 1,316,527 lekë dhe BOE fitues "J.SH.ö SHPK.

12-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë XHepe Bolenë", me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë, ose më pak se fondi limit prej 365,086 lekë dhe OE fitues "Aö SHPK.

13-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Rikonstruksion i Urrës në lagjen Lengë Vranisht", me vlerë të prokuruar 10,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 9,140,533 lekë, ose më pak se fondi limit prej 859,467 lekë dhe OE fitues "Bö SHPK.

14-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Shërbimi i pastrimit për zonat turistike", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë, ose më pak se fondi limit prej 138,762 lekë dhe OE fitues "K.G.ö SHPK.

15-Është audituar procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç", me vlerë të prokuruar 82,922,375 lekë dhe vlerë kontrate 78,282,827 lekë, ose më pak se fondi limit prej 4,639,548 lekë dhe OE fitues "Cö SHPK.

16-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "Ujësjiellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë, ose më pak se fondi limit prej 42,329 lekë dhe OE fitues "Lö SHPK.

Për çdo procedurë të audituar, kemi si më poshtë vijon:

**I-Tenderi me objekt: öBlerje karburant", me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje karburant		
1.Urdhër Prokurimi Nr	Datë	3.Hartuesit e Dokumenteve të
		4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

<b>2. Lloji Procedurës së Prokurimit</b> E hapur	<b>Tenderit</b> Urdhër Nr. ___ dt. __. __. 2020 1.E.M. - Ing 2.B.R. - Ekonomist 3.O.V. - Jurist	Urdhër Nr. __. Dt __. __. 2020 1.A.B. Kryetar -(Drejtor/Sherbimesh) 2.U.D. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,333,333leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 7,8% <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 10.03.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. <u>1</u> OE b) Së kualifikuar <u>x</u> OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE E.D.

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 25.01.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 04.02.2020 nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe çënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

### **Në DT është kërkuar:**

- Operatori Ekonomik duhet të disponojë ne pronësi te vet ose me qira te paktën 2 (dy) mjete autobot me kapacitet deri ne 1000 litra dhe një mjet autobot me kapacitet deri në 5000 lt. Per te provuar disponimin e tyre (ne pronësi) shoqëria duhet te dorëzojë librezën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Autobotet duhet te jene te regjistruar ne Ekstraktin e Q.K.B-se se Operatorit Ekonomik.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk argumentohet arsyeja pse është e nevojshme/ domosdoshme disponimi i këtyre mjeteve, pse tre mjete dhe pikërisht me këto kapacitete ????

Përcaktimi i kapacitetit mbajtës ...për dy mjete autobot deri ne 1000 litra dhe i autobot 5000 litra, është një kriter i cili kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike ne tender dhe diskriminues/ favorizues për sa kohe qe për autoritetin kontraktor e mjaftueshme është qe operatori ekonomik te marre përsipër furnizimin e sasisë se karburantit, sipas kërkesës dhe ne vendin e caktuar.

Kriteri i mësipërm, nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese,

natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., B.R. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., B.R. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 10.03.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 10.03.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 18.03.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 19.03.2020

Njoftim fituesi datë 19.03.2020..

Kontrata me OE fitues nr. 21 prot, datë 07.04.2020 për vlerën **8.333.333** lekë pa TVSH dhe vlera 10.000.000 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “E.D.” SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:**

- Në marrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë nr.800 rep.nr.273 kol. Datë 27.05.2019, në neni 9 parashikohet mundësia e nënkontraktimit, ndërkohë që në dokumentet standarde të procedurës nuk lejohet nënkontraktimit.
- Vizualisht, prima facia, marrëveshjes dhe prokurës së bashkëpunimit i mungon vula e thatë e noterit.
- Sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit duhet që dokumentet e dorëzuara të jenë origjinalë ose kopje të noterizuar. Deklaratat e dorëzuara nga bashkimi i operatorëve òDò dhe òEò janë fotokopje, përfshirë edhe formularin e ofertës.

Bashkimi i operatorëve òDò dhe òEò nuk kanë plotësuar saktë Shtojcë 1/1 sepse nuk kanë klikuar asnjë nga alternativat te pika 6.

*“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të LPP, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”.*

Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të neni 53 të LPP , vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

- Nuk plotëson kriterin: *òVërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.* Vërtetimet e paraqitura nga të dy operatorët janë fotokopje.
- Dokumentacioni i mjeteve është fotokopje, mungon një autobot sepse janë paraqitur 2 nga 3 të kërkuar.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE



“D. & E.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 të *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet *“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “D.& E.”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK, ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, K.K. dhe U.d. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor J.G.**

**II-Tenderi me objekt:** *“Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse”*, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji Procedurës Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.05 dt.21.04.2020 1.E.M. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V.- Jurist	Urdhër Nr.06. Dt 21.04.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2.B.R. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,345,612leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 7,999,972leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 345,640lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 04.05.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta + grante	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr. 1 OE b) Sëkualifikuar <u>  x  </u> OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE C ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 17.04.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 21.04.2020. nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

- Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kodi III.7.A LICENCE: *“Shërbime profesionale për projekte. Shërbime profesionale për zbatime (Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota) e diktuar nga nevoja për të siguruar një mjedis të pastër turistik, edhe pse në kushtet e koronavirusit COVID 19 në vend.*

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 *“Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: “KATEGORIA II.7 SHËRBIME TË EKSPERTIZËS DHE/OSE PROFESIONALE LIDHUR ME BURIMET MJEDISORE BAZË*

1. Veprimtaria e shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë është kategoria III.7 e Shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 *“Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.”*

2. Kategoria e kësaj veprimtarie specifikohet në dy nënkategori si vijon:

a) òshërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotatò, me kodin III.7.Aò, vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

dh. Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshire në liçensën e shoqërisë, me eksperience pune minimumi 10 vite dhe të deklaroje se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, CV, Libreze pune (përkatëse) si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Në bazë të Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 òPër Zbatimin e punimeve të ndërtimitò pika 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të përvetuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Kriteri i mësipërm bien ë kundërshtim me këtë parashikim ligjor. Kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimiò, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

62.5 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamionë vetëshkarkues peshe neto 2.83 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamionë vetëshkarkues peshe neto 4.4 t	1 copë	Pronësi ose me qira
Fadrome 6 t	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamionçinë peshe neto 2.3 t	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot Uji peshe neto 7.8 t	1 copë	Pronësi ose me qira

Në nenin 46, pika 1/b të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: òOperatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues.ò b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;ö

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, neni 26 òKontratrat për punë publikeò, pika 5 përcaktohet: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ò Numri i mjeteve të mësipërme me tonazhet e kërkuara fikse , nuk është në përputhje me zërat dhe volumet e parashikuara në preventiv. Ky numër i mjeteve të kërkuara, është i ekzagjeruar dhe i pajustificuar nga autoriteti kontraktor, kjo evidentuar edhe në procesverbalin òPër hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Nuk ka asnjë argumentim teknik mbi disponueshmërinë e tipologjisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka sjellë asnjë analizë teknike për çdo zë punimi, për të justifikuar përdorueshmërinë e tyre sipas proceseve të punës së kërkuar në preventiv. Referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe ***ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre***

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratrat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratrat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat ***ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre****

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 04.05.2020i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1(një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 05.05.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 05.05.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 15.05.2020

Njoftim fituesi datë 15.05.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 57 prot, datë 20.05.2020 për vlerën **7.999.972** lekë pa TVSH dhe vlera 9.599.966 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** BOE “C” SHPK, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

- Operatori ekonomik òCö SHPK nuk plotëson kriterin dëshmi për mjetet dhe pajisjet sepse Fadroma e paraqitur nga ky operator nuk ka dokumentacionin e kërkuar për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “C”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 òShqyrtimi i ofertaveö të ligjit 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikö, i ndryshuar ku citohet òAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “C”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor J.G..**

**III-Tenderi me objekt:** òMirëmbajtje e rrugëve rurale”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Mirëmbajtje e rrugëve rurale</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. LlojiProcedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.42 dt.01.10.2020 1.E.M. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V. - Jurist	Urdhër Nr.47. Dt 01.10.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2.K.K. Anëtar 3.B.R. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,992,053leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 4,917,350leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>74,703lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 09.11.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr.2 OE b) Søkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE A ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 10.09.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 01.10.2020, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, konkretisht:

**Në DT është kërkuar:**

**2.3.2** Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, e lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore duhet te përmbajë kategoritë e mëposhtme:

N.P. 2- Klasifikimi A

N.P. 9- Klasifikimi A  
N.S.5 - Klasifikimi A  
N.S. 6- Klasifikimi A  
N.S.19- Klasifikimi A

VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò

N.P. 2 Ndërtime civile e industriale Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje...

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme...

N.S 6 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën...

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jodriçuese, vertikale, horizontale...

N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material ...

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Këto pika licence nuk janë të domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që përfshihen në këto pika licence. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

### **2.3.5 Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë të përfshirë në licencën e shoqërisë:**

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi (me specialitet ndërtime rrugë-ura) i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo më pak se 10 Vjet,
- 1(një) inxhinier ndërtimi

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimiò, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për vendosjen e dy inxhinierëve të ndërtimit për këtë objekt është e ekzagjeruar. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre*

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 09.11.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 (dy) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 16.11.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 24.11.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 24.11.2020

Njoftim fituesi datë 24.11.2020

Kontrata me OE fitues nr. 250 prot, datë 25.11.2020 për vlerën **4.917.350** lekë pa TVSH dhe vlera 5.900.820 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues OE “A” SHPK,** pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik i kualifikuar nuk plotëson kriterin 2.3.9 Mjetet dhe Pajisjet: Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës Grejder 1 Copë, sepse për Grejderin e paraqitur nuk ka dorëzuar dokumentacionin:

- É certifikata e pronësisë;
- É leja e qarkullimit;
- É certifikata e kontrollit teknik;
- É vërtetimi i pagesës për taksat vjetore;

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “A.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 òShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet òAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “A”, **nuk** është në kushtet e plotësismit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor J.G..

**IV-Tenderi me objekt: “Mirëmbajtje shkollash”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Mirëmbajtje shkollash</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.27 dt.13.07.2020 1.E.M.- Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V. - Jurist	Urdhër Nr.28. Dt13.07.2020 1.A.B. .Kryetar -(P. Finance) 2..B.R. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,166,118leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,749,560leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>416,558</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 27.07.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr. <b>1OE</b> b) Sëkualifikuar x OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE J ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 26.06.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 13.07.2020 nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

**2.3.2** Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, e lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

N.P.1 - Klasifikimi A

NP. 12 - Klasifikimi A

Dhe

N.S.5 - Klasifikimi A

N.S. 6- Klasifikimi A

NS.7 - Klasifikimi A

N.S.18- Klasifikimi A

N.S.19- Klasifikimi A

VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò.

N.P. 1 Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe

vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik...

N.S 01 Punime për prishjen e ndërtimeve Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje...

N.S 05 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ...

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jodriçuese, vertikale, horizontale...

N.S 07 Barriera dhe mbrojtje rrugore Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluesit e zhurmat, barrierat...

N.S - 18 Punime topogjeodezi Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezi në objekte inxhinierike...

S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë ...

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Këto pika licence nuk janë të domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që përfshihen në këto pika licence. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

### **2.3.5 Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë të përfshirë në licencën e shoqërisë:**

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo më pak se 10 Vjet, i cili të disponojë licence individuale në zbatim dhe në projektim.
- 1(një) Inxhinier Topograf
- 1(një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë: Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për një Drejtues teknik inxhinier mjedisi, gjeolog dhe topograf nuk duhet. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulojnë nga këta inxhinier. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Per secilin Inxhinier të listuar më sipër, të paraqitet diplome, kontrate noteriale pune, CV, libere pune. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e kërkuar në pikën 2.3.3, janë të pa angazhuar në kontrata të tjera. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.



Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne përputhje me nenin 13, pika 3, germa öaö te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, öPer Prokurimin Publikö.

Operatori ekonomik duhet te këtë pjese te stafit:

- Restaurator 1 (një) i pajisur me liçensë personale restaurimi për kategoritë AZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 i cili te jete ne listëpagesat e shoqërisë ne gjithë periudhën e përshkruar me lart

- Arkitekt 1(një) te jete ne listëpagesat e shoqërisë ne gjithë periudhën e përshkruar me lart  
Te këtë ne listëpagesat ose te kontraktuar

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventivit, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e një restauratori i pajisur me liçensë personale restaurimi për kategoritë AZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 dhe arkitektit është e pabazuar dhe vendosja e këtij kriteri kufizon konkurrencën në mënyrë të padrejtë. Asnjë nga objektet që janë pjesë e projektit nuk është monument kulture dhe si rrjedhim nuk është e nevojshme prania e një restauratori të liçensuar.

- Një inxhinier mjedisi **vlerësues i ndikimit ne mjedis** i cili te jete ne listëpagesat te paktën dy muajt e fundit

Në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011 öPër vlerësimin e ndikimit në mjedisö, neni 2, öObjektiö, dhe nenin 3 öFusha e zbatimitö është përcaktuar: öObjekti i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësisve, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.ö

öKy ligj zbatohet për projektet e propozuar, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendimmarrjes së tyre.ö

Në nenin 8 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 öPër Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisö, i ndryshuar, parashikohet se öNeni 8 Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

a) projektet e listuar në shtojcën II, bashkëlidhur;

b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuar në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;

c) projektet e listuar në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë se dy vjet;

ç) projektet e listuar apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projektö.

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Gjykojmë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kriterin e mësipërm gjykojmë të ndalemi edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të

LPP-së. Në rastin konkret, konstatohet se, referuar specifitimeve teknike dhe termave të referencës, kërkesa e autoritetit kontraktor që Inxhinieri Mjedisi duhet të disponojë Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet, bazuar në objektin e prokurimit dhe në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si më sipër cituar.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre*

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre*

**-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 27.07.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE ka marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 27.07.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 05.08.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 05.08.2020

Njoftim fituesi datë 05.08.2020

Kontrata me OE fitues nr. \_\_ prot, datë \_\_.08.2020 për vlerën **3.749.560** lekë pa TVSH dhe vlera 4.499.472 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues OE “J” SHPK**, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**V-Tenderi me objekt:** *“Ndërtimi i Pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil”, me këto të dhëna:*

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndërtimi i Pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.40 dt.01.10.2020 1.A. G. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V.- Jurist	Urdhër Nr. __. Dt __. __.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2 .B.R. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 3,750,000leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,715,000leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>35,000</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 16.11.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr.2 OE

		b) Sëkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE A. ShPK
--	--	---

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 01.10.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 01.10.2020 nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

**2.3.2** Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, e lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore duhet te përmbajë kategoritë e mëposhtme:

N.S.5 - Klasifikimi A

N.S. 6- Klasifikimi A

N.S.19- Klasifikimi A

VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 ÷Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi÷.

N.S 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën...

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jodriçuese, vertikale, horizontale...

N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën...

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Këto pika licence nuk janë të domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që përfshihen në këto pika licence. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te këtë numrin e nevojshëm për zbatimin e kontratës. Një punësim mesatar prej 40 Punëtoresh për periudhën Mars 2020 deri Shtator 2020 te vërtetuar me:

***Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:***

***Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:***

- h) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- i) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- j) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.*

Referuar vlerës së kontratës, preventivit të punimeve, volumit të punimeve që do të kryhen, natyrës së punimeve, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm, që në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme i të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra si dhe

grafiku i punimeve. Për këtë qëllim, AK duhet të hartojë për çdo zë punimi, analizë teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore dhe mjetet/ makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse, duhet të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate. Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, kërkesa për disponimin e 40 punonjësve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, është një kërkesë joproporcionale dhe e pajustificuar nga autoriteti kontraktor, si dhe jo në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullave të prokurimit publik të ndryshuar ku parashikohet se: *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve."* Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht nevojën mbi kërkesën për disponimin e një numri prej 40 punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

### **2.3.5 Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet të ketë të përfshirë në licensën e shoqërisë:**

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo më pak se 10 Vjet,

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: *o*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese,

natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.G., U.d. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**  
Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A. G., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 16.11.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 (dy) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 23.11.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 0 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 14.11.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 14.11.2020

Njoftim fituesi datë 14.11.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 320 prot, datë 21.12.2020 për vlerën **3.715.000** lekë pa TVSH dhe vlera 4.458.000 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “A” SHPK**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik fitues nuk duhet të ishte kualifikuar sepse nuk plotëson kriterin 2.3.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(një) mjek ndërmarrje të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 òPër Masat e Veçanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e Kontratës së Punës së mjekut, diplomën, licencën e ushtrimit të profesionit dhe CV. Dhe të jete në listëpagesat për periudhën e kërkuar.

Liçenca e mjekut S. Dh. është e pavlefshme. Liçenca është lëshuar më datë 23.12.2013 dhe duhet të ishte rinovuar brenda 5 viteve.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “A.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 òShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet òAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “A”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..**

**VI-Tenderi me objekt:** òNdriçimi i rrugës Dhrale”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndriçimi i rrugës Dhrale</b>
---

<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.43dt.01.10.2020 1.A. G.- Ing 2.U.D. - Ekonomist 3. O.V. - Jurist	Urdhër Nr.49. Dt 01.10.2020 1. A.B. Kryetar -(P. Finance) 2. B.R. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 6,666,667leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 6,466,820leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>199,847 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes të tenderit</b> 05.11.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr. 1 OE b) Sëkualifikuar X OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE GJ./A. ShPK

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 05.11.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 05.11.2020 nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

#### **Në DT është kërkuar:**

2. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Liçensë profesionale nga Qendra Kombëtare e licencimit (QKB) Kodi 1.2.A. për Mbrojtjen nga Zjarri .

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 òPër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtao e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: òKATEGORIA I.2 SHËRBIIMEVE EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE TË MBROJTJES CIVILE

I. Ndarja e kategorisë dhe rregulla të përgjithshme

1. Veprimtaria òShërbimeve ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civileo është kategoria I.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 òPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëo

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) òShërbime ekspertizeo me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit;...ò vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate. Ekspertiza konsiderohet e ezauruar në fazën e projektimit.

3. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licence nga QKB me kod III.2.A (1+2) (për shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ).

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 òPër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtao e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: òVeprimtaria e òshërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ò është kategoria III.2 e

shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 òPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë[12]. 2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon: a) òveprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedisë me kodin III.2.A; b) òveprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedisë, me kodin III.2.B

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.A 4. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2. 5. Një subjekt mund të pajiset me një licencë të kategorisë III.2.A, për një apo të dyja veprimtaritë specifike në përputhje me masën e plotësimit të kriterëve të detajuara respektive, në të njëjtën kohë ose në kohë të ndryshme. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ekspertiza në lidhje me ndikimin në mjedis të projektit është e zaturuar në fazën e projektimit. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 85 (tetëdhjetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, Manovratorë, stafi teknik) për periudhën Janar 2020 ó Qershor 2020, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2019 - Janar 2020.
- b. Listë pagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2019 - Janar 2020.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

***Në nenin 26, pika 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:  
Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:***

- k) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- l) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- m) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.*

Referuar vlerës së kontratës, preventivit të punimeve, volumit të punimeve që do të kryhen, natyrës së punimeve, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm, që në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra si dhe grafiku i punimeve. Për këtë qëllim, AK duhet të hartojë për çdo zë punimi, analizë teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore dhe mjetet/ makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse, duhet të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, kërkesa për disponimin e 85 punonjësve të pasqyruar në listëpagesate shoqërisë, është një kërkesë joproportionale dhe e pajustifikuar nga autoriteti kontraktor, si dhe jo në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr.9643

datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave òPërmiratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar ku parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”* Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht nevojën mbi kërkesën për disponimin e një numri prej 85 punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

2.3.4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar Staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë si Drejtues Teknik në Liçensën e shoqërisë, si më poshtë:

- o Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- o Inxhinier Ndërtimi 2 (dy)
- o Inxhinier Elektronik 1 (një)
- o Arkitekt 1 (një)

Kriteri i mësipërm nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, gjykojmë se, kriteri lidhur me disponimin e 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi duke shqyrtuar volumet e punimeve të ndërtimit si dhe duke konstatuar që pjesa tërësore e punimeve janë punime elektrike të cilat do të mbikëqyren nga inxhinierët elektrik, dhe AK ka kërkuar dy drejtues teknik elektrik. Kërkesa për drejtues teknik inxhinier hidroteknik, elektronik dhe arkitekt, nuk justifikohet sepse nuk ka zëra punimesh që e kanë të nevojshme praninë e inxhinierëve të këtij profili.

1. Operatorët Ekonomik duhet të këtë në stafin e tij teknik të punësuar të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 ó Qershor 2020, të shoqëruar me kontrate pune, diplome, stafin inxhinierik mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) Topograf,

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e tre inxhinierëve të ndërtimit në total, dhe kërkesa për 4 (katër) inxhinierë elektrik dhe 2 (dy) inxhinierë topograf në total është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet e kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës. Punimet realizohen brenda një objekti, kantieri dhe duke marrë në konsideratë edhe kohëzgjatjen e kontratës dhe grafikun e punimeve nuk justifikohet prezenca e një numri të tillë inxhinierësh në kantier.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor me kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi kualifikim të sigurimit teknik të lëshuara nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listëpagesat për periudhën Janar 2020- Qershor 2020, për minimumi:

- 2 (dy) teknik ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier ó Auditues energjie (i pajisur me òCertifikate për auditimin e energjisë), duhet të këtë këto dokumente provues: Kontrata e punës e vlefshme, Certifikata (Dip) për efikasë e energjisë. Duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar 2020 ó Qershor 2020



Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për një Auditues Energjie nuk duhet. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që kërkojnë shërbimin e audituesit të energjisë. Sipas ligjit Nr.124/2015 për eficientësinë e energjisë: Audituesi energjetik është një person fizik ose juridik i licencuar për të kryer auditime energjetike.

Sipas ligjit nr. 116, datë 10.11.2016 për Performancën e Energjisë në Ndërtesa ose Certifikimi i performancës së energjisë së ndërtesës është procesi, i cili mundëson lëshimin e certifikatës së performancës së energjisë për një ndërtesë ekzistuese ose për një njësi të një ndërtese ekzistuese apo që do të ristrukturohet apo do të rinovohet.

Vendosja e këtij kriteri nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

- 1 (një) inxhinier i pajisur me certifikatë për vlerësimin e Ndikimit në Mjedisë, të vërtetuar me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, kontratë pune të vlefshme, diplomë, i cili të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2019 - Janar 2020.

Kriteri është dublim sepse është kërkuar Drejtuesi teknik Inxhinier Mjedisit me këtë certifikatë dhe është e mjaftueshme për realizimin e kontratës.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.G., U.d. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues", për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A. G., U.d. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre*

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 05.11.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1(një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 09.11.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 17.11.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 17.11.2020

Njoftim fituesi datë 17.11.2020

Kontrata me OE fitues nr.285 prot, datë 01.12.2020, për vlerën **6.466.820** lekë pa TVSH dhe vlera 7.760.184 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “GJ. & A.” SHPK**, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Bazuar në nenin 44 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, ÷Për prokurimin publikë i ndryshuar: ÷Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit. ÷ Bazuar në nenin 74 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar : ÷ Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. ÷

Në kontratën e bashkëpunimit nr.1078 rep.nr.340/3 kol. Datë 27.10.2020 , në pikën 2. Përcaktohet përqindja e punime (90% me 10 % secila) që do të kryejë secili operator, por nuk përcaktohen elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Ndarja e punimeve nuk i është bashkëlidhur as si Aneks kontratës, rrjedhimisht kjo kontratë bashkëpunimi është e pavlefshme referuar dispozitave sa më sipër.

Edhe në Formularin e Ofertës të paraqitur nuk është specifikuar cilat punime do të kryeje secili nga operatorët. Edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistem mungon ky dokument edhe si dokument i veçuar. Nisur nga ky fakt, në bazë të paragrafit 3 të nenin 74 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar : ÷Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. ÷, si është realizuar vlerësimi i kapaciteteve teknike të secilit anëtar?

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publikë, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”*, ( Nuk janë plotësuar kushtet e veçanta)

Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të LPP, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet

të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE "GJ. & A.", SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 të *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet *“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë "GJ. & A.", nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..

### **-Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të Kryetarit, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të kryer nga GJ. & A. SHPK, kontrata nr. 285, datë 02.12.2020. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatua se malli i kërkuar nga AK, ofruar dhe ai i lëvruar nga OE ishte sipas specifikimeve dhe dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

**VII-Tenderi me objekt:** "Ndriçimi me llampa Led i rrjetit rrugor Himarë", me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ndriçimi me llampa Led i rrjetit rrugor Himarë</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.17 dt.26.05.2020 1.E.M. - Ing 2. U.D. - Ekonomist 3.O.V.- Jurist	Urdhër Nr.18. Dt 26.05.2020 1.A.B. Kryetar -(Drejtor shërbimesh) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3.B.R. Anëtar (Financiere)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,328,400leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 7,895,200leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>433,200 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 06.07.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 7 OE b) Sëkualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 2 OE ç) Shpallur Fitues OE I. ShPK

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, është i argumentuar dhe nuk cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar.

**Lidhur me OE të shpallur fitues OE "I" SHPK,** rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

### **-Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të Kryetarit, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të kryer nga GJ. & A. SHPK, kontrata nr. 180, datë 24.09.2020. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatua se malli i kërkuar nga AK, ofruar dhe ai i lëvruar nga OE ishte sipas specifikimeve dhe dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

**VIII-Tenderi me objekt:** "Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë", me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, Faza II, Gjilek, Kondraq dhe Palasë</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>

<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	<b>Tenderit</b> Urdhër Nr.51 dt.26.10.2020 1.E.M.- Ing 2. U.D. - Ekonomist 3. O.V. - Jurist	Urdhër Nr.52. Dt 26.10.2020 1. A.B.. Kryetar -(Drejtor shërbimesh) 2.K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. B.R. Anëtar (Financiere)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 166,666,667leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 164,298,352.30 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>2,368,314.7</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 02.12.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Grant	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. <b>3 OE</b> b) Sëkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE ç) Shpallur Fitues OE GJ._Shpk

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 26.10.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 26.10.2020, nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

#### **Në DT është kërkuar:**

5.Një punësim mesatar i të paktën 250 (dyqind e pesëdhjetë) personave, për periudhën Janar - Shtator 2020 të vërtetuar me;

Në nenin 26, pika 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- n) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- o) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit tëprokurimit; dhe/ose*
- p) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicionoperatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”*

Referuar vlerës së kontratës, preventivit të punimeve, volumit të punimeve që do të kryhen, natyrës së punimeve, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm, që në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Përcaktimi i numrit të punonjësve, duhet të vijë pas një analize të hollësishme i të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra si dhe grafiku i punimeve. Për këtë qëllim, AK duhet të hartojë për çdo zë punimi, analizë teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore dhe mjetet/ makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve dhe, mbi bazën e analizave përkatëse, duhet të përcaktohet numri minimal i punonjësve të domosdoshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate. Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, kërkesa për disponimin e 250 punonjësve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, është një kërkesë joproporcionale dhe e pajustificuar nga autoriteti kontraktor, si dhe jo në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave òPërmiratimin e rregullave të prokurimit publikò të ndryshuar ku parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që

*duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*” Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, aktit mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht nevojën mbi kërkesën për disponimin e një numri prej 250 punonjësish si dëshmi të fuqisë punëtore.

6. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar Staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1. Inxhinier elektronik 1 (një)

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin një inxhinieri elektronik, është përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi ka zëra punimesh në preventiv që kërkojnë mbikëqyrje nga ky profil inxhinieri. Si rrjedhojë ky kriter është kufizues ndaj konkurrencës.

9. Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar (një) Inxhinier ó Auditues energjie (i pajisur me òCertifikate për auditimin e energjisë), *duhet të ketë këto dokumente provues: Kontrata e punës e vlefshme, Certifikata (Dip) për efikasitetin e energjisë. Duhet të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar - Shtator 2020.*

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për një Auditues Energjie nuk duhet. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që kërkojnë shërbimin e audituesit të energjisë. Sipas Ligjit Nr.124/2015 òPër efikasitetin e energjisë: òAuditues energjetikò është një person fizik ose juridik i licencuar për të kryer auditime energjetike.

Sipas Ligjit Nr. 116, datë 10.11.2016 òPër Performancën e Energjisë në Ndërtesaò òCertifikimi i performancës së energjisë së ndërtesësò është procesi, i cili mundëson lëshimin e certifikatës së performancës së energjisë për një ndërtesë ekzistuese ose për një njësi të një ndërtese ekzistuese apo që do të ristrukturohet apo do të rinovohet.

Vendosja e këtij kriteri nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

16. Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitetet, kontratat e nevojshme mbi zbatimin e planit të menaxhimit të monumenteve të natyrës që ka lidhje me projektin dhe autorizimet përkatëse.

Kërkesa është formuluar në mënyrë evazive. Autoriteti kontraktor nuk ka ngarkuar në sistem dokumentacioni i cili provon statusin si monument natyre të territorit ku zhvillohet projekti, si rrjedhim nuk mund të përcaktohet cilat janë autorizimet ????. Këto autorizime janë në emër të subjektit??? Apo duhet që operatorin të marrë autorizim për zbatimin e projektit në mënyrë specifike??? Autorizimi duhet të jetë i dhënë nga cili autoritet? A nuk është marrë miratimi nga ana e Ministrisë së Mjedisit apo institucionit kompetent për miratimin dhe lejin e implementimit të projektit nga ana e autoritetit?

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

20. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencat/Lejet e mëposhtme:

a. Licensë nga QKB me Kod 1.2.A. për Mbrojtjen nga Zjarri .

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 òPër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të

përbashkëtao e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: **ÖKATEGORIA I.2 SHËRBIMEVE EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE TË MBROJTJES CIVILE**

**I. Ndarja e kategorisë dhe rregulla të përgjithshme**

1. Veprimtaria öShërbimeve ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civileö është kategoria I.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 öPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëö

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) öShërbime ekspertizeö me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit;...ö vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

**II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.A** 4. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2. 5. Një subjekt mund të pajiset me një licencë të kategorisë III.2.A, për një apo të dyja veprimtaritë specifike në përputhje me masën e plotësimin të kriterëve të detajuara respektive, në të njëjtën kohë ose në kohë të ndryshme.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ekspertiza në lidhje me ndikimin në mjedis të projektit është e zaturuar në fazën e projektimit. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

b. Licence nga QKB me Kod III.2. B öPër Grumbullim dhe Transportim i mbetjeve të parrezikshme inerte dheraveö.

c. Leje mjedisore lëshuar nga QKB Kodi III.1.A. öPer trajtimin e ujerave të zezaö

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

d. Leje mjedisore lëshuar nga QKB Kodi III.1.A. öPër stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshmeö

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

Do të organizohet një vizitë në kantier 3 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 10:00 pranë Autoritetit Kontraktor për të paraqitur mostrat e tubacioneve HDPE, me raport testimet përkatëse, si dhe shoqëruar me Certifikatat ISO të prodhimit, Operatori i interesuar Ekonomik Gjatë vizitës do të japë informacione shtesë e shpjegime ku dhe do të pajisen me vërtetim nga institucioni.

Kriteri është në kundërshtim me nenin 46 të LPP-së dhe nenin 26 Kontratave për punë publike të Vendimit Nr.914 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë

29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, sepse në kontrata për punë publike nuk parashikohet kërkesa për paraqitjen e mostrave. Me vendosjen e këtij kriteri autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Po ashtu vendosja e vizitës së detyrueshme në kantier është në kundërshtim me parimet e prokurimit publik, sepse ka si qëllim evidentimin e operatoreve ekonomike pjesëmarrës në procedurë duke ndikuar në paanësinë dhe rregullsinë e procesit.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ÷Për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

1. Procesverbali i KVO datë 02.12.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 3 (tre) OE kanë marrë pjesë.
2. Procesverbali i KVO datë 09.12.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 2 (dy).
3. Raporti përmbledhës datë 17.12.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 17.12.2020.
4. Njoftim fituesi datë 17.12.2020.
5. Kontrata me OE fitues nr. 318 prot, datë 21.12.2020 për vlerën **169,298,352.3** lekë pa TVSH dhe vlera 196,833,404.8 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “GJ.” SHPK,** rezulton se ky OE ka plotësuar saktë të gjitha kriteret e DST.

**IX-Tenderi me objekt:** ÷Rikonstruksioni i godinës aktuale të Bashkisë Himarë”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i godinës aktuale të Bashkisë Himarë</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur	Urdhër Nr.03 dt.06.03.2020 1.E.M. - Ing 2.K.K. - Ekonomist 3. O.V.- Jurist	Urdhër Nr.____ Dt _____.2020 1. A.B..Kryetar -(Dr shërbimesh) 2. U.D. Anëtar (financier) 3. B.R. Anëtar (Financiere)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 41,666,379leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 40,613,118 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>1,053,261</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b>	<b>9.Burimi Financimit</b>	<b>10.Operatoret Ekonomike</b>

22.05.2020	Te ardhurat e veta+ Grant	a) Pjesëmarrës në tender Nr. <b>3 OE</b> b) S kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE GJ. ShPK
------------	---------------------------	---

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 09.01.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 06.03.2020, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

**3.Liçensa profesionale e shoqërisë e vlefshme, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës për kategoritë e mëposhtme:**

**NP-1A , NP-2B, NP-3B , NP-7A, NP-11A, NP-12A, NS-1A, NS-2A, NS-3A, NS-4B, NS-8A, NS-9B, NS-10B, NS-12A, NS-13A, NS-14A, NS-18A, NS-19A** sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI;

Referuar preventivit rkonstatojmë që kategoritë e licencave **NP-2B, NP-3B, NS-4B, NS-9B, NS-10B**

që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë me qëllim kualifikimi janë të fryra dhe tejkalojnë nivelin e punëve të kërkuara për këtë procedurë prokurimi duke pasur në konsideratë fondin limit në dizpocion.

Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues."

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, neni 26 òKontratat për punë publikeò, pika 5 përcaktohet: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ò Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të 33 barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së

4. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.



Kriteri i mësipërm bien ë kundërshtim me këtë parashikim ligjor. Kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 15 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimiò, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

8. Operatori Ekonomik duhet të këtë në stafin e tij teknik të punësuar të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2019 ó Janar 2020, të shoqëruar me kontrate pune , diplome , stafin inxhinierik mbështetës si më poshtë:

- 1 (dy) inxhinier ndërtimi
- 1 (dy) inxhinier elektrik,
- 1 (një) inxhinier mekanik,
- 1 (një) Topograf

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e tre inxhinierëve të ndërtimit në total, dhe kërkesa për 2 (dy) inxhinierë për secilin profil elektrik, mekanik, topograf në total është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet e kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës. Punimet realizohen brenda një objekti, kantieri dhe duke marrë në konsideratë edhe kohëzgjatjen e kontratës dhe grafikun e punimeve nuk justifikohet prezenca e një numri të tillë inxhinierësh në kantier.

12.Operatori ekonomik ofertues duhet të këtë të punësuar 1 ( një) inxhinier i pajisur me çertifikatë për òVlerësimin e Ndikimit në Mjedisò, të vërtetuar me çertifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit, kontratë pune të vlefshme, diplomë, i cili të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2019 - Janar 2020.

Në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011 òPër vlerësimin e ndikimit në mjedisò, neni 2, òObjektiò, dhe nenin 3 òFusha e zbatimitò është përcaktuar: òObjekti i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.ò

òKy ligj zbatohet për projektet e propozuar, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendimmarrjes së tyre.ò

Në nenin 8 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 òPër Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisò, I ndryshuar, parashikohet se òNeni 8 Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) projektet e listuar në shtojcën II, bashkëlidhur;
- b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuar në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;
- c) projektet e listuar në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë se dy vjet;
- ç) projektet e listuar apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që,

veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projektö

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Gjykojmë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kriterin e mësipërm gjykojmë të ndalemi edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret, konstatohet se, referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, kërkesa e autoritetit kontraktor që Inxhinieri Mjedisit duhet të disponojë Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet, bazuar në objektin e prokurimit dhe në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 öPër Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisö si më sipër cituar.

22. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licence nga QKB me kod III.2.A (1+2) (për shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis). Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 öPër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtaö e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: öVeprimtaria e öshërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ö është kategoria III.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 öPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëö[12]. 2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon: a) öveprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedisö me kodin III.2.A; b) öveprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedisö, me kodin III.2.B

II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.A 4. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2. 5. Një subjekt mund të pajiset me një licencë të kategorisë III.2.A, për një apo të dyja veprimtaritë specifike në përputhje me masën e plotësimit të kriterëve të detajuara respektive, në të njëjtën kohë ose në kohë të ndryshme.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ekspertiza në lidhje me ndikimin në mjedis të projektit është e zaturuar në fazën e projektimit. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me Licence nga QKB Kodi 1.2.A.öPer Mbrojtjen nga Zjarriö .

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 öPër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtaö e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: öKATEGORIA I.2 SHËRBIMEVE EKSPERTIZE DHE/OSE PROFESIONALE TË MBROJTJES CIVILE

I. Ndarja e kategorisë dhe rregulla të përgjithshme

1. Veprimtaria öShërbimeve ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civileö është kategoria I.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 öPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëö

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) ÷Shërbime ekspertizeo me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit;...÷ vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate. Ekspertiza konsiderohet e ezauruar në fazën e projektimit.

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5 deri në 12 ton)	2 copë	Pronësi ose me qira
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15 deri 20 ton)	2 Cope	Pronësi ose me qira
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	2 cope	Pronësi ose me qira
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1 ton deri 7 ton për secilin kamionçinë)	2 cope	Pronësi ose me qira
Rrul ngjeshës deri në 12 Ton	1 cope	Pronësi ose me qira

Në nenin 46, pika 1/b të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publiko, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues.”* b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publiko, neni 26 ÷Kontratat për punë publikeo, pika 5 përcaktohet: *÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* ÷ Numri i mjeteve të mësipërme me tonazhet e kërkuara, nuk është në përputhje me zërat dhe volumet e parashikuara në preventiv. Ky numër i mjeteve të kërkuara, është i ekzagjeruar dhe i pajustificuar nga autoriteti kontraktor, kjo evidentuar edhe në procesverbalin ÷Për hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Nuk ka asnjë argumentim teknik mbi disponueshmërinë e tipologjisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka sjellë asnjë analizë teknike për çdo zë punimi, për të justifikuar përdorueshmërinë e tyre sipas proceseve të punës së kërkuar në preventiv. Referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 dhe rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 22.05.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 3 (tre) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 23.06.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 01.07.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 01.07.2020.

Njoftim fituesi datë 01.07.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 121 prot, datë 13.07.2020 për vlerën **40,613,118** lekë pa TVSH dhe vlera 48,735,741 lekë me TVSH.

Nga 2 (dy) OE pjesëmarrës ka pasur ankesa dhe konkretisht:

Ankesa nga Operatori ÷Cö SHPK, me adresë: Vlorë, paraqitur nëpërmjet SPE dhe me e-mail në datë 25.06.2020 dhe protokoll nr.121/3, datë 25.06.2020

Ankesa nga Operatori ÷P.ö SHPK, me adresë: Tiranë, paraqitur nëpërmjet postës në datë 26.06.2020 dhe protokoll nr.121/4, datë 26.06.2020.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues OE “GJ.” SHPK**, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

### **X-Tenderi me objekt: ÷Rikonstruksioni i kopshteve”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i kopshteve</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.25 dt.13.07.2020 1.E.M. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V. - Jurist	Urdhër Nr.26 . Dt 13.07.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2.K.K. Anëtar 3.B.R. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,164,160leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,911,660leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>252,500lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 03.08.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr. 3 OE b) Skualifikuar 1OE, c) Kualifikuar 2 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE J ShPK

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 26.06.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 13.07.2020 nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

### **Në DT është kërkuar:**

**2.3.2** Licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, e lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore duhet te përmbajë kategoritë e mëposhtme:

N.P.1 - Klasifikimi A

NP. 12 - Klasifikimi A

*Dhe*

N.S.5 - Klasifikimi A

N.S. 6- Klasifikimi A

NS.7 - Klasifikimi A

N.S.18- Klasifikimi A

N.S.19- Klasifikimi A

VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò.

N.P. 1 Punime gërmimi në tokë Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit...

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik...

N.S 01 Punime për prishjen e ndërtimeve Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi ...

N.S 0 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ...

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jodriçuese Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jodriçuese, vertikale, horizontale ..

N.S 0 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve si guard rail, në jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat ...

N.S - 18 Punime topogjeodezi Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezi në objekte inxhinierike...

S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën ...

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Këto pika licence nuk janë të domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që përfshihen në këto pika licence. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

**2.3.5** Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet te këtë te përfshirë ne liçensën e shoqërisë:

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo me pak se 10 Vjet, i cili te disponoje licence individuale ne zbatim dhe ne projektim.

- 1(një) Inxhinier Topograf
- 1(një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 ÷Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiö i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimiö, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kërkesa për një Drejtues teknik inxhinier mjedisi, gjeolog dhe topograf nuk duhet. Ky kriter nuk është i domosdoshëm për zbatimin e kontratës, për sa kohë që në preventiv nuk ka zëra punimesh që mbulojnë nga këta inxhinier. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Operatori ekonomik duhet të këtë pjesë të stafit:

- Restaurator 1 (një)

i pajisur me licensë personale restaurimi për kategoritë AZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 i cili të jete në listëpagesat e shoqërisë në gjithë periudhën e përshkruar me lart

- Arkitekt 1(një) të jete në listëpagesat e shoqërisë në gjithë periudhën e përshkruar me lart

Te këtë në listëpagesat ose të kontraktuar

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e një restauratori i pajisur me licensë personale restaurimi për kategoritë AZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 dhe arkitektit është e pabazuar dhe vendosja e këtij kriteri kufizon konkurrencën në mënyrë të padrejtë. Asnjë nga objektet që janë pjesë e projektit nuk është monument kulture dhe si rrjedhim nuk është e nevojshme prania e një restauratori të licensuar.

- një inxhinier mjedisi **vlerësues i ndikimit në mjedis** i cili të jete në listëpagesat të paktën dy muajt e fundit

Në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011 ÷Për vlerësimin e ndikimit në mjedisö, neni 2, ÷Objektiö, dhe neni 3 ÷Fusha e zbatimitö është përcaktuar: ÷Objekti i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësisë, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.ö

÷Ky ligj zbatohet për projektet e propozuar, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendimmarrjes së tyre.ö

Në nenin 8 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 ÷Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisö, I ndryshuar, parashikohet se ÷Neni 8 Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

a) projektet e listuar në shtojcën II, bashkëlidhur;

b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuar në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;

c) projektet e listuar në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë se dy vjet;

ç) projektet e listuar apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projektö

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Gjykojmë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kriterin e mësipërm gjykojmë të ndalemi edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret, konstatohet se, referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, kërkesa e autoritetit kontraktor që Inxhinieri Mjedisi duhet të disponojë Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet, bazuar në objektin e prokurimit dhe në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 *ËPër Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisö si më sipër cituar.*

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 *ËPër rregullat e Prokurimit Publikö sipas të cilit: **ËKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratësö dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.d dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre*****

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.***

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 03.08.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se (tre) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 05.08.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 1 OE dhe kualifikuar 2 (dy).  
Raporti përmbledhës datë 05.08.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 17.08.2020  
Njoftim fituesi datë 17.08.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 156 prot, datë 20.08.2020, për vlerën **3.911.660** lekë pa TVSH dhe vlera 4.693.992 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues BOE "J" SHPK**, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

#### **-Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të Kryetarit, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të kryer nga òJò SHPK, kontrata nr. 156, datë 20.08.2020. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatua se malli/puna/shërbimi i kërkuar nga AK, ofruar dhe ai i lëvruar nga OE ishte sipas specifikimeve dhe dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

**XI-Tenderi me objekt:** òRikonstruksioni i qendrës dhe rrugët lidhëse Fshati Shën Vasil", me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i qendrës dhe rrugët lidhëse Fshati Shën Vasil</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.38 dt.01.10.2020 1.E.M. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V.- Jurist	Urdhër Nr.46. Dt 01.10.2020 1 A.B. .Kryetar -(Drejt shërbimesh) 2. B.R. Anëtar (Financë) 3. K.K. Anëtar (Ekonomist)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 6,666,667leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 5,350,140 <b>leke</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>1,316,527</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 09.11.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. <b>2 OE</b> b) Søkualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE ç) Shpallur Fitues BOE J SH. ShPK

#### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 01.10.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 01.10.2020, nga anëtarët e NJHD.

#### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

#### **Në DT është kërkuar:**

-1(një) pllaka shtrues shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues

-1(një) betonues, shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues;

-4(katër) Manovratorë mjetesh të rënda (buldozerit/eksvatorist/automakinist), shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që



vërteton kualifikimin profesional përkatës), lejen e drejtimit ( patentën) si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues;

-5 (pese) shoferë, shoqëruar me kontratë individuale pune, leje drejtimi si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues.

Bazuar në Ligjin nr.8734, datë 1.2.2001 ÷Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike, i ndryshuar, neni 9 ÷Formimi i punëmarrësve: ÷Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej sajë. Në dokumentet standarde të tenderit për profesionet e mësipërme nuk duhet të ishte kërkuar çertifikata e sigurimit teknik. Kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet dhe vlerat e punimeve elektrike të kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ÷Për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre***

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 09.11.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2 (dy) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 23.11.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 0 OE dhe kualifikuar 2 (dy).

Raporti përmbledhës datë 01.12.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 07.12.2020.

Njoftim fituesi datë 07.12.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 307 prot, datë 14.12.2020 për vlerën **5,350,140** lekë pa TVSH dhe vlera 6,420,168 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** BOE “J. K. + SH.” SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik/punonjës/ specialistë të pajisur me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose çertifikata ekuivalente të cilat të jenë të lëshuara nga organe/shoqëri të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe me dëshmi të

aftësimit profesional/çertifikatë/diplomë, të siguruar sipas **listë pagesës së muajin te fundit**, si më poshtë:

-4(katër) Manovratorë mjetesh të rënda (buldozerit/eksvorist/automakinist), shoqëruar me kontratë individuale pune, dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë (që vërteton kualifikimin profesional përkatës), lejen e drejtimit (patentën) si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues;

-5 (pese) shoferë, shoqëruar me kontratë individuale pune, leje drejtimi si dhe me çertifikata të sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues.

Për këta specialistë mungojnë çertifikatat e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) ose nga një organ i akredituar çertifikues.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “J.SH.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet *“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “J.SH.”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..**

**XII-Tenderi me objekt:** *“Rikonstruksioni i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë Xhepe Bolenë”*, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i ujerave të zeza dhe gropë septike Hundë Xhepe Bolenë</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. LlojiProcedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.53 dt27.10.2020 1.E.M. - Ing 2.U.D.- Ekonomist 3.O.V.- Jurist	Urdhër Nr.54. Dt 27.10.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2.K.K. Anëtar 3.B.R. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,162,186leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 3,797,100leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 365,086lekë</b>
<b>8. Data e hapjessëtenderit</b> 12.11.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr. 2OE b) Squalifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE A.

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 27.10.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 27.10.2020 nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht*:

**Në DT është kërkuar:**

### **2.3.5 Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet të këtë te përfshirë ne licensën e shoqërisë:**

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo me pak se 10 Vjet, i cili te disponoje licence individuale ne zbatim dhe ne projektim.

Operatori ekonomik duhet të këtë pjese te stafit:

- Restaurator 1 (një)

i pajisur me licensë personale restaurimi për kategoritë AZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 i cili te jete ne listëpagesat e shoqërisë ne gjithë periudhën e përshkruar me lart

- Arkitekt 1(një) te jete ne listëpagesat e shoqërisë ne gjithë periudhën e përshkruar me lart

Te këtë ne listëpagesat ose te kontraktuar

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventivit, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e një restauratori i pajisur me licensë personale restaurimi për kategoritë AZ/1,AZ/2,AZ/3,AZ/4 dhe arkitektit është e pabazuar dhe vendosja e këtij kriteri kufizon konkurrencën në mënyrë të padrejtë. Asnjë nga objektet që janë pjesë e projektit nuk është monument kulture dhe si rrjedhim nuk është e nevojshme prania e një restauratori të licensuar.

### **2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se ka te punësuar te paktën:**

- Karpentjer,murator shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.

- Manovratorë me dëshmi për makineritë e rënda, shoqëruar me: kontratë pune dhe leje manovrimi, dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente minimalisht 3 të punësuar.

- Hidraulik, shoqëruar me: kontratë pune ,diplome dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.

- Inxhinierë te stafit 3 (tre) me kategori V

Bazuar në Ligjin Nr.8734, datë 1.2.2001 ÷Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike i ndryshuar, neni 9 ÷Formimi i punëmarrësve ÷ Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej sajë. Në dokumentet standarte të tenderit për profesionet e mësipërme nuk duhet të ishte kërkuar çertifikata e sigurimit teknik . Kjo kërkesë është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet dhe vlerat e punimeve elektrike të kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ÷Për rregullat e Prokurimit Publikë sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe *ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre*

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

**-Zhvillimi i procedurës.**  
Procesverbali i KVO datë 12.11.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 2(dy) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 16.12.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 24.11.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 24.11.2020

Njoftim fituesi datë 24.11.2020

Kontrata me OE fitues nr. 295 prot, datë 27.12.2020 për vlerën **3.797.100** lekë pa TVSH dhe vlera 4.556.520 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues BOE “A.” SHPK**, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar saktë të gjitha kriteret e DST dhe konkretisht:

Operatori ekonomik nuk ka plotësuar saktë Shtojcën 1/1 sepse nuk ka zgjedhur asnjë nga alternativat.

**XIII-Tenderi me objekt:** òRikonstruksioni i urës në Lagjen Lenga Vranisht”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i urës në Lagjen Lenga Vranisht</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.31 dt.27.08.2020 1.A. G. - Ing 2.U.D.- Ekonomist 3.O.V. - Jurist	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.32. Dt 27.08.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2.B.R. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim		
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 10,000,000leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 9,140,533 <b>leke</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>859,467</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 28.09.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr.5 OE b) Skualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 3 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE B ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 08.09.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 08.09.2020 nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

**2.3.5** Staf i teknik i shoqërisë(drejtuesit teknik) të ketë në përbërje (për stafin të paraqitet dokumentacion qe vërteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, dëshmi profesionale të

punonjësve teknik, *ose ekuivalenti i tij/saj*) dhe te figurojnë ne licencën e shoqërisë si dhe ne listëpagesat për periudhën e mësipërme

<u>Inxhinier Arkitekt (i pajisur me Licence Restaurues)</u>	1 (një)
<u>Inxhinier Elektrik</u>	1 (një)
<u>Teknik ndërtimi(me kontrata pune)</u>	2 (një)

Kriteri i mësipërm nuk është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret, referuar projekt preventiv, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, gjykojmë se, kriteri lidhur me disponimin e një inxhinieri arkitekt me licence restauratori është e pajustificuar, objekti nuk është monument kulturore. Po ashtu kërkesa për një inxhinier elektrik drejtues teknik, nuk justifikohet sepse në preventiv nuk ka zëra pune që mbulohen nga ky profil. Gjithashtu kriteri është strukturuar gabim sepse bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 *ËPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi* i ndryshuar, Lidhja 5 Arsimet universitare përkatëse që duhet të ketë drejtuesi/it teknik, Teknik ndërtimi(me kontrata pune)

Saldator me eksperiencë mi 5 vjet me licence, Punëtori e specializuar me makineri,(Manovratorë), nuk janë drejtues teknik.

Kërkesa për 2 teknik ndërtimi , është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi duke shqyrtuar volumet e punimeve të ndërtimit si dhe duke konstatuar që kemi vetëm një objekt ku do të kryhen punimet e ndërtimit e rikonstruksionit dhe sistemimet e jashtme, pra një kantieri ndërtimi, është mëse e mjaftueshme disponimi i 1 (një) tekniku ndërtimi, i cili do të mbikëqyret nga inxhinieri i ndërtimit.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 *ËPër rregullat e Prokurimit Publik* sipas të cilit: *ËKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës* dhe ***ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.G., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre***

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A. G., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre***

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 28.09.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 5 (PESE) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 22.10.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).  
Raporti përmbledhës datë 13.11.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 13.11.2020  
Njoftim fituesi datë 13.11.2020

Kontrata me OE fitues nr. 273 prot, datë 23.11.2020 për vlerën **9.140533** lekë pa TVSH dhe vlera 10.968.639 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** OE “B” SHPK, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

**XIV-Tenderi me objekt: ÷Shërbimi i pastrimit për zonat turistike”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Shërbimi i pastrimit për zonat turistike</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.15 dt.12.05.2020 1.E.M. - Ing 2.U.d. - Ekonomist 3.O.V.- Jurist	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.____. Dt _____.2020 1.A.B. .Kryetar -(P. Finance) 2.B.R. Anëtar 3.K.K. Anëtar
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim		
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 7,711,782leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 7,573,020leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 138,762lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 26.05.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr. <b>1 OE</b> b) Søkualifikuar x OE, c) Kualifikuar 1OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE K.G. ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 29.04.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 12.05.2020 nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

**2.1.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë profesionale të Shoqërisë e vlefshme për kategoritë:

- i. NP-12.öPunime te inxhinierisë se mjedisit;
- ii. NS17. öNdërtimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbaneö;

sipas modelit të lëshuar nga MPPTT ose MTI;

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 öPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiö, i ndryshuar, parashikohet:

N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik...

N.S - 17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane Konsiderohet zbatimi dhe mirëmbajtja e zakonshme ose jashtëzakonshme, e impiantit të djegies së mbetjeve e lidhur me sistemin e trajtimit të tymrave, e ripërdorimit...

Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 öPër prokurimin publikö parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e

prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues."

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ËPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikë*, neni 26 *ËKontratat për punë publikeë*, pika 5 përcaktohet: *ËKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ë Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së. Duke patur në konsideratë që pikat e liçencës si mësipërm nuk janë të domosdoshme për zbatimin e kontratës, vendosja e këtij kriteri kufizon konkurrencën.*

**2.3.5** Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qellim realizimin e objektit te prokurimit: Makineritë qe duhet te disponoje shoqëria për realizimin e shërbimit si me poshtë:

Nr.	Emërtimi makinerive	Sasia min	Pronësia
1	Makine pastrimi me diferencë peshe 6.6 t	1 (një)	ne pronësi ose me qira
2	Elektropompe zhytëse 37 kv	1 (një)	ne pronësi ose me qira
5	Kamion me diferencë peshe 7.84 t	1 (një)	ne pronësi ose me qira
6	Kamionçinë me diferencë peshe 1.108 t	1 (një)	ne pronësi ose me qira

Në nenin 46, pika 1/b të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *ËPër prokurimin publikë*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues.”* b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ËPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikë*, neni 26 *ËKontratat për punë publikeë*, pika 5 përcaktohet: *ËKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.ë Lloji i mjeteve të mësipërme me tonazhet e kërkuara fikse , është i pajustificuar teknikisht dhe nga autoriteti kontraktor, kjo evidentuar edhe në procesverbalin *ËPër hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Nuk ka asnjë argumentim teknik mbi disponueshmërinë e tipologjisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate. Referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën.**

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 *ËPër rregullat e Prokurimit Publikë sipas të cilit: ËKërkesat e veçanta*

të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre*

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 26.05.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 (katër) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 26.05.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 04.06.2020 Vendimi i titullarit të AK datë 04.06.2020

Njoftim fituesi datë 04.06.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 93 prot, datë 15.06.2020 për vlerën **7.573.020** lekë pa TVSH dhe vlera 9.087.624 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues** OE “K.G. SHPK, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar saktë të gjitha kriteret e DST dhe konkretisht:

Operatori ekonomik fitues nuk plotëson kriterin **2.3.5** Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit: Makineritë që duhet të disponojë shoqëria për realizimin e shërbimit si me poshtë:

Nr.	Emërtimi makinerive	Sasia min	Pronësia
9	Mjet gjermimi e shtyrje mbetjesh fadromë	1 (një)	ne pronësi ose me qira

Sepse për mjetin e deklaruar në Shtojcën e makinerive nuk ka paraqitur dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, Siguracioni i mjetit dhe pagesat e taksave.

#### **-Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të Kryetarit, është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim të mallit të kryer nga òK. G.ò SHPK, kontrata nr. 93, datë 15.06.2020. Nga auditimi i zbatimit të kontratës u konstatua se malli/puna/shërbimi i kërkuar nga AK, ofruar dhe ai i lëvruar nga OE ishte sipas specifikimeve dhe dorëzuar brenda afateve të përcaktuara.

**XV-Tenderi me objekt:** òUjësjiellësi i fshatit Tërbaç”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur	Urdhër Nr.13 dt.06.05.2020 1.E.M. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3. O.V.- Jurist	Urdhër Nr.14. Dt 06.05.2020 1. A.B..Kryetar -(Drejt shërbimesh) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. B.R. Anëtar (Financiere)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 82,922,375leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 78,282,827 leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>4,639,548</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 30.06.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Grant	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 4 OE b) Skualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE C

#### **Hartimi fondit limit:**



Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 06.05.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 06.05.2020, nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

### **Në DT është kërkuar:**

Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, (lëshuar nga QKB), kodi III.7.A òShërbime profesionale për projektme. Shërbime profesionale për zbatimeò për Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet dhe/ose kullotatò (lëshuar nga QKL), për te siguruar një mjedis te pastër te blerte, edhe pse ne kushtet e koronavirusit COVID 19 ne vend. Për të cilët duhet të paraqiten: formatet përkatëse dhe certifikata e akreditimit. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).*

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 òPër licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtaò e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: òKategoria II.7 Shërbime të Ekspertizës dhe/ose Profesionale lidhur me Burimet Mjedisore Bazë.

1. Veprimtaria e òshërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazëò është kategoria III.7 e Shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 òPër licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëò.

2. Kategoria e kësaj veprimtarie specifikohet në dy nënkategori si vijon:

a) òshërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotatò, me kodin III.7.A;ò vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

- a. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë, me eksperience pune minimumi 10 vite dhe të deklarojë se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, CV, Libreze pune (përkatëse) si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventivit, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin 1(një) drejtuesi teknik i pajisur, me eksperience pune minimalisht 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimeò i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë : Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimiò, për të qenë drejtues teknik

është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës.

*Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Lloji i mjeteve të mësipërme me tonazhet e kërkuara fikse, është i pajustificuar teknikisht dhe nga autoriteti kontraktor, kjo evidentuar edhe në procesverbalin “Për hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Nuk ka asnjë argumentim teknik mbi disponueshmërinë e tipologjisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate. Referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën.*

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.d dhe O.V. si dhe titullari i AK, J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D dhe O.V. si dhe titullari i AK J.G., në cilësinë e miratuesit të tyre.***

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 15.06.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 (katër) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 30.06.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 10.07.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 10.07.2020.

Njoftim fituesi datë 10.07.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 138 prot, datë 28.07.2020 për vlerën **78,282,827** lekë pa TVSH dhe vlera 93,939,392 lekë me TVSH.

Nga 3 (tre) OE pjesëmarrës ka pasur ankesa dhe konkretisht:

Ankesa nga Operatori ÷Jö SHPK, me adresë: Lezhe, paraqitur nëpërmjet postes dhe në datë 15.05.2020 dhe protokoll nr.1292, datë 19.05.2020

Ankesa nga Operatori 060 SHPK, me adresë: Tiranë, paraqitur nëpërmjet postës në datë 11.05.2020 dhe protokoll nr.1250, datë 14.05.2020

Ankesa nga Operatori 0L0 SHPK, me adresë: Vlorë, paraqitur nëpërmjet postës në datë 11.05.2020 dhe protokoll nr.1272, datë 18.05.2020

\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** OE “C” SHPK, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar saktë të gjitha kriteret e DST dhe konkretisht:

- Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10). Fadromë 6t sepse nuk ka paraqitur dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.

**XVI-Tenderi me objekt:** 0Ujësjellësi Rural 0Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ujësjellësi Rural “Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.37 dt.01.10.2020 1.A.G. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V. - Jurist	Urdhër Nr.48. Dt 01.10.2020 1.A.B. Kryetar -(P. Finance) 2.K.K. Anëtar 3.E.M. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 22,500,000leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 22,457,670.10leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 42,329.1 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 13.11.2020	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Nr.1 OE b) Sëkualifikuar x OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE L

#### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 01.10.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

#### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 01.10.2020 nga anëtarët e NJHD.

#### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, konkretisht:

#### **Në DT është kërkuar:**

c. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) me Kodin III.2.B 0Për grumbullim, ruajtje dhe transportimin e mbetjeve urbane; si dhe me kodin 1.2.A 0Liçensë për mbrojtjen nga zjarri (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë).

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Asnjë zë preventivi nuk parashikon grumbullim apo transport të mbetjeve urbane. Operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës nuk gjeneron mbetje urbane, dhe ky shërbim do të realizohet nga operatorët e tjerë të kontraktuar. Vendosja e

këtij kriteri, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate. Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta e ndryshuar, në të cilin parashikohet që: ÷Kategoria i.2 shërbimeve ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile

I. Ndarja e kategorisë dhe rregulla të përgjithshme

1. Veprimtaria ÷Shërbimeve ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile është kategoria I.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) ÷Shërbime ekspertize me kodin I.2.A, të cilat mund të specifikohen në shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit;...÷ vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosija e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate. Ekspertiza konsiderohet e ezauruar në fazën e projektimit.

**2.3.5** Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesin Certifikatën e cilësisë së punimeve:

- “ SA 8000 (Sistemi i menaxhimit të përgjegjësishë shoqërore).
- “ ISO 28001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë për zinxhirin e furnizimit).
- “ ISO IEC 27001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit).
- “ Rregullore (EU) nr. 333/2011 (Menaxhimi dhe trajtimi i hekurit, çelikut dhe aluminit për skrap).

ISO si më sipër nuk kanë asnjë lidhje me objektin e prokurimit.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A.G., U. D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga A. G., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre.***

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 13.11.2020 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1(një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 16.11.2020 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar \_\_ OE dhe kualifikuar 1 (një).  
Raporti përmbledhës datë 24.11.2020. Vendimi i titullarit të AK datë 24.11.2020  
Njoftim fituesi datë 24.11.2020.

Kontrata me OE fitues nr. 287 prot, datë 01.12.2020 për vlerën **22.457.670** lekë pa TVSH dhe vlera 26.949.204 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** OE "L" SHPK, rezulton se ky OE ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr120/5, datw 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë,ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Mbi konstatimet e grupit të KLSH për procedurat e prokurimit të realizuara në vitin 2020.

**Sqarimi i grupit të KLSH:** Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit pjesërisht qëndrojnë dhe kanë argumentim dhe pjesa tjetër nuk qëndron, duke mos u marrë në konsideratë. Konkretisht për çdo procedurë kundërshtimet që janë marrë apo jo në konsideratë, duke mos u bërë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten:

-Për procedurën e prokurimit të Blerje karburantë, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për 2 autobote eksperiencën prej 10 vjet, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për 2 pika karburanti, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të autoboteve.

-Për procedurën e prokurimit të Pastrim dhe Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri licencën III.7.A dhe Kriteri për mjetet e disponueshme, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri kategoritë II.8.B, III.1.A dhe III.2.A, III.2.B, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të fadromës dhe është marrë në konsideratë për plotësimin e shtojcës 1/1.

-Për procedurën e prokurimit të Mirëmbajtje e rrugëve rurale, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterëve për kategorinë e licencave, numrin e inxhinierëve pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të mjetit tip Grejder.

-Për procedurën e prokurimit të Mirëmbajtje shkollave, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara,, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore.

-Për procedurën e prokurimit të Ndërtim i pusit të ri për ujë të pijshëm Shën Vasilë, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, dhe numrin prej 40 punonjësish, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mbarimin e afatit të licencës të mjekut të shoqërisë.

-Për procedurën e prokurimit të Ndriçim i rrugës Dhrale, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri për licencën 1.2.A dhe Kriteri për numrin e përgjithshëm të punonjësve prej 85 personash.

-Për procedurën e prokurimit të Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi Faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për numrin e përgjithshëm të punonjësve prej 250 personash, kriteri për inxhinier elektronik, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në

konsideratë kriteri për stafin tjetër teknik të shoqërisë, si dhe është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për plotësimin e shtojcës 1/1.

-Për procedurën e prokurimit òRikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë Himarë, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri për licencën III.2.A (1+2), si dhe mbi disponimin e mjeteve pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për 2 inxhinier, 2 teknik ndërtimi.

-Për procedurën e prokurimit òRikonstruksion i Kopshteve, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara.

-Për procedurën e prokurimit òRikonstruksion i qendrës dhe rrugët lidhëse Shën Vasilë, është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për 1 pllakashtrues dhe 1 betonues.

-Për procedurën e prokurimit òShërbimi i pastrimit për zonat e pastrimit, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri licencën NP 12 dhe NS17, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri kategoritë III.1.A dhe III.2.B, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të mjetit të gërmimit (fadromë).

-Për procedurën e prokurimit òUjësjetësi i fshatit Tërbaçë, është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara për drejtuesit teknik dhe numrin e punonjëseve si dhe licencën III.1.A, si dhe mbi mjetet e kërkuara për realizimin e kontratës, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të fadromës 6 ton dhe është marrë në konsideratë për plotësimin e shtojcës 1/1.

-Për procedurën e prokurimit òUjësjetësi rural, rrjeti i shpërndarjes në zonën Kuçë, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri licencën III.2.B dhe Kriteri për certifikimin ISO, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të fadromës.

### **Auditim mbi prokurimet publike për periudhën 01.01.2021-30.09.2021**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Regjistri i prokurimeve të periudhës 01.01.2021 ó 30.09.2021;

Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;

DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;

Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;

Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura (me zgjedhje);

Akt-Mbylljen të kontratave të punimeve/mallrave dhe shërbimeve (me zgjedhje).

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secila përfituese e investimit apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave që ka Bashkia Himarë, referuar në disponimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publik, nenet 23 dhe 28; si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, nenet 9, 11/3/c, 28, 56, 57/4 dhe 59.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operojnë në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Referuar të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur nga grupi i auditimit nisur nga numri i pakët i procedurave të zhvilluara në periudhën 01.01.2021 ó 30.09.2021, auditoi 6 procedura me vlerë nga 5 milion deri në 50 milion lekë.

Konstatohet se numri i operatorëve në procedurë varjon nga 1 deri në 3 shoqëri pjesëmarrëse, gjë e cila tregon interesim të pakët të OE kjo edhe për faktin se kriteret që aplikohen nga AK, përgjithësisht nuk janë në përputhje me ligjin.

-Nga auditimi i 6 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 òObjekti dhe qëllimiò pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 òParimet e përzgjedhjesò germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ò Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveò, ku;

a- Në 4 (katër) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b- Në 1 (një) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

Procedurat e audituara janë:

1-Është audituar procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë, me marzhë fitimi 12% dhe BOE fitues "E.D.ò SHPK.

2-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë, ose më pak se fondi limit prej 238,329 lekë dhe OE fitues "E.ò SHPK.

3-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Piqeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë, ose më pak se fondi limit prej 181,752 lekë dhe OE fitues "A.ò SHPK.

4-Është audituar procedura e prokurimit "E Hapur" me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Stefanel segmenti 1-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë, ose më pak se fondi limit prej 240,747 lekë dhe OE fitues "S.ò SHPK.

5-Është audituar procedura e prokurimit "Kërkesë për propozim" me objekt "*Rikonstruksion i ujësjellësit Kallarar*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë, ose më pak se fondi limit prej 26,654 lekë dhe OE fitues "A. C0ò SHPK.

6-Është audituar procedura e prokurimit "E hapur" me objekt "*Ujësjellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë, ose më pak se fondi limit prej 16,993 lekë dhe OE fitues "Cò SHPK.

Për çdo procedurë të audituar, kemi si më poshtë vijon:

**I-Tenderi me objekt:** òBlerje karburant", me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Blerje karburant</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur	Urdhër Nr.01 dt.08.02.2021 1.E.M.- Ing 2.U.D.- Ekonomist	Urdhër Nr.02. Dt 23.02.2021 1.A.B. Kryetar -(Drejtor Shërbimesh) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. B.R. Anëtar (Financiere)

	3. O.V.- Jurist	
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,333,333leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 12 %	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 23.03.2021	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. <b>1OE</b> b) S kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues BOE E.D. ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 23.02.2021 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 23.02.2020, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

- b) Per arsyen e vendodhje, Operatori Ekonomik duhet te disponojë ne pronësi te vet ose me qira te paktën 2 (dy) mjete autobot me kapacitet deri ne 1000 litra dhe një mjet autobot me kapacitet deri në 5000 lt. Per te provuar disponimin e tyre (ne pronësi) shoqëria duhet te dorëzojë librezën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Autobotet duhet te jene te regjistruar ne Ekstraktin e Q.K.B-se se Operatorit Ekonomik.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk argumentohet arsyeja pse është e nevojshme/ domosdoshme disponimi i këtyre mjeteve, pse tre mjete dhe pikërisht me këto kapacitete ????

Përcaktimi i kapacitetit mbajtës ...për dy mjete autobot deri ne 1000 litra dhe i autobot 5000 litra, është një kriter i cili kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike ne tender dhe diskriminues/ favorizues për sa kohe qe për autoritetin kontraktor e mjaftueshme është qe operatori ekonomik te marre përsipër furnizimin e sasisë se karburantit, sipas kërkesës dhe ne vendin e caktuar.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriterë jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratësò dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga*



autoriteti kontraktues”, për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre.

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 23.03.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 25.03.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 0 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 07.04.2021. Vendimi i titullarit të AK datë 07.04.2021.

Njoftim fituesi datë 07.04.2021.

Kontrata me OE fitues nr. 132 prot, datë 16.04.2021 për vlerën **8,333,333** lekë pa TVSH dhe vlera 10,000,000 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** BOE “E.D.” SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

- Në marrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë nr.2835 rep.nr.1068 kol. Datë 07.05.2021, në nenin 9 parashikohet mundësia e nënkontraktimit, ndërkohë që në dokumentet standarte të procedurës nuk lejohet nënkontraktimit.
- Vizualisht, prima facia, marrëveshjes dhe prokurës së bashkëpunimit i mungon vula e thatë e noterit.
- Sipas kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit duhet që dokumentet e dorëzuara të jenë origjinalë ose kopje të noterizuar. Deklaratat e dorëzuara nga bashkimi i operatorëve òD.ò dhe òEò janë fotokopje, përfshirë edhe formularin e ofertës.

Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të LPP, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të nenit 53 të LPP , vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

- Nuk plotëson kriterin: òTë mos ketë detyrime për taksat vendore për të cilat duhet të paraqesë një vërtetim nga të gjitha organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin sipas QKB-se.ò Bazuar në ekstraktin e QKB, datë 16.03.2021, në rubrikën vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit rezulton:

Vërtetimet e dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ò Dò dhe òEò janë fotokopje.

Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të LPP, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të nenit 53 të LPP , vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

**Mungon vërtetimi i DAS OIL për Bashkinë Kukës, Bashkinë Berat, Bashkia Sarandë.**

- Nuk plotëson kriterin: òOperatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të

cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.”. **Çertifikatat e EROIL dhe DAS OIL janë fotokopje.**

- **Dokumentacioni i mjeteve është fotokopje, mungon një autobot sepse janë paraqitur 2 nga 3 të kërkuar.**
- **Dokumentacioni teknik i depozitave është fotokopje.**

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “E. & D.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet *“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “E.D.”, **nuk është në kushtet e plotësisë të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK, ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..**

**II-Tenderi me objekt:** *“Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe kulluese”*, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Mirëmbajtja e kanaleve vaditëse dhe kulluese</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.22 dt.08.03.2021 1.E.M. - Ing 2.U.D. - Ekonomist 3.O.V.- Jurist	Urdhër Nr.24. Dt 08.03.2021 1. A. B. Kryetar -(Dr shërbimesh) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. A. G.Anëtar (Inxhinier)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 7,460,551leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> <b>7,222,222leke</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>238,329 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 06.04.2021	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 1 OE b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE E. ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 23.03.2021 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 08.03.2021, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

- Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kodi II.8.B LICENCE: *“Shërbime ndërhyrëse higjeno-sanitare: Dezinfektin, Deratizim, Dezinfektim, për zbatimin e projektit në kushtet e koronavirusit COVID 19, për realizim të*

punimeve ne qendrat e banuara te Bashkise Himare, ku do te realizohet kontrata.

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 ÷Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: ÷KATEGORIA II.8 TË TJERA SHËNDETËSORE DHE/OSE HIGJIENO-SANITARE

2. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon:

b) ÷shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B. ÷ vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate, nuk parashikohet në preventiv kryerja e këtij shërbimi. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ÷Për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.d. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre***

#### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 06.04.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 06.04.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 0 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 14.04.2021. Vendimi i titullarit të AK datë 14.04.2021.

Njoftim fituesi datë 14.04.2021.

Kontrata me OE fitues nr. 139 prot, datë 19.04.2021 për vlerën **7,222,222** lekë pa TVSH dhe vlera 8,666,666 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues OE “E.” SHPK**, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

alternativat);

-Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **shtator 2020 ó shkurt 2021**, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, janë të pasakta sepse u mungon fatura elektronike.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “E.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar ku citohet *“Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”*.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “E.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *“Për prokurimin publik”*, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..

**III-Tenderi me objekt:** *“Rikonstruksioni i rrugës dhe zgjerimi i varrezave Piqeras”*, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i rrugës dhe zgjerimi i varrezave Piqeras</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b> Urdhër Nr.04 dt.25.02.2021 1.E.M.- Ing 2. U.D. - Ekonomist 3. O.V.- Jurist	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b> Urdhër Nr.07. Dt 26.02.2021 1. A.B. Kryetar -(Drejtor shërbimesh) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. B.R. Anëtar (Financiere)
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim		
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 5,825,642leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 5,643,890 leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>181,752 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 24.03.2021	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. <b>1 OE</b> b) Skualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE A. ShPK

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 23.02.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 26.02.2020, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

**Në DT është kërkuar:**

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te këtë numrin e nevojshëm për zbatimin e kontratës. Një punësim mesatar prej 40 Punëtoresh për periudhën Mars 2020 deri Shtator 2020 te vërtetuar me:

**2.3.5 Operatori Ekonomik për realizimin e kontratës duhet te këtë te përfshirë ne licensën e shoqërisë:**

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi (me specialitet ndërtime rrugë-ura) i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo me pak se 10 Vjet,
- 1(një) Inxhinier Mekanik (për makineritë)

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventivit, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e

prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e 2 (dy) inxhinierëve të ndërtimit, dhe (një) Inxhinier Ndërtimi (me specialitet ndërtime rrugë-ura) i pajisur me kontrate noteriale, me eksperience pune jo më pak se 10 Vjet, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet e kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës. Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi i ndryshuar, Kreu IV Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi, për të qenë drejtues teknik është e mjaftueshme eksperiencia e punës prej 5 vitesh. Autoriteti kontraktor në kërkesat e vendosura prej tij nuk duhet të tejkalojë parashikimet ligjore. Po ashtu kërkesa për dy inxhinierë ndërtimi si drejtues teknik është në tejkallim të kapaciteteve të nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Kërkesa për inxhinierin mekanik, për sa kohë nuk ka zëra punimesh që kërkojnë praninë e këtij profili inxhinierik, kërkesa për praninë si drejtues teknik të tij kufizon konkurrencën dhe ul pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

### **2.3.10 Shoqëria duhet të jete e pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme:**

- *Certifikate : Per sistemin e menaxhimit te energjisë (ISO 50001:2011 e vlefshme )*

Në nenin 46, pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 për Prokurimin Publik, i ndryshuar parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.[...]”

- Në nenin 30 të Kërkesat e Cilësisë të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit Publik i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminim.” Neni 1 i LPP parashikon shprehimisht se “Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorimin të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si dhe dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”. Certifikata : Per sistemin e menaxhimit te energjisë (ISO 50001:2011 e vlefshme ), referuar përkufizimit nga Drejtoria e Standardizimit nuk është e domosdoshme për realizimin e kësaj kontrate.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese,

natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.d dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe neni 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre.**

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 24.03.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 25.03.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 0 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 02.04.2021. Vendimi i titullarit të AK datë 02.04.2021.

Njoftim fituesi datë 02.04.2021.

Kontrata me OE fitues nr. \_135 prot, datë 16.04.2021 për vlerën **5,825,642** lekë pa TVSH dhe vlera 6,772,668 lekë me TVSH.

**\*\*\*\* Lidhur me OE të shpallur fitues OE “A.” SHPK**, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Operatori ekonomik fitues òA.ò SHPK, nuk plotëson kriterin **2.3.9 Mjetet dhe Pajisjet:** Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës , për disponimin e një grejderi, sepse grejderi i paraqitur pavarësisht se janë mjete të cilat regjistrohen në regjistrat publikë, për to nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar sipas ligjit. Nuk plotëson kriterin për disponimin e një fadromë, sepse mjete i paraqitur nuk është fadromë dhe për të nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar sipas ligjit. Autobitumatriçe së paraqitur i mungon çertifikata e kontrollit teknik (kolaudimi).

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “A.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 òShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet òAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “A.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat **ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..**

**IV-Tenderi me objekt:** òRikonstruksioni i rrugës Stefanel segmenti 1-2”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i rrugës Stefanel segmenti 1-2</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.03 dt.25.02.2021 1.E.M. - Ing 2. U.D. - Ekonomist 3. O.V.- Jurist	Urdhër Nr.06. Dt 26.02.2021 1A.B. Kryetar -(Drejtor Shërbimesh) 2. K.K.. Anëtar 3. B.R. Anëtar
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 48,333,333leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 48,092,585.76 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> <b>240,747.76</b> lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 01.04.2021	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 3 OE b) Sëkualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE “S.” ShPK

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 26.02.2021 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 26.02.2021, nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

### **Në DT është kërkuar:**

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik të përfshirë në **licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 12 (dymbëdhjetë ) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2(dy) Inxhinier Ndërtimi

Operatori Ekonomik duhet të ketë ne stafin e tij të punësuar të cilët të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Shtator 2020 - Janar 2021 të shoqëruar me kontratë pune , diploma Libreze Pune, stafin mbështetës si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier hidroteknik,
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (një ) agronom

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventivit, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e 2 (dy) inxhinierëve të ndërtimit, dhe kërkesa për 2 (dy) inxhinierë për secilin profil, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet e kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. *Per këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*

- a) Kërkohen të jene ne dispozicion këto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1.	Kamionë vetëshkarkues min 20 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qira
2.	Kamionë vetëshkarkues 10 deri 18 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qira
3.	Kamionë vetëshkarkues 5 deri 10 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qira
4.	Kamionçinë deri 4.5 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira

Në nenin 46, pika 1/b të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminues.” b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, neni 26 Kontratave për punë publike, pika 5 përcaktohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Numri i mjeteve të mësipërme me tonazhet e kërkuara, nuk është në përputhje me zërat dhe volumet e parashikuara në preventiv. Ky numër i mjeteve të kërkuara, është i ekzagjeruar dhe i pajustificuar nga autoriteti kontraktor, kjo evidentuar edhe në procesverbalin për hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit. Nuk ka asnjë argument teknik mbi disponueshmërinë e tipologjisë së mjeteve të kërkuara, për realizimin e punimeve objekt kontrate. Për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka sjellë asnjë analizë teknike për çdo zë punimi, për të justifikuar përdorueshmërinë e tyre sipas proceseve të punës së kërkuar në preventiv. Referuar testit të proporcionalitetit, kërkesa në fjalë e autoritetit kontraktor mbi disponimin e mjeteve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nuk është në proporcion dhe në përputhje me përmasat dhe volumin e kontratës duke kufizuar në mënyrë të padrejtë konkurrencën.*

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë:

1. Liçensë kodi III.2.Bö Grumbullim dhe Transporti i Mbetjeve Urbaneö.

Liçensë kodi III.2.B öGrumbullim dhe Transporti i Mbetjeve Urbaneö, nuk ka lidhje me objektin e kontratës dhe zërat e punime në preventiv.

***Per shkak te specifikes qe ka objekti dhe vendndodhjes se tij, do te organizohet një vizite e detyrueshme ne objekt ne date 24.03.2021 ora 10:00 - 12:00 për t’u njohur me objektin. Per te kryer vizitën ne objekt duhet te paraqitet pranë Bashkise Himare - (zyra e prokurimeve) administratori i shoqërisë ose drejtuesi teknik i operatorit ofertues/bashkimit te operateve (me autorizim), ku një inxhinier i Bashkise do ti shoqëroj ne vendin ku do te jetë objekti i kantierit, për tu njohur me objektin. Per këtë do te lëshohet nga ana e investitorit një vërtetim për kryerjen e vizitës ne objekt.***

Vizita në kantier është fakultative, sipas nenit 14 pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik öNë udhëzime duhet të përcaktohet që, nëse autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit...ö dhe nuk mundet të shërbejë si kusht për skualifikimin e operatorëve ekonomik. Duke vendosur këtë kriter, praktikisht AK ka zbuluar të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në kundërshtim me*



rregullat e konkurrencës dhe duke lejuar mundësinë e ndikimeve të jashtme në vullnetin e OE ofertues.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 “Kontratat e mallrave” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, në të cilën përcaktohet se: “Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: “Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues”, për të cilat **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre***

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 06.04.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 14.04.2021. Vendimi i titullarit të AK datë 14.04.2021.

Njoftim fituesi datë 14.04.2021.

Kontrata me OE fitues nr. 138 prot, datë 19.04.2021 për vlerën **48,092,585.76** lekë pa TVSH dhe vlera 57,711,103 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues OE “S.” SHPK**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk duhet të ishte kualifikuar sepse nuk plotëson kriterin: ò2.2.4 Operatori ekonomik fitues òS.ò SHPK, nuk plotëson kriterin 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, për disponimin e dy grejderëve, sepse grejderat e paraqitur pavarësisht se janë mjete të cilat regjistrohen në regjistrat publikë, për to nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar sipas ligjit.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e OE “S.”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 òShqyrtimi i ofertaveò të ligjit 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar ku citohet òAutoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “S.”, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..

**V-Tenderi me objekt:** òRikonstruksioni i ujësjetllësit Kallarat”, me këto të dhëna:

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksioni i ujësjetllësit Kallarat</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> Kërkesë për propozim	Urdhër Nr.05 dt.25.02.2021 1.E.M.- Ing 2. U.D.- Ekonomist 3. O.V.- Jurist	Urdhër Nr.23. Dt 08.03.2021 1. A.B. Kryetar -(Drejt shërbimesh) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. A. G.Anëtar (Inxhinier)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 8,179,354leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 8,152,700leke	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 26,654 lekë</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 02.04.2021	<b>9.Burimi Financimit</b> Te ardhurat e veta	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 1OE b) Søkualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE ç) Shpallur Fitues OE A. CO

**Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 23.02.2021 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

**Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 08.03.2021, nga anëtarët e NJHD.

**Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, konkretisht:

**Në DT është kërkuar:**

1. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2020– Nëntor 2020** stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2(dy) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaidet/Gjeomatik.
- 2(dy) inxhinier Hidroteknik
- 2(dy) inxhinier Mjedisi
- 2(dy) inxhinier Gjeolog
- 2(dy) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinierë Mekanik

Në nenin 26, pika 8, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, parashikohet si më poshtë:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- q) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuaranga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- r) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit tëprokurimit; dhe/ose
- s) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicionoperatorit ekonomik për të përmbushur kontratë”.

Referuar vlerës së kontratës, preventivit të punimeve, volumit të punimeve që do të kryhen, natyrës së punimeve, është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm, që në rastin konkretë duhet të jetë i konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar edhe në kategoritë e licencave dhe pikave (janë A), përcaktimi i numrit të punonjësve drejtues teknik, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra si dhe grafiku i punimeve. Për këtë qëllim, AK duhet të hartojë për çdo zë punimi, analizë teknike, ku të parashikohen fuqia punëtore dhe mjetet/ makineritë që nevojiten për realizimin e secilit zë punimesh, sipas afateve kohore të parashikuara në grafikun e punimeve ku duhet të përcaktohet qartë se cilat zëra punimesh do të ndjekë secili drejtues teknik për realizimin e punimeve objekt kontrate. Sa më sipër, bazuar në të gjithë elementët e cituar më lartë, kërkesa për disponimin e 2(dy) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaider/Gjeomatik, 2(dy) inxhinier Hidroteknik, 2(dy) inxhinier Mjedisi, 1(një) inxhinier Mjedisi(Profili energjitik), 2(dy) inxhinier Gjeolog, 2(dy) inxhinier Elektrik, është një kërkesë joproportionale dhe e pajustificuar nga autoriteti kontraktor, si dhe jo në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 46 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 26 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave oPërmiratimin e rregullave të prokurimit publiko të ndryshuar ku parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”* Gjithashtu, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, akti mbi miratimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht nevojën për 3 inxhinierë mjedisi, duke vendosur kriteret të cilat kanë ulur konkurrencën në tender (një ofertë e vetme) në kundërshtim me parashikimet dhe frymën e legjislacionit për prokurimin publik.

## 2. Krahas stafit të mësipërm të këtyre të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- o 1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturist

Në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së, referuar projekt preventivit, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik të procedurës së mësipërme të prokurimit, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik nga autoriteti kontraktor, kriteri lidhur me disponimin e stafit të mësipërm, është e ekzagjeruar dhe përtej asaj se çka është e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, pasi nuk është në përputhje me volumet e kontratës që prokurohet dhe si rrjedhojë kufizues ndaj konkurrencës. Nuk justifikohet kërkesa e njëkohësish me për praninë në objekt të dy inxhinierëve të ndërtimit dhe të 2 teknikëve të ndërtimit. Po ashtu është e pajustificuar kërkesa për 1 (një) punonjës teknik Gjeometër dhe 1 (një) punonjës teknik Topograf në të njëjtin objekt. Për më tepër, në kriteret e kualifikimit të dokumenteve të tenderit për procedurën objekt ankimimi, është kërkuar 2 (dy) inxhinier topograf/gjeodet, i cili do të kryejë punimet e rilevimit/piketimit me instrumentin topografik, dhe kërkesa për 1 (një) teknik topograf është dublimi i kriterit, duke rënduar pozitativisht ofertuesve të mundshëm.

Kërkesa për paraqitjen e kontratave noteriale të punës është në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës, ku në asnjë dispozitë nuk parashikohet detyrimi që kontrata e punës të jenë noteriale. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke rritur shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit.

## 3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 Punëtori e specializuar me makineri,(automakinist)(me certifikatë)
- 3 Punëtori e specializuar me makineri,(ekskavatorist) (me certifikate)
- 1 Inxhinier(Me certifikatëSPECIALIST NDERTIMI)
- 4 Punëtori e specializuar me makineri,(Manovratorë me certifikate)

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme; dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë profesionale dëftesë/ certifikate/diplomës dhe te figurojnë ne listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2020 Shtator 2020.*

7.Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht: 5(pese) Ekskavatorist/Manovratorë, 2(dy) automakinist, 5(pese) shofere, Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata noteriale e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), dëshmitë e aftësisë Profesionale (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2020– Janar 2021**.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Kërkesa për 16 Manovratorë dhe 5 shoferë \* sipas pikës 5 dhe 6 të dokumenteve standarte të tenderit është tërësisht e ekzagjeruar, tejkalon edhe numrin e mjeteve që si rregull këta Manovratorë duhet të drejtojnë, dhe ndikon drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës.

Kërkesa për paraqitjen e kontratave noteriale të punës është në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës, ku në asnjë dispozitë nuk parashikohet detyrimi që kontrata e punës të jenë noteriale. Vendorsja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke rritur shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit.

11.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10).

Nr/	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamionë vetëshkarkues kapacitet mbajtës(10-12 ton)	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Kamionçine kapacitet mbajtës(1.5-2 ton)	2 copë	Pronësi ose me qira

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk argumentohet arsyeja pse është e nevojshme/ domosdoshme disponimi i këtyre mjeteve pikërisht me këto kapacitete ????

Kamionë vetëshkarkues kapacitet mbajtës(10-12 ton)	2 copë
Kamionçine kapacitet mbajtës(1.5-2 ton)	2 copë

Përcaktimi i kapacitetit mbajtës pa u argumentuar teknikisht , është një kriter i cili kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike ne tender dhe diskriminues/ favorizues.

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një 1 (një) agronom me licencë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI me eksperiencë mbi 10 vjet e dëshmuar me Licencë, Libreze pune, Diplome, CV si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Kërkesa për një 1 (një) agronom me licencë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI me eksperiencë mbi 10 vjet, nuk është e domosdoshme për realizimin e kontratës, po ashtu edhe eksperiencia 10 vjeçare është e ekzagjeruar, për sa kohë që diploma dhe liçenca japin garanci të mjaftueshme mbi aftësitë profesionale.

Operatori ekonomik te këtë te punësuar një ekspert zjarrfikës te shoqëruar me : kontrate noteriale pune, certifikatën e zjarrfikësit, libreze pune, CV, te jete ne liste pagesa për periudhën 12 muajt e fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrfikës te jete te

i pajisur me Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL (kjo pike kërkohet duke qene se ne objekt do përdoret praimer/bitum këto materiale konsiderohen lende e rrezikshme për zjarr).

Kërkesa për paraqitjen e kontratave noteriale të punës është në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës, ku në asnjë dispozitë nuk parashikohet detyrimi që kontrata e punës të jenë noteriale. Vendosija e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, duke rritur shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit.

**16.** Operatori ekonomik duhet të këtë licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.B autoriteti kontraktor kërkon që kjo të kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe konkretisht në ligjin 10081 datë 23.02.2003 , nga ku rrjedhimisht operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë licencë QKL III.2.B ò Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve Urbane".

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-se. Kriteret duhet të jene në përpjesëtim dhe të lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Asnjë zë preventivi nuk parashikon grumbullim apo transport të mbetjeve urbane. Operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës nuk gjeneron mbetje urbane, dhe ky shërbim do të realizohet nga operatorët e tjerë të kontraktuar. Vendosija e këtij kriteri abuziv, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

Kriteret e mësipërme, nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 òPër rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: òKërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.d dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues", për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre.*

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 12.04.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 1 (një) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 06.04.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 0 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 14.04.2021. Vendimi i titullarit të AK datë 14.04.2021.

Njoftim fituesi datë 14.04.2021.

Kontrata me OE fitues nr. 141 prot, datë 20.04.2021 për vlerën **8,152,700** lekë pa TVSH dhe vlera 9,783,240 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues** OE “A.” SHPK, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk duhet të ishte kualifikuar sepse nuk plotëson kriterin: 2.2.4 Nuk ka plotësuar saktë shtojcë 1/ 1 ( nuk ka klikuar asnjë alternative);
- Nuk ka plotësuar shtojcën 10 ó Deklaratë mbi punët në proces sipas formatit të DST-ve;
- Për specialistët e kërkuar në pikën 4: Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2020– Nëntor 2020** stafi inxhinierik si më poshtë:
- 2(dy) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaidër/Gjeomatik. Ka paraqitur vetëm 1 Helenada Sava.
- Për specialistët e kërkuar në pikën 5, mungojnë kontratat noteriale të punës.
- Nuk plotësohet numri total i manovratorëve sipas pikës 5 dhe 6 të DST.
- Nuk ka paraqitur inxhinierin agronom sipas kërkesave të pikës 13 : Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një 1 (një) agronom me licencë sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI me eksperiencë mbi 10 vjet e dëshmuar me Licencë, Libreze pune, Diplome, CV si dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë.
- Nuk ka paraqitur inxhinierin agronom sipas kërkesave të pikës 13: Operatori ekonomik te këtë te punësuar një ekspert zjarrfikës te shoqëruar me : kontrate noteriale pune, certifikatën e zjarrfikësit, libreze pune, CV, te jete ne liste pagesa për periudhën 12 muajt e fundit, gjithashtu operatori ekonomik ose eksperti zjarrfikës te jete te i pajisur me Kodi 1.2.A lëshuar nga QKL (kjo pike kërkohet duke qene se ne objekt do përdoret praimer/bitum këto materiale konsiderohen lende e rrezikshme për zjarr).

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “G. & A. K. ”, SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”.

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë “G.A. K. ”, **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B.**

**VI-Tenderi me objekt:** ÷Ujësjetillësi i Fshatit Tërbaç Himarë (vazhdim) Loti II”, me këto të dhëna:

**Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Ujësjetillësi i Fshatit Tërbaç Himarë (vazhdim) Loti II**

<b>1.Urdhër Prokurimi Nr Datë</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit të Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> E hapur	Urdhër Nr.60 dt.28.12.2020 1.E.M. - Ing 2. U.D. - Ekonomist 3. O.V.- Jurist	Urdhër Nr.61. Dt 28.12.2021 1 A.B. .Kryetar -(Drejtor shërbime) 2. K.K. Anëtar (Ekonomist) 3. B.R. Anëtar (Financiere)
<b>5.Fondi Limit (pa TVSh)</b> 16,461,437leke	<b>6.Oferta fituese (pa TVSh)</b> 16.444.444 <i>leke</i>	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 16,993 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 01.02.2021	<b>9.Burimi Financimit</b> Grant	<b>10.Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Nr. 4 OE b) Sëkualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1OE ç) Shpallur Fitues OE/BOE C

### **Hartimi fondit limit:**

Llogaritja e fondit limit është mundësuar, nga komisioni i NJHDT me procesverbal datë 29.12.2020 (shoqëri private sipas kontratës së shërbimit apo strukturë e krijuar enkas për këtë qëllim). Miratimi i këtij fondi rezulton sipas preventivit pjesë e dosjes së prokurimit.

### **Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Procesverbali i hartimit të kriterëve datë 29.12.2020, nga anëtarët e NJHD.

### **Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST.**

Vendosja e tyre konstatohet se nuk është në përputhje me llojin e objektit të shërbimit/investimit të kërkuar, nuk është i argumentuar dhe cënon pjesëmarrjen e OE të interesuar, *konkretisht:*

### **Në DT është kërkuar:**

✓ Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB): Kodi III.7.A ÷Shërbime profesionale për projektme. Shërbime profesionale për zbatimeo për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me pyjet gjate procesit te realizimit te zbatimit te kontratës se ujesjesjellesit te rrjetit kryesor dhe sekondar qe do te rikonstruktohet, për zbatimin e kontratës dhe ne kushtet e ekzistencës se pandemisë se koronavirusit COVID 19 ne vend.

Në bazë të Vendimit Nr.538, datë 26.5.2009 ÷Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëtao e ndryshuar , në të cilin parashikohet që: ÷KATEGORIA II.7 SHËRBIME TË EKSPERTIZËS DHE/OSE PROFESIONALE LIDHUR ME BURIMET MJEDISORE BAZË

1. Veprimtaria e ÷shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazëo është kategoria III.7 e Shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 ÷Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisëo.

2. Kategoria e kësaj veprimtarie specifikohet në dy nënkategori si vijon:

a) ÷shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyjet apo kullotatö, me kodin III.7.A;

ö vlerësohet se ky kriter nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.

Kërkesat e veçanta te kualifikimit duhet te përfshijnë te gjitha kriteret specifike, ne përputhje me nenin 46 te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Vendosja e këtij kriteri kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevancë në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

Për të gjitha këto duhet të paraqiten: formatet përkatëse te licencave

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar I grupit duhet të dorëzoj liçensat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit qe merr përsipër të realizojë).

- a. Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) se Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt do të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë, me vjetërsi pune mbi 10 vjet dhe të deklaroje se ai do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Kontratë pune e noterizuar (e vlefshme), Diploma, CV, Libreze pune (përkatese).

Në bazë të Udhëzimit Nr.2, datë 13.5.2005 për Zbatimin e punimeve të ndërtimito pika 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të përvetuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Kriteri i mësipërm bien ë kundërshtim me këtë parashikim ligjor.

**Konkluzion:** Për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

Për hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 për rregullat e Prokurimit Publik sipas të cilit: ÷Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe **ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre**

*Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim, janë veprime në mospërputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, pika 2, germa (c, ç, d), neni 2 germa (a, b, c), 20, 23 si dhe nenin 46 pika (1, 3), si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 27 "Kontratat e mallrave" Kreu III, "Dokumentet e tenderit", pika 3, "Informacione të veçanta", në të cilën përcaktohet se: "Kontratat për punë, në të cilën është përcaktuar se: "Në çdo rast kërkesat e mësipërme duhet të jenë të argumentuara nga autoriteti kontraktues", për të cilat ngarkohet me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga E.M., U.D. dhe O.V. si dhe titullari i AK, B.B., në cilësinë e miratuesit të tyre.*

### **-Zhvillimi i procedurës.**

Procesverbali i KVO datë 01.02.2021 i hapjes së procedurës nga ku ka rezultuar se 4 (katër) OE kanë marrë pjesë.

Procesverbali i KVO datë 09.02.2021 për vlerësimin e dokumentacionit të OE pjesëmarrës, nga ku ka rezultuar se janë skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 1 (një).

Raporti përmbledhës datë 23.02.2021. Vendimi i titullarit të AK datë 23.02.2021.

Njoftim fituesi datë 23.02.2021.

Kontrata me OE fitues nr. 25 prot, datë 05.03.2021 për vlerën **16,444,444** lekë pa TVSH dhe vlera 19,733,333 lekë me TVSH.

\*\*\*\* **Lidhur me OE të shpallur fitues BOE "C" SHPK**, pavarësisht se është oferta më e favorshme ekonomike, rezulton se ky OE nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues pa të drejtë nga ana e KVO-së dhe Titullarit të AK dhe konkretisht:

- Operatori ekonomik C SHPK nuk plotëson kriterin dëshmi për mjetet dhe pajisjet sepse Fadroma e paraqitur nga ky operator nuk ka dokumentacionin e kërkuar për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e OE/BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar



shpallja fitues e OE "C", SHPK. Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës 5, të nenit 53 të *Shqyrtimi i ofertave* të ligjit 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik*, i ndryshuar ku citohet *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*".

**Konkluzioni:** Referuar sa mësipërm, kualifikimi i shoqërisë "C", **nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: A.B., në cilësinë e kryetarit të KVO, B.R. dhe K.K. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. B.B..**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr120/5, datw 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:

Mbi konstatimet e grupit të KLSH për procedurat e prokurimit të realizuara në vitin 2020.

**Sqarimi i grupit të KLSH:** Pas shqyrtimit të kundërshtive të subjekti, arrin në konkluzionin se pretendimet e subjektit pjesërisht qëndrojnë dhe kanë argumentim dhe pjesa tjetër nuk qëndron, duke mos u marrë në konsideratë. Konkretisht për çdo procedurë kundërshtimet që janë marrë apo jo në konsideratë, duke mos u bërë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten:

-Për procedurën e prokurimit të Blerje karburantë, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për 2 autobote dhe eksperiencën prej 10 vjet, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për 2 pika karburanti, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të autoboteve.

-Për procedurën e prokurimit të Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkuara, kriteri licencën II.8.B, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri kategoritë 1.2.A, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të listpagesave të punonjësve për periudhën shtator 2020-shkurt 2021 dhe është marrë në konsideratë për plotësimin e shtojcës 1/1 dhe është marrë në konsideratë për pagesën e faturës së energjisë elektrike.

-Për procedurën e prokurimit të Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerimi i varrezave Piqeraso, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterëve për kategorinë e licencave, 2.3.5 dhe 2.3.10 pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri kategoritë 2.3.4, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të listpagesave të punonjësve për periudhën shtator 2020-shkurt 2021 dhe është marrë në konsideratë për plotësimin e shtojcës 1/1 dhe është marrë në konsideratë për mjetin tip grejder.

-Për procedurën e prokurimit të Rikonstruksion i rrugës Stefanel Segmenti 1-2ö, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterëve për kategorinë e licencave, 2.3.3 dhe licenca

III.3.8 dhe 3.2.B pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri për numrin e përgjithshëm të punonjësve.

-Për procedurën e prokurimit ÷Ujësjetllësi i fshatit Tërbaç, loti 2ö, nuk është marrë në konsideratë vendosja e kriterit për kategoritë e licencave të kërkua, kriteri licencën III.2.B si dhe III.7.A, pasi nuk gjen referim në ligj dhe aktet nënligjore, si dhe është marrë në konsideratë kriteri kategoritë për 1.2.A, II.8.B, licenca NP-9A, NS 19-A dhe NS-2-A, si dhe nuk është marrë në konsideratë kundërshtimi i KVO për mungesën e dokumentacionit të plotë të mjetit tip grejder dhe është marrë në konsideratë për plotësimin e shtojcës 1/1.

#### **Konkluzioni i gjetjeve në fushën e prokurimit për vitin 2019**

-Nga auditimi i 4 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ÷Për prokurimin publikö, i ndryshuar, neni 1 ÷Objekti dhe qëllimiö pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ÷Parimet e përzgjedhjesö germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ÷ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveö, ku;

a-Në 4 (katër) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b-Në 1 (një) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

#### **Konkluzioni i gjetjeve në fushën e prokurimit për vitin 2020**

-Nga auditimi i 16 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ÷Për prokurimin publikö, i ndryshuar, neni 1 ÷Objekti dhe qëllimiö pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ÷Parimet e përzgjedhjesö germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ÷ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveö, ku;

a-Në 11 (njëmbëdhjetë) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b-Në 6 (gjashtë) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

#### **Konkluzioni i gjetjeve në fushën e prokurimit për vitin 2021**

-Nga auditimi i 6 procedurave, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ÷Për prokurimin publikö, i ndryshuar, neni 1 ÷Objekti dhe qëllimiö pika 2, germa (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ÷Parimet e përzgjedhjesö germa (a), (b) dhe (c), dhe nenet 46 dhe 55, 56, 58, pika 2 e nenit 61, si dhe neni 73 i VKM nr. 797, datë 29.12.2017 ÷ Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministraveö, ku;

a-Në 4 (katër) procedura, kriteret nuk janë në përputhje me procedurën e zhvilluar, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedura;

b-Në 1 (një) procedura, OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

#### **5. Planifikimi i territorit**

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) për territorin administrativ të Bashkisë Himarë ka nisur procesin e hartimit në kuadër të prokurimit të shërbimit të konsulencës nga ish Ministria e Zhvillimit Urban për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki në Shqipëri, ku ÷Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për bashkitë....ö.

Përbashtrim nga kompetencat për të shqyrtuar kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi nga Bashkia Himarë bëjnë zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe **brezi bregdetar**, sipas vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), **në të cilat çdo ndërtim i ri do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.**

Neni 45, i VKM Nr. 408 përcakton gjithashtu se:

2. Kërkesat për leje ndërtimi, që bazohen në instrumentet e planifikimit të miratuara përpara hyrjes në fuqi të Planeve të Përgjithshme Vendore për territoret e reja administrative, do të shqyrtohen në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe **kushtet zhvillimore në fuqi në kohën e miratimit të tyre.**

Bazuar në Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, **kushtet zhvillimore** janë kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Neni 3

15. “**Kushte zhvillimore**” janë kushtet e përcaktuara nga plani i detajuar vendor ose, në mungesë, **nga plani i përgjithshëm vendor** dhe, në mungesë të të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.

Për gjithë sa më sipër nga auditimi rezulton se për periudhën e auditimit 01.10.2019 ó 30.09.2021:

1. Në territorin e përfshirë në Bashkinë Himarë kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi shqyrtohen konformë Ligjit 107/2014 òPër planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi , si edhe duke u bazuar në dokumentet e planifikimit si : Plani i përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë e miratuar me Vendimin nr.2 të KKT-së datë 16.10.2017 òPër miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarëò (që tani e tutje do të shënohet PPV në këtë dokument), i rishikuar me Vendimin nr.5 datë 10.06.2020 të KKT òPër miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë, i rishikuar me Vendimin nr.5 datë 15.04.2021 të KKT òPër miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor , Bashkia Himarëò.

## 2. Kontrolli dhe zhvillimi i territorit

Referuar të dhënave në sistemin elektronik e-lejet për Bashkinë Himarë, rezulton se për afatin e auditimit **01.10.2019 deri në 30.09.2021**, ka pasur **160 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi etj. përkatësisht 42 aplikime për leje Zhvillimi, 10 për leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250m<sup>2</sup>, 5 aplikime për leje me sipërfaqe deri 250m<sup>2</sup>, 10 certifikata përdorimi, 5 shtyrje afati leje ndërtimi, 25 deklarata paraprake për kryerje punimesh, 0 ndryshime funksioni, 14 aplikime për shtesë në ndërtim ekzistues, rikonstruksione 26 dhe 7 leje infrastrukture.

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar	2019	2020	2021	Jashtë afateve
---------------	-------	----------	----------	------	------	------	----------------

							ligjore për shqyrtim
Leje Zhvillimi	42	25	17	3	15	24	35
Leje ndërtimi mbi 250m <sup>2</sup>	10	6	4	2	2	6	8
Leje Ndërtimi deri 250m <sup>2</sup>	5	2	3	-	3	2	4
Deklarate paraprake për kryerje punimesh	25	9	16	3	16	6	-
Rikonstrukcion	26	7	19	7	15	4	20
Certifikate përdorimi	10	4	6	1	5	4	8
Shtesë në objekt ekzistues	14	3	11	-	6	8	9
Ndryshim projekti gjate zbatimit	5	1	4	-	2	3	4
Ndryshim funksioni	-						
Njoftim fillim punimesh	6	6	-	-	6	-	-
Shtyrje afati leje ndërtimi	5	3	2	-	4	1	2
Leje Infrastrukture	7	0	7	1	3	3	7

Referuar të dhënave në sistemin elektronik e-lejet për Bashkinë Himarë, për afatin e auditimit 01.10.2019 deri në 30.09.2021, rezulton se janë tejkuluar afatet ligjore për shqyrtimin e aplikimeve, pavarësisht statusit të tyre, specifikisht për këto lloje lejesh:

përkatesisht 35 aplikime për leje Zhvillimi janë trajtuar në tejkalim të afateve të përcaktuara për shqyrtim, 41 aplikime për leje ndërtimi, 7 aplikime për leje infrastrukture janë shqyrtuar në tejkalim të afateve dhe 8 aplikime për pajisje me certifikatë përdorimi.

Nga sa më sipër janë përzgjedhur për t'u audituar disa nga procedurat e miratimit për leje ndërtimi për ndërtime të reja me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, nën 250m<sup>2</sup> si edhe certifikata përdorimi, duke e bazuar kështu përzgjedhjen në madhësinë e objekteve, vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë si edhe vendndodhjes së tyre, për të mbajtur në fokus veçanërisht lejet e dhëna në Bashkinë e Himarë dhe në zonën e brezit bregdetar, si zona ku risku paraqitet më i lartë.

Është në proces auditimi i tyre rast pas rasti.

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave për leje ndërtimi të miratuara nga Bashkia Himarë, ku u përzgjedhën si më me risk lejet për objektet shumëkatëshe banimi, multifunkionale dhe turistike, rezulton se **Bashkia Himarë në 16 raste ka miratuar leje ndërtimi dhe procedura të tjera (certifikata përdorimi) në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi**, konkretisht:

<b>Titulli gjetjes</b>	<b>Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 83, Prot.2299/1 datë 26/8/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi miratuar me Vendim Nr. 19, datë 28.07.2020 të KKT për objektin “Strukturë hotelerie dhe shërbimi 1-5 kate”, në adresën Gjilekë, Bashkia Himarë, me zhvillues “R.” sh.p.k, projektuar nga “C.” sh.p.k.</b>
<b>01</b>	



Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së sipërcituar rezulton se:

**1.** Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim nr.2 të KKT-së datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1198, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është  $K_{shtmax}=40\%$ , ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është  $K_{sht\ miratuar}=47.7\%$ , duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1198, lartësia maksimale e lejuar është  $H_{max} = 18m$ , ndërsa miratimi  $H_{miratuar}=18.85m$ .

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1198,  $K_{shr}=10\%$  dhe  $K_{shp}=20\%$ , në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit, madje objekti propozohet mbi njësinë HI.IN.1013, i cili është rrjet rrugor kryesor.

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1198, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është  $I_{max}=1.7$ , ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet, pasi nga sipërfaqja e vënë në dispozicion për zhvillim, nuk janë zbritur sipërfaqet që do përdoren për rrugë dhe hapësira publike në zbatim të Nenit 37 pika 1, të dokumentit të Rregullores së PPV Bashkia Himarë.

**2.** Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë të ndryshuar, specifikisht:


- Nuk plotëson distancën në drejtimin verilindor, që duhej të ishte minimalisht 6m nga kufiri i pasurisë.

- Nuk plotëson distancën në drejtimin veriperëndimor e cila është propozuar 0m, e duhej të ishte minimalisht 6m nga kufiri i pasurisë.

- Nuk plotëson distancën në drejtimin Juglindor e cila është propozuar 1 m, e duhej të ishte minimalisht (nr. kate + 1m) nga kufiri i pasurisë.

- Nuk plotëson distancën në drejtimin Jugperëndimor, distancë e cila është propozuar 0.5 m për volumin 2 kate, dhe duhej të ishte minimalisht 3m nga kufiri i pasurisë.

**3.** Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga infrastruktura rrugore

	<p>në zbatim të Nenit 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nuk plotëson distancën në drejtimin verilindor, që duhej të ishte minimalisht 3 m nga plani më i afërt i faqes së ndërtimit me kufirin e rrugës, që është konsoli, duke miratuar një distancë 0m.</li> <li>- Nuk plotëson distancën në drejtimin veriperëndimor, që duhej të ishte minimalisht 2.5 m nga plani më i afërt i faqes së ndërtimit me kufirin e rrugës, që është konsoli.</li> </ul>
<p><b>Titulli gjetjes</b></p> <p><b>02</b></p>	<p><b>Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 77, Prot.2024/1, datë 19/8/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 22 , datë 03.12.2020 të KKT për objekt "B.", 1-2-3 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje Gjilekë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "H.S."sh.p.k.</b></p>
<p><b>Situata</b></p>	<div style="display: flex; align-items: flex-start;"> <div style="flex: 1;">  </div> <div style="flex: 2; padding-left: 10px;"> <p>Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN120520210062 aplikuar nr.2024 prot. me datë 12.05.2021 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 77, Prot.2024/1, datë 19/8/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për "B. H. Dhërmi", 1-2-3 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë , u konstatua se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. -Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.6.1221, parcela minimale për zhvillim është 3000 m2, ndërsa parcela e zhvilluar me lejen e miratuar me vendim Nr. 77, Prot.2024/1, datë 19.8.2021 është 2000m2, pra leja është miratuar në kundërshtim me treguesit zhvillimorë të PPV Bashkia Himarë.</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Koeficienti maximal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është <math>K_{shtmax}= 30\%</math>, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është <math>K_{shtmiratuar}= 33\%</math>, duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.</li> <li>- Intensiteti maximal i lejuar i ndërtimit është <math>I_{max}=0.4</math>, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është <math>I_{miratuar}=0.9</math>, duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.</li> <li>- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.6.1221, lartësia maksimale e lejuar është <math>H_{max} = 8m</math>, dhe numri i kateve maksimal i lejuar është 2 kate, ndërsa miratimi <math>H_{miratuar}=12.68m</math> dhe numri i kateve të miratuara është 3 kate, pra objekti i miratuar me Vendimin Nr. 77, Prot.2024/1, datë 19.8.2021, tejkalon lartësinë maksimale të lejuar sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Himarë.</li> <li>- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.6.1221, <math>K_{shr}=10\%</math> dhe <math>K_{shp}=20\%</math>, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.</li> </ul> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nuk plotëson distancën në drejtimin lindor, që duhej të ishte minimalisht 3m nga kufiri i pasurisë për volumnin 2 kate.</li> </ul> </li> </ol> </div> </div>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nuk plotëson distancën në drejtimin perëndimor e cila është propozuar 2.5m, e duhej të ishte minimalisht 4m nga kufiri i pasurisë, për volumin 3 Kt.</li> <li>- Nuk plotëson distancën në drejtimin Jugor e cila është propozuar më pak se 1 m, nga një volum i cili trajtohet si konsol, por ka lartësi mbi 50cm nga terreni i sistemuar (rruga) e duhej të ishte minimalisht 2m nga kufiri i pasurisë.</li> </ul> <p>2. Plan i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, i ndryshuar, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët , gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Një informacion i tillë mungon. <i>Për sa më sipër Plani i rievimit është i pasaktë.</i></p>
<b>Titulli gjetjes</b>  <b>3</b>	<b>Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 39, Prot.832/1, datë 1/7/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 25 , datë 14.10.2020 të KKT për objekt “D.”, me vendndodhje në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria “B.” sh.p.k.</b>
<b>Situata</b>	<div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div data-bbox="316 707 981 1220" style="width: 45%;"> </div> <div data-bbox="1034 748 1406 1146" style="width: 50%;"> <p>Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN110220210090 aplikuar nr.832 prot. me datë 12.02.2021 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.39, Prot.832/1, datë 1/7/2021 për oD. Beach Hotelö, u konstatua se:</p> <p>1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë të cilat zhvillohen bëjnë pjesë në njësinë strukturore <b>HI.UB.3.1199</b>:</p> <p><b>HI.UB.3.1199</b>, me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim dhe nënkategori S.2_Zonë hotelesh/shërbime turistike; S.1_Dyqane, Shërbime personale, Qendra Lokale Multifunkionale; AR_Aktivitete sociale dhe rekreative; A.5_Zona me shtëpi të dyta.</p> <p>2. Sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Himarë zhvillimi në këtë njësi strukturore duhet të kryhet me anë të një PDV-je. Nga Bashkia Himarë është filluar nisma për hartimin e një PDV me datë 5/31/2018, por ky proces nuk është finalizuar. Për sa u shpjegua , kjo leje është miratuar në mungesë të PDV, pra në kundërshtim me dokumentin e planifikimit siç është PPV Bashkia Himarë.</p> <p>3. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në njësinë strukturore HI.UB.3.1199 është <math>Ksht_{max} = 40\%</math>, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është <math>Ksht_{miratuar} = 46\%</math>, duke tejkaluar limitet e treguesve zhvillimorë të përcaktuar në dokumentin e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.</p> <p>4. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është <math>I_{max} = 0.4</math>, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është <math>I_{miratuar} = 1.8</math>, duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.</p> <p>- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.1199, lartësia maksimale e lejuar është <math>H_{max} = 11.0m</math>, dhe numri i kateve</p> </div> </div>

	<p>maksimal i lejuar është 3 kate, ndërsa miratimi Hmiratuar=23.20m dhe numri i kateve të miratuara është 6 kate, pra dyfishi i lartësisë së lejuar bazuar në dokumentin e planifikimit PPV bashkia Himarë, duke tejkaluar lartësinë maksimale të lejuar sipas përcaktimeve të tij..</p> <p>- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.1199, Kshr=15% dhe Kshp=10%, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.</p> <p>5. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 780,021,278.0 lekë.</p> <p>Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë me nr.9 datë 29.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit , vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.100 datë 31.05.2021 është përllogaritur me vlerën 26825813.1 lekë. Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del <math>4\% * 780,021,278.0 = 31,200,851.12</math>lekë.</p> <p>Nga subjekti òBò shpk me mandatin e BKT datë 01.06.2021 janë paguar 26825813.1 lekë.</p> <p><b>Vlera e llogaritur nga Bashkia Himarë me mungesë prej 4,375,038.02 lekë përbën arkëtim të munguar si rrjedhojë dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë.</b></p> <p>Për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e vlerave monetare, duke shkaktuar të ardhura të munguara me dëm financiar për institucionin ngarkohet me përgjegjësi z. L.M..</p>
<p><b>Titulli gjetjes</b></p> <p>4</p>	<p><b>Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 104, Prot.3810/1, datë 14/12/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 10, datë 28.02.2020 të KKT për objekt "I." (kompleks hotelerie 2 dhe 3 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë) me vendndodhje Dhërmi në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria "I." ShPK.</b></p>
<p><b>Situata</b></p>	<p>Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit për aplikimin me AN111120200092 dhe nr.3810 prot. me datë 11.11.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 104, Prot.3810/1, datë 14/12/2020 për "I. hotel Dhërmiö (kompleks hotelerie 2 dhe 3 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë), u konstatua se:</p> <p>1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë të cilat zhvillohen bëjnë pjesë në njësinë strukturore <b>HI.UB.3.1189</b>: <b>HI.UB.3.1189</b>, me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim dhe nënkategori S.2_Zonë hotelesh/shërbime turistike; S.1_Dyqane, Shërbime personale, Qendra Lokale Multifunkionale; AR_Aktivitete sociale dhe rekreative; A.5_Zona me shtëpi të dyta.</p> <p>Sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Himarë zhvillimi në këtë njësi strukturore duhet të kryhet me anë të një PDV-je. Nga Bashkia Himarë është filluar nisma për hartimin e një PDV me datë 6/29/2018, por ky proces është finalizuar me miratimin e PDV me Vendim nr.20 datë 26.03.2021. Për sa u shpjegua, kjo leje është miratuar në mungesë të PDV, pra në kundërshtim me dokumentin e planifikimit siç është PPV Bashkia Himarë.</p>



Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në njësinë strukturore HI.UB.3.1189 është  $K_{shtmax}= 25\%$ , ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është  $K_{shtmiratuar}= 37.7\%$ , duke tejkaluar limitet e treguesve zhvillimorë të përcaktuar në dokumentin e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

- Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është  $I_{max}=0.4$ , ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është  $I_{miratuar}= 0.81$ , duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

- *Këta dy tregues Ksht dhe I, janë edhe më të lartë tek miratimi i vendimit Nr. 104, Prot.3810/1, datë 14/12/2020, pasi në llogaritje nuk janë shtuar ksht dhe intensiteti i objekteve ekzistuese të cilat nuk prishen, dy godina hoteli 3kt.*

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.1189, lartësia maksimale e lejuar është  $H_{max} = 11.0m$ , dhe numri i kateve



maksimal i lejuar është 3 kate, ndërsa miratimi  $H_{miratuar}=17.20m$  dhe numri i kateve të miratuara është 3 kate, duke tejkaluar lartësinë maksimale të lejuar sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Himarë.

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore

HI.UB.3.1189,

$K_{shr}=15\%$  dhe

$K_{shp}=10\%$ , në këtë leje

nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

3. Objekti i miratuar parashikon sistemime jashtë kufirit të pasurisë, duke cënuar pasuritë kufitare, në kundërshtim me legjislacionin për të drejtat e pronës.

4. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në drejtimin perëndimor, që duhej të ishte minimalisht 4m nga kufiri i pasurisë për volumin 3 kate.

- Nuk plotëson distancën në drejtimin jugor e cila është propozuar 0m, e duhej të ishte minimalisht 3m për objektin 2 kate nga kufiri i pasurisë.

- Nuk plotëson distancën në drejtimin lindor e cila është propozuar më pak se 3 m, nga një volum 2 kate.

5. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga trupi i rrugës (përfshirë edhe trotualet) në zbatim të Nenit 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në drejtimin jugor, që duhej të ishte minimalisht 3m nga trupi i rrugës.


Titulli  
gjetjes

5

Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.6 , datë 07. 02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 103, datë 09/10/2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Hoteleri 2 kate me 1 kat nëntokë dhe pishinë” me vendndodhje Livadh në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria “S.” ShPK.

**Situata**

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>, aplikuar me AN051120190085 dhe nr.3104 prot. me datë 05.11.2019 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.6, datë 07.02.2020 për òHoteleri 2 kate me 1 kat nëntokë dhe pishinë, u konstatua se:



1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:

- Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në njësinë strukturore HI.UB.10.218 është  $K_{shtmax} = 20\%$ , ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje e

tejkalon këtë tregues zhvillimor, pasi nuk janë hequr nga parcela e vënë në dispozicion sipërfaqja për rrugë dhe parkime në kundërshtim me dokumentin e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

- Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është  $I_{max} = 0.25$ , ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është  $I_{miratuar} = 0.3$ , duke tejkeluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

**Titulli gjetjes**  
**6**

**Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 87, Prot.2022/1, datë 22/9/2021, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 27, datë 14.10.2020 të KKT për objekt “Struktura me funksion apart-hotel 1 dhe 2 kat, parkim dhe ambiente ndihmëse nëntokë”, Drimadhë në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues F.D..**

**Situata**



Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m<sup>2</sup>, aplikuar me AN060520210087 dhe nr.2022 prot. me datë 06.05.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.87, Prot.2022/1, datë 22/9/2021 për objekt òStruktura me funksion apart-hotel 1 dhe 2 kat, parkim dhe ambiente ndihmëse nëntokë, u konstatua se:

1. Plan i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë

13.05.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, i ndryshuar, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Plani i rilevimit i paraqitur është me një kontur të ndryshëm nga ai i pasurisë me nr.36/2 ZK1739, dhe ka emërtim të pronarëve të tjerë. Gjithashtu edhe informacioni i sipërpërmendur mbi pasuritë dhe

objektet kufitare mungon. Për sa më sipër Plani i rilevimit është i pasaktë.

2. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi

- Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në njësinë strukturore HI.UB.3.1191 është  $K_{shtmax} = 25\%$ , ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është  $K_{shtmiratuar} = 29.1\%$ , duke tejkaluar limitet e treguesve zhvillimorë të përcaktuar në dokumentin e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

- Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është  $I_{max} = 0.4$ , ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është  $I_{miratuar} = 0.54$ , duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.1199,  $K_{shr} = 15\%$  dhe  $K_{shp} = 10\%$ , në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

3. Kjo leje ka shkelur kërkesat për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme, pasi edhe aksesin për në pronë bëhet duke kaluar nga pasuria nr.1/82 për të cilën nuk është dhënë informacion dhe nuk është marrë asnjë dakortësi. Në këtë rast janë shkelur dispozitat ligjore për detyrimin e ekzistencës së infrastrukturës me kusht që të lëshohet leja e ndërtimit, në zbatim të Nenit 45 të Ligjit 107/2014 për planifikimin dhe zhvillimin e territoritë ndryshuar.

4. **Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritë ndryshuar, specifikisht:**

- Nuk plotëson distancën në drejtimin verilindor e cila duhet të ishte minimalisht 3m për objektin 2kate.

- Nuk plotëson distancën në drejtimin juglindor e cila është propozuar 0.0m e cila duhet të ishte minimalisht 3 m, nga një volum 2 kate.

Titulli gjetjes

7

**Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 71, Prot.1537/1, datë 16/07/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 56, Prot.1007/1, datë 27/05/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Banesë individuale 2 katëshe” me vendndodhje në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues L.K.**

Situata

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe deri në 250m<sup>2</sup>, aplikuar me AN030620200016 dhe nr.1537prot. me datë 03.06.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.71 Prot.1537/1, datë 16/07/2020 për objekt *o*Banese\_individuale 2 katë, u konstatua se:

1. Plan i rilevimit të pronës mungon duke shkelur kërkesat ligjore në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritë, i ndryshuar, ku planvendosjen e cila miratohet duhet të hartohet mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë.



2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në drejtimin perëndimor dhe verior e cila është ruajtur 0.5m me faqe kallkan, duhet të ishte minimalisht 3m për objektin 2kate.

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga objektet kufitare në zbatim të Nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në drejtimin jugor nga objekti ekzistues brenda konturit të supozuar të pasurisë, distancë e cila duhet të ruhej minimalisht 5m.


4. Treguesit e distancave të përcaktuar në nenin 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, për faqet kallkan përfshijnë vetëm rastin e objekteve që qëndrojnë përballë njëri tjetrit, të cilët nuk kanë çarje të çfarëdolloj në fasadë dhe për të cilët kur nuk sigurohet deklarata e kallkanit mund të pozicionohen 1 m nga kufiri i pronës. Në rastin konkret projekti është hartuar e miratuar pa asnjë informacion lidhur me çarjet në faqet e objekteve 1 katëshe në kufirin perëndimor, nga ana tjetër pozicionimi 0.5m nga kufiri i pronës, në zonat ku objekti i lejes nuk qëndron përballë një objekti tjetër, është totalisht i kundërligjshëm pasi nuk respekton përcaktimet e nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, që e detyrojnë objektin të largohet të paktën 3m nga ky kufi.

**Titulli gjetjes**

**8**

**Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 75, Prot.3308, datë 11/8/2021, datë të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 75, Prot.1536/1, datë 24/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Objekt individual banimi 2 kat” me vendndodhje në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues A.C..**

**Situata**



Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe deri në 250m<sup>2</sup>, aplikuar me AN021020200035 dhe nr.3221 prot. me datë 02.10.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.75, Prot.3308, datë 11/8/2021 për òObjekt individual banimi 2katò u konstatua se:

Objekti i miratuar është propozuar në pasurinë nr.1183

vol.3, fq.185 ZK2963 me sip.208m<sup>2</sup>, status truall me ndërtesë ekzistuese në të 72m<sup>2</sup>, në pronësi të A. Ç.

Për këtë objekt janë konstatuar një sërë shkeljes të legjislacionit në fuqi si vijon:

1. Plan i rilevimit të pronës mungon duke shkelur kërkesat ligjore në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò, i ndryshuar, ku planvendosjen e cila miratohet duhet të hartohet mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët , gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë.

**2. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë,** miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuria e cila zhvillohet bën pjesë në njësinë strukturore **LU.UB.4.73:**

**LU.UB.4.73,** me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore A. Banim dhe nënkategori S.1\_Dyqane, Shërbime Personale, Qendra Lokale Multifunksionale, AR\_Aktivitete sociale dhe rekreative,S.5\_Format turizmi të Veçantë (ekoturizmi, agroturizmit, turizmi kulturor).

- Lartësia maksimale e lejuar sipas njësisë LU.UB.4.73 është 8m, ndërsa lartësia maksimale e miratuar në këtë leje ndërtimi është 8.45m, duke tejkualuar përcaktimet ligjore që sjell detyrimi i zbatimit të PPV Bashkia Himarë.

- Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është  $I_{max}=0.8$ , ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është  $I_{miratuar}=0.87$ , tejkalon kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë, duke shkelur kështu detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky dokument. Madje ky intensitet është paraqitur më i ulët në planvendosjen e miratuar duke tjetërsuar të dhënat e treguesve zhvillimorë.

- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore LU.UB.4.73,  $K_{shr}=5\%$  dhe  $K_{shp}=5\%$ , në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

**3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015** òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në drejtimin perëndimor e cila është ruajtur 0m duhet të ishte minimalisht 2m për objektin 1kat nga kufiri i pasurisë.

**4. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga objektet kufitare në zbatim të Nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015** òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në drejtimin verilindor nga objekti ekzistues, distancë e cila duhet të ruhej minimalisht 5m. (*nr. kateve obj.1+nr.kat.obj2 +2m =1+2+2=5m*).

- Nuk plotëson distancën në drejtimin juglindor nga 2 objektet ekzistuese, distancë e cila duhet të ruhej minimalisht 5m.

**5. Për prishjen e ndërtimit ekzistues nuk është lëshuar leje ndërtimi e posaçme dhe as nuk është përfshirë lejimi i prishjes në lejen e ndërtimit për objektin e ri,** veprim i cili ka shkaktuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën që përftohej nga gjoba që ky zhvillues duhet të paguante për mospajisjen me leje për prishjen e objektit ekzistues prej 72m<sup>2</sup>, duke shkelur parashikimet ligjore në Ligjin nr.107/2014 òPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, neni 39 pika 1 dhe pika 3, ku përcaktohet se:

*1.Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.*

*3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.*

Në nenin 52 òKundërvajtjet administrativeò shkronja æpërcaktohet se:

e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për .....

**Titulli Leje për ndryshimin e projektit gjatë zbatimit miratuar me Vendim Nr. 78,**

<b>gjetjes</b>  <b>9</b>	<b>Prot.2301/1, datë 19/8/2021, Kryetarit të Bashkisë Himarë për rishikim të kushteve të lejes për objektin: "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë dhe pishine (objekti 1) me shtesë 2 kat mbitokë" për "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë ("R" ShPK - objekti 1), Objekt banimi 4 kat me 1 kat nëntokë ("G." ShPK - objekti 2) dhe 2 Objekte hoteleri 4 kat me 1 kat nëntokë dhe pishine (G. ShPK - objekti 3 dhe 4) sh.p.k me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë.</b>
--------------------------------	---

**Situata** Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, aplikuar me AN070620210052 dhe nr.2301\_2021 prot. me datë 07.06.2021 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Vendim Nr.78, Prot.2301/1, datë 19/8/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë: "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë dhe pishine (objekti 1) me shtesë 2 kat mbitokë" me zhvillues òR.-04ò u konstatua se:  
Me anë të këtij miratimi janë ndryshuar treguesit e zhvillimit për objektin 1 "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë dhe pishinë me zhvillues òR. 04ò, të miratuar me Vendim Nr.04 , Prot 291, Date 31/01/2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë , të cilit i shtohen 2 kate "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë dhe pishine (objekti 1) me shtesë 2 kat mbitokë" me zhvillues po òR. 04ò si vijon:

Treguesit e zhvillimit	E miratuar me Vendim Nr.04 Prot 291, date 31/01/2019	E miratuar me Vendim Nr. 78, Prot.2301/1, datë 19/8/2021
Sipërfaqe ndërtimi nëntokë	6940.7 m <sup>2</sup>	6940.7
Sipërfaqe mbi tokë (pa ballkone)	6358 m <sup>2</sup>	8400 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe mbi tokë me ballkone	7246.8 m <sup>2</sup>	9288.8 m <sup>2</sup>
Numri i kateve	4	6
Ksht	22%	22%
Sipërfaqe tarracë e shfrytëzueshme	1994.8 m <sup>2</sup>	1191.4 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe totale ndërtimi	16182.3 m <sup>2</sup>	17420.9 m <sup>2</sup>

**1.** Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Nenin 48 të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" me të gjitha ndryshimet, ku sipas këtij neni ndryshimet në projekt gjatë ndërtimit mund të kryhen vetëm për raste të shfaqjes së situatave të paparashikuara ekonomike dhe realizimi i projektit të miratuar është i pamundur të zbatohet. Ndërkohë që ky aplikim për ndryshim projekti nuk ka asnjë arsytim mbi pamundësinë e zbatimit të projektit të miratuar me Nr.04 Prot 291, date 31/01/2019.

*Neni 48*

*Rishikimi i kushteve të lejes dhe ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit*

*1. Kushtet e tjera të lejes së ndërtimit dhe projekti i zbatimit mund të rishikohen në rast se gjatë kryerjes së punimeve të ndërtimit hasen situata të paparashikuara ekonomike dhe teknike që e bëjnë të pamundur realizimin e projektit të miratuar me lejen e ndërtimit.*

**2.** Kjo leje, është lëshuar në kundërshtim me Nenin 17 të VKM 408 datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò të ndryshuar, pasi punimet e parashikuara dhe shtesat në objekt nuk janë subjekt i asnjë prej rasteve që parashikon ky Nen i VKM-së për miratim të ndryshimeve.

*Neni 17 Ndryshimi i projektit gjatë ndërtimit*

*1. Rastet, në të cilat mund të ndryshohet projekti i ndërtimit, sipas nenit 48, të ligjit, në përputhje me dokumentet e planifikimit në fuqi, janë ndryshim:*

*a) të sistemit konstruktiv të objektit apo të punimeve teknike në zbatim;*

*b) të numrit dhe formës së njërive brenda objektit;*

	<p>c) për përmirësimin e eficiencës energjetike;  ç) në instalime, për sa kohë që rritet cilësia e punimeve;  d) për të shtuar elemente arkitektonike, për përdorim të barabartë e të pavarur të hapësirave të projektuara nga të gjithë personat, përfshirë ata me aftësi të kufizuara;  dh) ndryshime në fasadë;  e) ndryshime që rezultojnë në ndryshimin e sipërfaqes ndërtimore të objektit, mbi tokë dhe nën tokë, brenda kufijve dhe kushteve urbane të zhvillimit, me kusht që ndryshimi i sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të mos tejkalojë masën 2% të sipërfaqes ndërtimore mbi tokë të miratuar në lejen e ndërtimit.</p>
<b>Titulli gjetjes</b>  <b>10</b>	<b>Leje për Rikonstruksionin e objektit pa ndryshim funksioni miratuar me Nr. 28, Prot.1706, datë 6/5/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për “Rindërtim i objektit ekzistues 1 kat dhe mur mbajtës” me zhvillues O.M., në Borsh, në territorin administrativ Bashkia Himarë.</b>
<b>Situata</b>	<p>Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, aplikuar me AN310820200059 dhe nr.2757 prot. me datë 31.08.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 28, Prot.1706, datë 6/5/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për Rindërtim i objektit ekzistues 1 kat dhe mur mbajtës u konstatua se:</p> <p><b>1.</b> Në kundërshtim me legjislacionin për kontrollin dhe planifikimin e territorit, Nenin 9, pika 5, kjo leje duhej të shoqërohej me Leje zhvillimi paraprakisht.  Neni 9, pika 5, VKM 408/2015  Leja e zhvillimit nuk është e nevojshme për pajisjen me leje ndërtimi për punimet sipas shkronjave “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 11.  Neni 11, pika b,c,ç, VKM 408/2015</p> <p>b) rezultojnë në rikonstruksion, riparim dhe restaurim që çojnë në krijimin e një strukture tërësisht, ose pjesërisht të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe që kanë si pasojë shtimin e njësisive dhe/ose ndryshimin e vëllimit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtimit, pamjes së jashtme të objektit, të përdorimit, ose të sistemit konstruktiv</p> <p>c) realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme sipas kësaj rregulloreje, të shoqëruar me ndryshime të sistemit konstruktiv të objektit</p> <p>ç) kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri. Nëse prishja shoqërohet me ndërtim të ri, leja për prishje është pjesë e lejes së ndërtimit dhe shënohet në kushtet e dokumentit të lejes.</p> <p><b>2.</b> Kjo leje ndërtimi është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 157 ditësh pune, duke shkelur kështu përcaktimet ligjore të nenit 20 dhe 21 të VKM 408/2015 ÷Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit të ndryshuar.</p>
<b>Titulli gjetjes</b>  <b>11</b>	<b>Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin “Njësi akomoduese, hoteleri dhe bujtina 2, 3, dhe 4 kate dhe 3 kate nëntokë, pishinë” , në adresën Potam, Bashkia Himarë, me zhvillues “B.” sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me nr.8 prot. datë 23.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe rishikuar me Vendim Nr. 104 Nr. Prot. 3369, datë 30/10/2017 .</b>



Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit për objektin e miratuar me vendimet e sipërcituara rezulton se:

1. Kjo certifikatë përdorimi është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar , pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, siç është:

- Vërtetim nga IMT Himarë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim.
- Foto të objektit në të gjitha drejtimet (nuk janë paraqitur të gjitha drejtimet).

2. Nga verifikimi në terren objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, kjo e vërtetuar edhe me dokumentacion fotografik vihet re se kati tarracë, i cili duhej të kishte vetëm kafazin e shkallëve me dimensione 380x720 cm, sipas projektit të miratuar, në terren ka ndërtuar një sipërfaqe më të madhe, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, IMT Bashkia Himarë ka anashkaluar përgjegjësitë e veta, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar me Vendim nr. 7 datë 11.02.2020.

3. Përsa i përket pagesës së tarifës për pajisje me certifikatë përdorimi, për këtë objekt është përlllogaritur pagesa me faturën nr.2 datë 27.01.2020 dhe është paraqitur mandati i Raiffeisen Bank me datë 10.02.2020 me vlerë 909.086 lekë.

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë me nr.201 datë 23.11.2018 vlera e tarifës për pajisje me Certificate përdorimi është 100 lekë/m<sup>2</sup>. Përlllogaritja për objektin nuk është e qartë, pasi sipërfaqja totale në m<sup>2</sup> (duke përfshirë nëntokën, ballkonet etj), nuk është shkruar në asnjë dokument.

Sipas dokumentacionit të paraqitur vlera e preventivuar e objektit është 840970982 lekë, ndërsa nga situacioni përfundimtar vlera përfundimtare e punimeve të objektit është 111,525,144 lekë.

Nisur nga legjislacioni në fuqi vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit.

Për diferencën  $111,525,144 - 84,097,982 = 27,427,162$  lekë, zhvilluesi dhe investitori duhej të paguanin taksën e ndikimit në infrastrukturë. Pra duhej të paguanin  $4\% * 27,427,162 = 1,097,086.48$  lekë.

Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.2 datë 27.01.2020 nuk është përlllogaritur, duke i shkaktuar të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar institucionit Bashkia Himarë me



	<p>vlerë <b>1,097,086.48</b> lekë.</p> <p>Për përlogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit òB.ò me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Himarë, <b>ngarkohet me përgjegjësi z. L.M..</b></p> <p>Sa më sipër, <b>përmes miratimit të kësaj certifikate përdorimi janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave, me qëllim përfitimin e padrejtë të zhvilluesit “B.” ShPK.</b></p>
<p><b>Titulli gjetjes</b></p> <p><b>12</b></p>	<p><b>Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.76, prot 2862, datë 05/10/2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 66, nr.prot.2351, datë 01/08/2018 të kryetarit të Bashkisë Himarë, për objektin “Shtese 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 kat” me vendndodhje në Livadh në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues E.K. dhe R.M..</b></p> <p><b>Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 70, Prot.1371/1, datë 16/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin “Shtesë 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 kat”, në adresën Livadh, Bashkia Himarë, me zhvillues E.K. dhe R.M..</b></p>
<p><b>Situata</b></p>	<p>Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN130820180002 aplikuar nr.2438 prot. me datë 13.08.2018 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Vendim nr.76 , prot 2862, datë 05/10/2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për òShtese 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 katò, u konstatua se:</p> <p><b>1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuria e cila zhvillohet me nr. pasurie 213/14 vol.55 fq.13 ZK.1952 me sip.800m2 truall bën pjesë në njësinë strukturore:</b></p> <p><b>HI.UB.10.1138, me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim dhe nënkategori S.2_Zonë hotelesh/shërbime turistike; S.1_Dyqane, Shërbime personale, Qendra Lokale Multifunkionale; AR_Aktivitete sociale dhe rekreative; A.5_Zona me shtëpi të dyta.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sipas përcaktimeve kjo njësi strukturore duhej të zhvillohej përmes një PDV-je.</li> <li>- Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është <math>I_{max}=0.4</math>, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është <math>I_{miratuar}=0.54</math>, duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.</li> <li>- Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.10.1138, <math>K_{shr}=15\%</math> dhe <math>K_{shp}=10\%</math>, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.</li> </ul> <p><b>2. Kjo leje ndërtimi është miratuar në mungesë të planit të rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò, i ndryshuar, i cili duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Një informacion i tillë mungon. Për sa më sipër leja e ndërtimit është miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore.</b></p> <p><b>Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së përdorimit për objektin e miratuar me vendimet e sipërcituara rezulton se:</b></p> <p><b>1. Kjo certifikatë përdorimi është miratuar në kundërshtim me përcaktimet</b></p>

ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar , pasi certifikata e pòrdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, siç është:

- òProjekti për mirëmbajtjen e objektitò, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të pòrcaktuara, të gjendjes së të gjitha sistemeve pòrbërëse, sipas disiplinave pòrkatëse të zbatimit të punimeve.

- Vòrtetim nga IMT Himarë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim pa pajisje me certifikatë pòrdorimi.

- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe kolaudatorit të punimeve, shoqëruar me licencën pòrkatëse.

- Foto të objektit në të gjitha drejtimet (nuk janë paraqitur të gjitha drejtimet)

- Aktet pòrkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.), të lëshuara nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane;

- Policën e sigurimit të pèrgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të pèrfunduar;

2. Nga verifikimi në terren objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar me Vendim nr.76, prot 2862, datë 05/10/2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, kjo e vòrtetuar edhe me dokumentacion fotografik vihet re se në katin tarracë në kuotën +9.45 nuk duhej të kishte dalje në tarracë dhe mbulim kafazi shkallësh, duke shkelur pòrcaktimet e projektit të miratuar, në kundërshtim kjo me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, IMT Bashkia Himarë ka anashkaluar pèrgjegjësitet e veta, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar me Vendim nr.76, prot 2862, datë 05/10/2018.



<b>Titulli gjetjes</b>  <b>13</b>	<b>Certifikatë pòrdorimi miratuar me Nr. 95, Prot. 3004/1, datë 28/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin “Objekt 2 kat mbi toke dhe 1 kat nëntokë, hotel, restorant, pishinë”, në adresën Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me zhvillues “E.B.” sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me nr.85 prot.2461 datë 16.08.2017 të Kryetarit të Bashkisë Himarë.</b>
---	--

<b>Situata</b>	Nga auditimi i procedurës së miratimit të certifikatës së pòrdorimit, aplikuar me AN190920200013 dhe nr.3004 prot. me datë 19.09.2020 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 95, Prot. 3004/1, datë 28/10/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt òObjekt 2 kat mbi toke dhe 1 kat nëntokë, hotel, restorant, pishinëò, në adresën Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me zhvillues òE. Beachò sh.p.k u konstatua se:
----------------	---

1. Kjo certifikate pòrdorimi është miratuar në kundërshtim me pòrcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar , pasi certifikata e pòrdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, siç është:

- Vòrtetim nga IMT Himarë që objekti nuk është vënë në shfrytëzim.

- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve, shoqëruar me licencën pòrkatëse.

- Kontrata e nënshkruar, ndërmjet zhvilluesit dhe kolaudatorit të punimeve,

shoqëruar me licencën përkatëse.

2. Përsa i përket pagesës së tarifës për pajisje me certifikatë përdorimi, për këtë objekt është përlllogaritur pagesa me faturën nr.56 datë 23.10.2020 dhe është paraqitur mandati i B. A. të investimeve me datë 26.10.2020 me vlerë 980,900 lekë.

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë me nr.201 datë 23.11.2018 vlera e tarifës për pajisje me Certificate përdorimi është 100 lekë/m<sup>2</sup>. Përlllogaritja për objektin me sipërfaqe 4744 mbi toke dhe 5065 nën toke = 9809m<sup>2</sup> është e saktë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur në aplikimin me nr. 1931 datë 30.06.2017 vlera e preventivuar e objektit është 96,510,449 lekë, ndërsa nga situacioni përfundimtar vlera përfundimtare e punimeve të objektit është 316,253,640 lekë.

Nisur nga legjislacioni në fuqi vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit.

Për diferencën  $316,253,640 - 96,510,449 = 219,743,191$  lekë, zhvilluesi dhe investitori duhej të paguanin taksën e ndikimit në infrastrukturë. Pra duhej të paguanin  $4\% * 219,743,191 = 8,789,727.64$  lekë.

Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.56 datë 23.10.2020 nuk është përlllogaritur, **duke i shkaktuar të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar institucionit Bashkia Himarë në vlerën prej 8,789,727.64 lekë.**

Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit òE. B. R.ò me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Himarë, **ngarkohet me përgjegjësi z. L.M..**

Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Nr. 95, Prot. 3004/1, datë 28/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, **ngarkohet me përgjegjësi z. F.B. dhe z. G.S. drejtues i DPKZHT**, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me Nr.16, datë 23.10.2020 me lëndë: òRelacion i Vlerësimit Teknikò; Për mos llogaritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për diferencën situacion-preventiv, me pasojë mos arkëtimin e vlerave monetare **ngarkohet me përgjegjësi z. L.M.**; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G. në zbatim të nenit 29 pika c) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për certifikatë përdorimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.120/5, datë 17.01.2022, protokolluar në KLSH me nr.594/9, datë 20.01.2022 nga Drejtori i Drejtorisë së Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Himarë, ku janë shprehur observacionet si më poshtë:*

*Mbi aplikimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, duke sqaruar se sipas VKB nr. 54, datë 23.11.2019 "Për paketën fiskale 2020", është bërë ndarja e përgjegjësiave ligjore dhe kompetencave nëpër drejtoritë përkatëse, nga ku struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është DPKZHT dhe të ardhurat arkëtohen nga Drejtoria e të Ardhurave.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** *Pretendimet e paraqitura nga ana juaj merren pjesërisht në konsideratë përsa i përket rregullimit të bërë nga Bashkia Himarë, Këshilli Bashkiak me VKB nr. 54, datë 23.11.2019 "Për paketën fiskale 2020", pavarësisht kësaj për përlllogaritjen e vlerës së taksës, si e ardhur e drejtpërdrejtë për bashkinë përcaktimi i saj bëhet nga rakordimi ndërmjet dy strukturave të bashkisë dhe konkretisht DPKZHT si struktura miratuese (e lejeve) prej vendimmarrjes të cilës buron e ardhura dhe DIZHE si struktura në favor të së cilës kalon e ardhura e krijuar (taksa). E cila është po ashtu*

struktura e cila lëshon rast pas rasti formularin përkatës për llojin dhe sasinë e taksës për tu paguar nga përfituesi i lejes.

Detyrimi i strukturave të sipërcituara është i ndërsjelltë, duke ngarkuar me përgjegjësi paralelisht si DIZHE ashtu edhe DPKZHT.

**Pretendimet e Subjektit:** Me shkresën nr. 120/5, datë 17.01.2022, Administruar nga KLSH me nr. 594/9, datë 20.01.2022, Bashkia Himarë ka dërguar observimet dhe shpjegimet për projektraportin e auditimit (152 faqe, 4 CD), shoqëruar me deklaratën për njohjen e Projektraportit të auditimit.

Sipas dokumenteve bashkëlidhur është observuar nga Drejtori i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit z. G.S., shkresa nr. 120/1, datë 13.01.2022, janë paraqitur pretendimet/kundërshtimet tekniko-ligjore për secilën leje të lëshuar nga Bashkia Himarë dhe konkretisht struktura e drejtuar për tij (22 fletë).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimet e paraqitura nga ana juaj merren pjesërisht në konsideratë, duke u bërë edhe ndyshimet/korrigjimet përkatëse në Raportin përfundimtar të auditimit, si më poshtë vijon:

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 83, Prot.2299/1 datë 26/8/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi miratuar me Vendim Nr. 19, datë 28.07.2020 të KKT për objektin "Strukturë hotelerie dhe shërbimi 1-5 kate", në adresën Gjilekë, Bashkia Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1 dhe 4 dhe është marrë parasysh pjesërisht për pikat 2 dhe 3 përsa i përket delegimit të kompetencave.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 77, Prot.2024/1, datë 19/8/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 22, datë 03.12.2020 të KKT për objekt "B. hotel Dhërmi", 1-2-3 kate mbitokë dhe 2 kate nëntokë, me vendndodhje Gjilekë, Bashkia Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 5 dhe 6 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2, 3, 4 dhe 7.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 39, Prot.832/1, datë 1/7/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 25, datë 14.10.2020 të KKT për objekt "D. Beach Hotel", me vendndodhje në territorin e Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 5, 6, 7 dhe 8 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2, 3, 4 dhe 9.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 104, Prot.3810/1, datë 14/12/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 10, datë 28.02.2020 të KKT për objekt "I. hotel Dhërmi" (kompleks hotelerie 2 dhe 3 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë) me vendndodhje Dhërmi në territorin e Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 3, 4 dhe 9 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2, 5, 6, 7 dhe 8.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.6, datë 07.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 103, datë 09/10/2019 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Hoteleri 2 kate me 1 kat nëntokë dhe pishinë" me vendndodhje Livadh në territorin e Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 2, 3 dhe 4.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 87, Prot.2022/1, datë 22/9/2021, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 27, datë 14.10.2020 të KKT për objekt "Struktura me funksion apart-hotel 1 dhe 2 kat, parkim dhe ambiente ndihmëse nëntokë", Drimadhë në territorin e Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 3, 6 dhe 8 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2, 4, 5, dhe 7.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 71, Prot.1537/1, datë 16/07/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 56, Prot.1007/1, datë 27/05/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Banesë individuale 2 katëshe" me vendndodhje në territorin e Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1 dhe 2 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 3, 4 dhe 5.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 75, Prot. 3308, datë 11/8/2021, datë të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 75, Prot.1536/1, datë 24/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Objekt individual banimi 2 kat" me vendndodhje në territorin e Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 3, 6, 7, 8 dhe 9 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2, 4 dhe 5.

-Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues miratuar me Vendim Nr. 4, Prot.290, datë 22/1/2021, Kryetarit të Bashkisë Himarë "Leje ndërtimi (për ndryshim subjekti zhvillues)" për "Struktura shërbimi 3 kate me 2 kate nëntokë dhe pishine", me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë, janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjet nr. 1, 2, 3 dhe 4.

-Leje për ndryshimin e projektit gjatë zbatimit miratuar me Vendim Nr. 78, Prot.2301/1, datë 19/8/2021, Kryetarit të Bashkisë Himarë për rishikim të kushteve të lejes për objektin : "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë dhe pishine (objekti 1) me shtesë 2 kat mbitokë" për "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2,3 dhe 4 kat me 2 kat nëntokë (objekti 1), Objekt banimi 4 kat me 1 kat nëntokë (objekti 2) dhe 2 Objekte hoteleri 4 kat me 1 kat nëntokë dhe pishine (objekti 3 dhe 4) sh.p.k me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 3 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 1 dhe 2.

-Leje për Rikonstrukcionin e objektit pa ndryshim funksioni gjatë zbatimit miratuar me Nr. 24, Prot.1573/1, datë 26/4/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për "Mbulesë çati dhe riorganizim i hapësirave të brendshme në objekt ekzistues banimi 5 kate", në territorin administrativ Bashkia Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh të gjitha pretendimet tuaja mbi gjetjet nr. 1, 2 dhe 3.

-Leje për Rikonstrukcionin e objektit pa ndryshim funksioni miratuar me Nr. 28, Prot.1706, datë 06/5/2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për "Rindërtim i objektit ekzistues 1 kat dhe mur mbajtës", Borsh, në territorin administrativ Bashkia Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2 dhe 3.

-Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin "Njësi akomoduese, hoteleri dhe bujtina 2, 3, dhe 4 kate dhe 3 kate nëntokë, pishinë", në adresën Potam, Bashkia Himarë, me leje ndërtimi miratuar me nr.8 prot. datë 23.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe rishikuar me Vendim Nr. 104 Nr. Prot. 3369, datë 30/10/2017 . Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1 (pjesërisht vetëm për objektin për mirëmbajtjen e objektit dhe kontratën e nënshkruar me mbikëqyrësin e punimeve) dhe nuk është marrë parasysh për pikat 2, 3, 4 dhe 5.

-Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr.76, prot 2862, datë 05/10/2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 66, nr.prot.2351, datë 01/08/2018 të kryetarit të Bashkisë Himarë, për objektin "Shtese 2 kate në objekt ekzistues shërbimi 1 kat" me vendndodhje në Livadh. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 2, 4 dhe 5 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 1 dhe 3.

Çertifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 70, Prot.1371/1, datë 16/07/2020 për objektin "Shtesë 2 kate në objekt ekzistues shërbimi 1 kat" Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 3 dhe nuk është marrë parasysh për pikat 1 dhe 2.

-Certifikatë përdorimi miratuar me Nr. 95, Prot. 3004/1, datë 28/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin "Objekt 2 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, hotel, restorant, pishinë", në adresën Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me leje ndërtimi miratuar me nr.85 prot.2461 datë 16.08.2017 të Kryetarit të Bashkisë Himarë. Për këtë leje nuk janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1 dhe 2.

-Çertifikatë përdorimi miratuar me Nr. 48, Prot.2963, datë 19/7/2021, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin "Objekte banimi e shërbimi 4 kate (3 njësi) me 1 kat

*podrum”, në adresën Potam, Bashkia Himarë, me leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 47 Nr. Prot. 1630, datë 02/06/2017 të Kryetarit të Bashkisë Himarë. Për këtë leje janë marrë parasysh pretendimet tuaja mbi gjetjen nr. 1, 2 dhe 3.*

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIM**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Sistemi aktual i komunikimit të institucionit nuk është eficient. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 20-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat e nevojshme për analizimin e shkaqeve të mos funksionimit të sistemit të komunikimit, si dhe të nxirren përgjegjësitë.

**1.2. Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masa për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Të hartohet procedurë e veçantë mbi mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve/ankesave dhe kryerjen e analizimit i tyre në zbatim të kërkesave të ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** NJAB funksionon duke pasur në përbërje të njësisë maksimumi dy punonjës dhe jo minimumi 3 persona duke përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. (*Trajtuar më hollësisht pika 1, faqe 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandimi:** NJAB, të marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi plotësimin e vendeve të NJAB, me minimumin 3 persona përfshirë drejtuesin e njësisë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nuk kemi plan auditimi dhe raport për vitin 2019, plani i auditimeve për vitin 2020 nuk është realizuar në masën 100% (për vitin 2020 janë parashikuar gjithsej 8 auditime dhe janë realizuar 5 auditime, ose në masën 62.5 %), ndërsa për vitin 2021 janë parashikuar në planin vjetor 3 auditime dhe akoma janë në proces auditimi. Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Himarë nuk ka kryer një analizë dhe vlerësim të riskut në hartimin e planit vjetor dhe atë strategjik të auditimit si dhe gjatë realizimit të auditimit nuk ka kryer etapat dhe procedurat e auditimit. (*Trajtuar më hollësisht pika 1, faqe 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1 Rekomandimi:** NJAB, gjatë realizimit të planit vjetor të auditimit të marrë parasysh analizimin dhe vlerësimin e riskut për përzgjedhjen e fushave të auditimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Himarë, nuk ka një vlerësim të riskut, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit. (*Trajtuar më hollësisht pika 1, faqe 24-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1 Rekomandimi:** NJAB, të hartojë program të veçantë mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e buxheteve vjetore rezulton se për vitin 2019, buxheti është realizuar në total në mase 66% ose nga 628,055 mijë lekë të programuara, është realizuar 416,642 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 349,236 mijë lekë ose 84 % të totalit të buxhetit dhe nga grandet specifike në vlerën 67,406 mijë lekë ose 16% e totalit, për vitin 2020, buxheti është realizuar në total në masë 66% ose nga 727,102 mijë të programuara, është realizuar 478,814 mijë lekë, nga të cilat nga grandit e të ardhurat e veta në vlerën 362,911 mijë lekë ose 76 % të totalit të buxhetit dhe nga grandet specifike në vlerën 115,903 mijë lekë ose 24% e totalit, u konstatua se nuk është analizuar dhe miratuar në Këshillin e Bashkisë, realizimi i tregueseve të buxhetit brenda datës 30 Qershor, në kundërshtim me kërkesat e nenit 46, të ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore.

-Nuk janë paguar detyrimet kreditorë të krijuara në vitin ushtrimor si dhe ato të trashëguara nga viteve paraardhëse, megjithëse në fund të vitit ushtrimor, kanë rezultuar burimet financiare të pa përdorura, konkretisht:

Në fund të vitit 2019, kanë rezultuar të pa përdorura fonde në shumën 143,526 mijë lekë të cilat janë transferuar për llogari të vitit 2020 dhe në fund të vitit 2020, kanë rezultuar të pa përdorura fonde në shumën 244,248 mijë lekë të cilat janë transferuar për llogari të vitit 2021, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 32, neni 65; UMF Nr. 2, datë 6.02.2012 për procedurat standard të zbatimit të buxhetit i ndryshuar pika 101; ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes Vendore, neni 46 (*Trajtuar më hollësisht pika 2, faqe 25-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditorë të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2020,, të llogarisë (401-408) ofurnitor e llogari të lidhura me toë, detyrime të tjera në llog (467) kreditorë të ndryshëm, paraqitet në vlerën 75,170,102 lekë, ose 9.6% e vlerës së buxhetit të vitit 2020 dhe vendime gjykate në vlerën 436,972 lekë.

Me datë 31.08.2021, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara, të llogarisë (401-408) ofurnitor e llogari të lidhura me toë, detyrime të tjera në llog (467) kreditorë të ndryshëm, paraqitet në vlerën 32,752,293 lekë, në totalin e tyre Vendime Gjykate janë për vlerën 436,972 lekë, sa më sipër mos likuidimi në kohë i detyrimeve të vitit paraardhës janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë nënenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 për financat e Vetëqeverisjes Vendore neni 40, 48(*Trajtuar më hollësisht pika 2, faqe 29-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **32,752,293 lekë**.

**Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkisë.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se llogaritë 210 Toka, troje, terrene, 211 Pyje Plantacione, 212 Ndërtesa e Konstruksione, 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore, 214 Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune, 215 Mjete transporti, janë të pa analizuar në kontabilitet, nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e

këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket këtyre llogarive për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin 10296 për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 6, Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko pikat 26-30, si dhe pikën 74, të UMF nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (Trajtuar më hollësisht pika 3, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë regjistrin e aktiveve të analizojë llogaritë e aktiveve për vlerat e tyre kontabël ku të specifikohen datat e hyrjes ose marrjes në dorëzim dhe personat përgjegjës me qëllim inventarizimin fizik të tyre.

### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020, inventarizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të pa Trupëzuara, Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe aktiveve Qarkulluese, nuk është kryer sipas kërkesave ligjore, nuk është i plotë, nuk është i saktë dhe as i dokumentuar me dokumente ligjorë e kontabël për rrjedhje; llogaritë e pasqyrave financiare, për këto llogari, nuk janë të besueshme, nuk janë të verifikuara me gjendjen fizike të tyre. Nga inventarizimi janë konstatuar mangët vlera inventariale për llogaritë 218 inventar ekonomik dhe 327 objekte inventarë në vlerën 472,698 lekë dhe jashtë përdorimit për llogaritë 215 mjete transporti, 218 inventar ekonomik dhe 327 objekte inventarë në vlerën 8,811,652 lekë, por nuk janë debituar personat përgjegjës për mungesat dhe nuk janë shkarkuar nga kontabiliteti dhe nuk ka veprim kontabël, për vlera jashtë përdorimit. Në këtë rast, përgatitja e pasqyrave financiare është në shkelje të kërkesave të Kreut II, neni 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrave financiare të ndryshuar, Kreu III, pika 30, të UMF nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe pikave; 74, 77, 83, 85/a, b, 86, 95 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht pika 3, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Himarë të ngriejë një grup pune me specialist të fushës, për inventarizimin e aktiveve të veta për të gjitha llogaritë kontabël dhe për Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara si 210 Toka, troje, terrene, 211 Pyje Plantacione, 212 Ndërtesa e Konstruksione, 213 Rrugë, rrjete, vepra ujore, 215 Mjete transporti, të bëhet verifikimi në terren të këtyre Aseteve.

Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2020, gjendja e llogarisë 468 Debitorë të ndryshëm, paraqitet me vlerë kontabël 137,747,839 lekë, *respektivisht:* -vlera 76,426,839 lekë, debitorë sipas rekomandimeve nga auditimet e KLSH-së e analizuar për 65 subjekte juridike dhe persona fizike, vlera 324,000 lekë, për vlerën e



gjobave të vendosura nga APP ndaj personave lidhur me procedurat e prokurimeve me tender dhe vlera 61,747,839 lekë, debitorë për detyrime për tatim taksat të subjekteve taksapagues lokalë. Gjithashtu veç këtyre debitorëve, nuk janë kontabilizuar dhe raportuar në pasqyrat financiare vlera për 67 debitorëve të tjerë në shumën totale 83,385,955 lekë, nga e cila 13 raste të gjobave të vendosura nga APPP për shumën totale 3,240,000 lekë dhe 54 subjekte fizikë dhe juridikë të tjerë sipas rekomandimeve nga auditimet e KLSH-së, nuk janë kontabilizuar detyrimet sipas rekomandimeve të KLSH-së, për periudhën 2017-30.10.2019, në vlerën 29,030,035 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme, Kreu III. Për procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitet e qeverisjes së përgjithshme (Trajtuar më hollësisht pika 3, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe pasqyrat financiare të vitit 2020, detyrimet debitorë të pa kontabilizuar për vlerën 112,415,990 lekë.

Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë pa shpresë arkëtimi.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2020, llogaria 466 *ōKreditorë për mjetet në ruajtje* në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 21,037,938 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesari, kjo llogari është e analizuar për 79 objekte për vlerën 20,859,786 lekë, pra me diferencë për vlerën **178,152 lekë**, pasqyruar më pak në llogaritë e fund vitit 2020 se sa janë me dokumente sipas subjekteve dhe objekteve të ngurtësuar për të cilat janë ngurtësuar fondet në formë garancie. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde në 51 raste për vlerën 11,445,558 lekë i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018 të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Himarë nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për zhbllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik, veprime në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitet e Qeverisjes së Përgjithshme, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitit i ndryshuar, Kap. II, pika 10 (Trajtuar më hollësisht pika 3, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën prej 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

#### **Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave për detyrimet ndaj subjekteve të kryera në vitin 2021, u konstatua se disa fatura të paguara gjatë vitit 2021 për shërbime nga të tretët që i përkasin vitit 2020, nuk janë kontabilizuar si detyrim i lindur në kredi të llogarisë 467 *ōKreditorë të ndryshëm*, për 5 raste në vlerën 16,378,087 lekë.

Moskryerja e veprimeve kontabël me faturat e mbërritura për blerje mallrash e shërbimesh dhe kryerja investimesh e si rrjedhojë mos përfshirja e vlerës së detyrimeve që lindin prej tyre dhe të tjera në bilancin vitit ushtrimor, ka sjellë mos evidentimin në kontabilitet të gjendjes reale të faturave të pa likuiduara në fund të vitit ushtrimor 2020, për vlerën

**16,378,087 lekë** duke sjellë një pasaktësi dhe informacion kontabël jo real në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2020 për detyrimet e bashkisë ndaj të tretëve, veprime në kundërshtim me Udhëzimet e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeo kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32. Aneksi 1 ÷ Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publiko Pika 3.3/c.d ÷ Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të

tretëve (klasa 4)ö. *(Trajtuar më hollësisht pika 3, faqe 39-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

#### **Në vijimësi.**

**12. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Himarë ka lëshuar çertifikatën e përdorimit miratuar me vendimin nr. 7, nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin ÷ Njësi akomoduese, hoteleri dhe bujtina 2, 3, dhe 4 kate dhe 3 kate nëntokë, pishinëo, në adresën Potam, Bashkia Himarë, me zhvillues öbö sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me nr.8 prot. datë 23.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe rishikuar me Vendim Nr. 104 Nr. Prot. 3369, datë 30/10/2017.

**Nga verifikimi në terren objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar** me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, kjo e vërtetuar edhe me dokumentacion fotografik vihet re se kati tarracë , i cili duhej të kishte vetëm kafazin e shkallëve me dimensione 380x720 cm, sipas projektit të miratuar, në terren ka ndërtuar një sipërfaqe më të madhe, në kundërshtim me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeo, IMT Bashkia Himarë ka anashkaluar përgjegjësitë e veta, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar me Vendim nr. 7 datë 11.02.2020.

dhe është paraqitur mandati i R. Bank me datë 10.02.2020 me vlerë 909.086 lekë.

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj certifikate përdorimi janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave, me qëllim përfitimin e padrejtë të zhvilluesit öBö shpk *(Trajtuar më hollësisht pika 5, faqe 161-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeo, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues öBö SHPK dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.*

#### **Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Himarë ka lëshuar çertifikatën e përdorimit miratuar me vendimin Nr. 70, Prot.1371/1, datë 16/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin ÷ Shtesë 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 katö, në adresën Livadh, Bashkia Himarë, me zhvillues E.K. dhe R.M..

**Nga verifikimi në terren objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar me Vendim nr.76, prot 2862, datë 05/10/2018 të Kryetarit të Bashkisë Himarë, kjo e vërtetuar edhe me dokumentacion fotografik vihet re se në katin tarracë në kuotën +9.45 nuk duhej të kishte dalje në tarracë dhe mbulim kafazi shkallësh, duke shkelur përcaktimet e projektit të miratuar, në kundërshtim kjo me Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, **IMT Bashkia Himarë ka anashkaluar përgjegjësitë e veta**, duke mos konstatuar devijimin nga leja e miratuar me Vendim nr.76, prot 2862, datë 05/10/2018.**

Sa më sipër, përmes miratimit të kësaj certifikate përdorimi janë shkelur dispozitat ligjore në fuqi për kontrollin e zhvillimit të territorit, zhvillimit të kontrolluar urban të tij, janë cënuar standardet higjeno-sanitare, mjedisore dhe të sigurisë së ndërtesave, me qëllim përfitimin e padrejtë të zhvilluesit òE.K. R.M.ò shpk. (*Trajtuar më hollësisht pika 5, faqe 162-164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1 Rekomandimi:** Bashkia Himarë, Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dy struktura përgjegjëse për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme, por edhe kontrollin e zbatimit të objekteve të ndërtuara me leje apo në shkelje të saj, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga ligji nr.107/2014 datë 31.07.2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*” të ndryshuar, dhe ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 òPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, si dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015 òPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò të ndryshuar, të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për ndëshkimin e subjektit zhvillues E.K. R.M. dhe trajtimin e ndërtimit të kundërligjshëm sipas referimit ligjor të sipërcituar, deri në kthimin e ligjshmërisë në fazën fillestare.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

#### **C/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Shërbimin Civil:**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, germat (b, c, ç) e nenin 58-òLlojet e masave disiplinoreò, të ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin civilò, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Himarë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSHòsë, për periudhën 01.10.2019 deri më 30.5.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, si më poshtë:**

#### **C/I “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë deri në Largim nga Shërbimi Civil”**

**1. Z. L.M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social. Për shkeljet e konstatuara konkretisht:**

- Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa për vitet 2019, 2020 dhe 10/mujori 2021, mungesë të ardhurash për Bashkinë në vlerën 287,712 mijë lekë.
- Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga të ardhurat nga dhënia me qira e Aseteve për vendosjen e antenave të telefonisë celulare për periudhën objekt auditimi në vlerën 5,375,850 lekë.
- Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e dhënies së licencës

për tregtimin e naftës gazit në mospërputhje me dispozitat ligjor në vlerën 8,000,000 lekë.

- Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 3,851,173 lekë.
- Për llogaritjen e gabuar të taksës së ndikimi në infrastrukturë për subjektin òBò sh.p.k. Vlera e llogaritur nga Bashkia Himarë me mungesë prej 4,375,038.02 lekë përbën arkëtim të munguar si rrjedhojë dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë
- Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit òBò me pasojë të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën 1,097,086.48 lekë
- Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit òEò me pasojë të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën prej 8,789,727.64 lekë.
- Në lidhje me vlerësimin e raporti financiarë të vitit 2020, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 *òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò* neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, *òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò*; Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 *òPër miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyreò* (me ndryshime) me Vendimin e KM nr.25, datë 20.01.2001; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 *òPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publikò*; Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 *òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò* (Trajtuar më hollësisht pika 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## 2. Z. K.K., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave

### Për shkeljet e konstatuara konkretisht:

- Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa për vitet 2019, 2020 dhe 10/mujori 2021, mungesë të ardhurash për Bashkinë në vlerën 287,712 mijë lekë.
- Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga të ardhurat nga dhënia me qira e Aseteve për vendosjen e antenave të telefonisë celulare për periudhën objekt auditimi në vlerën 5,375,850 lekë.
- Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e dhënies së licencës për tregtimin e naftës gazit në mospërputhje me dispozitat ligjor në vlerën 8,000,000 lekë.
- Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 3,851,173 lekë.
- Në lidhje me vlerësimin e raporti financiarë të vitit 2020, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 *òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò* neni 6; nenet 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, *òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò*; Vendimin e KM nr. 248, datë 10.04.1998 *òPër miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyreò* (me ndryshime) me Vendimin e KM nr.25, datë 20.01.2001; Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.11.2011 *òPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publikò*; Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 *òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò* (Trajtuar më hollësisht pika 3 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Në cilësinë e anëtarit të njësive së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e

prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 të Kualifikimi ofertuesve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (me ndryshime), neni 26 të Kontrata për punë publike, pika (5); neni 61 të Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika (2), paragrafi (2), konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje Makine me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 4,125,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam*", me vlerë të prokuruar 34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Qendrës Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë

### 3. Znj. B.B., me detyrë Nënkyetare e Bashkisë

#### Për shkeljet e konstatuara

Në cilësinë e Titullarit të autoritetit Kontraktor dhe konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndriçim i rrugës Dhrale*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 6,466,820 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë "GJ. & A.ö, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publik
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Përmirësim i sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë*", me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë "J.SH.ö, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar OE të radhës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publik
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë Xhepe Bolenë*", me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Shërbimi i pastrimit për zonat turistike*", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë ku për këtë

- procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
  - Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë òE.D.ò, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò
  - Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë òE.ò, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò
  - Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Rikonstruktion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Piqeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë òA.ò, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò.
  - Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Rikonstruktion i rrugës Stefanel segmenti 1-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë òS.ò, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò.
  - Në procedurën e prokurimit me objekt: objekt "*Rikonstruktion i ujësjiellësit Kallarati*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë òG.A. KONSTRUKSIONò, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò.
  - Në procedurën e prokurimit me objekt: "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë ku për këtë procedurë prokurimi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës si dhe kualifikimi i shoqërisë òCò, **nuk** është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte propozuar

Titullarit të AK ribërjen e procedurës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *oPër prokurimin publiko*.

Për mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 *oKualifikimi ofertuesveo* të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *oPër prokurimin publiko* (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *oPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 oPër miratimin e rregullave të prokurimit publiko* (me ndryshime), neni 26 *oKontrata për punë publikeo*, pika (5); neni 61 *oHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitö*, pika (2), paragrafi (2).

Për vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) *oAnulimi një procedure prokurimio*, pika (1), germa (ç); neni (46) *oKualifikimi i ofertuesveo*, pika (1); neni (53) *oShqyrtimi ofertaveo*, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) *oKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseo*, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *oPër prokurimin publiko* (me ndryshime) dhe neni (66) *oShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveo*, pika (3); neni (67) *oKlasifikimi ofertave*; neni (68) *oRaporti përmbledhësö*; Kreu (VIII) *oKushte të përgjithshme për zbatimö*; neni (73) *oMungesa e konkurrencësö*, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *oPër miratimin e rregullave të prokurimit publiko*, (me ndryshime).

#### 4. Z. G.S., me detyrë drejtues i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

##### *Për shkeljet e konstatuara:*

- Për llogaritjen e gabuar të taksës së ndikimi në infrastrukturë për subjektin *oBö sh.p.k.* Vlera e llogaritur nga Bashkia Himarë me mungesë prej 4,375,038.02 lekë përbën arkëtim të munguar si rrjedhojë dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë.
- Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin *oNjësi akomoduese, hoteleri dhe bujtina 2, 3, dhe 4 kate dhe 3 kate nëntokë, pishinëö*, në adresën Potam, Bashkia Himarë, me zhvillues *oBö sh.p.k.* me leje ndërtimi miratuar me nr.8 prot. datë 23.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe rishikuar me Vendim Nr. 104 Nr. Prot. 3369, datë 30/10/2017. Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit *oBö* me pasojë të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën 1,097,086.48 lekë.
- Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Nr. 95, Prot. 3004/1, datë 28/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore për objektin *oObjekt 2 kat mbi toke dhe 1 kat nëntokë, hotel, restorant, pishinëö*, në adresën Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me zhvillues *oEö sh.p.k.* Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit *oEö* me pasojë të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën prej 8,789,727.64 lekë.
- Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 70, Prot.1371/1, datë 16/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin *oShtesë 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 katö*, në adresën Livadh, Bashkia Himarë, me zhvillues E.K. R.M.

Certifikatat e përdorimit janë miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 *oPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritö* i ndryshuar , pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në

mungesë të dokumentacionit të nevojshëm si dhe përlllogaritja e gabuar të detyrimeve të subjektit.

#### 5. Z. F.B., me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi

##### Për shkeljet e konstatuara:

- Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Për llogaritjen e gabuar të taksës së ndikimi në infrastrukturë për subjektin òBò sh.p.k. Vlera e llogaritur nga Bashkia Himarë me mungesë prej 4,375,038.02 lekë përbën arkëtim të munguar si rrjedhojë dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë.
- Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 7 nr. Prot. 410, datë 11/02/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin òNjësi akomoduese, hoteleri dhe bujtina 2, 3, dhe 4 kate dhe 3 kate nëntokë, pishinë, në adresën Potam, Bashkia Himarë, me zhvillues òBò sh.p.k, me leje ndërtimi miratuar me nr.8 prot. datë 23.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe rishikuar me Vendim Nr. 104 Nr. Prot. 3369, datë 30/10/2017. Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit òBò me pasojë të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën 1,097,086.48 lekë.
- Për miratimin e certifikatës së përdorimit me Nr. 95, Prot. 3004/1, datë 28/10/2020, të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore për objektin òObjekt 2 kat mbi toke dhe 1 kat nëntokë, hotel, restorant, pishinë, në adresën Gjilekë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me zhvillues òEò sh.p.k. Për përlllogaritjen e gabuar të detyrimeve të subjektit òEò me pasojë të ardhura të munguara me dëm për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën prej 8,789,727.64 lekë.
- Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim Nr. 70, Prot.1371/1, datë 16/07/2020 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objektin òShtesë 2 kate ne objekt ekzistues shërbimi 1 katò, në adresën Livadh, Bashkia Himarë, me zhvillues E.K. R.M.

Certifikatat e përdorimit janë miratuar në kundërshtim me përcaktimet ligjore, konkretisht Neni 27 dhe neni 27/2 i VKM Nr.408, datë 13.05.2015 òPër miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territoritò i ndryshuar, pasi certifikata e përdorimit është dorëzuar në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm si dhe përlllogaritja e gabuar të detyrimeve të subjektit.

##### C/2 “Vërejtje deri në pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”

#### 6. Z.E.M., me detyrë Specialist Gjeodet

##### Për shkeljet e konstatuara:

Në cilësinë e Anëtarit të NHDJT, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje Makine” me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 4,125,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje Shkollash", me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam”, me vlerë të prokuruar 34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Qendrës Tërbar", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburanti”, me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse", me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,



- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e rrugëve rurale*", me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Përmirësim I sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë*", me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë*", me vlerë të prokuruar 41,666,379 lekë dhe vlerë kontrate 40,613,118 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Kopshteve*", me vlerë të prokuruar 4,164,160 lekë dhe vlerë kontrate 3,911,660 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë XHepe Bolenë*", me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Shërbimi i pastrimit për zonat turistike*", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 82,922,375 lekë dhe vlerë kontrate 78,282,827 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Piqeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Stefanel segmenti I-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujësjiellësit Kallarati*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 të Kualifikimi ofertuesve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (me ndryshime), neni 26 të Kontrata për punë publike, pika (5); neni 61 të Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika (2), paragrafi (2).

**7. Znj.B.R.,** me detyrë Specialist i Regjistrimit dhe Procedurave

Për shkeljet e konstatuara:

Në cilësinë e anëtarit të NHDJT, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: *"Blerje Makine"* me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 4,125,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Blerje Karburant"*, me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 të Kualifikimi ofertuesve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (me ndryshime), neni 26 të Kontrata për punë publike, pika (5); neni 61 të Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika (2), paragrafi (2).

Në cilësinë e anëtarit të KVO, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje Shkollash"*, me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam"*, me vlerë të prokuruar 34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Qendrës Tërbcac"*, me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse"*, me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje e rrugëve rurale"*, me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje Shkollash"*, me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Ndërtimi i pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil"*, me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse"*, me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje e rrugëve rurale"*, me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Mirëmbajtje Shkollash"*, me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Përmirësim I sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë"*, me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë"*, me vlerë të prokuruar 41,666,379 lekë dhe vlerë kontrate 40,613,118 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i Kopshteve"*, me vlerë të prokuruar 4,164,160 lekë dhe vlerë kontrate 3,911,660 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil"*, me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë XHepe Bolenë"*, me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Shërbimi i pastrimit për zonat turistike*", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 82,922,375 lekë dhe vlerë kontrate 78,282,827 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Pigeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Stefanel segmenti 1-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujësjiellësit Kallarati*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Urrës në lagjen Lenga Vranisht*", me vlerë të prokuruar 10,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 9,140,533 lekë

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) *ōAnulimi një procedure prokurimiō*, pika (1), germa (ç); neni (46) *ōKualifikimi i ofertuesveō*, pika (1); neni (53) *ōShqyrtimi ofertaveō*, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) *ōKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseō*, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *ōPër prokurimin publikō* (me ndryshime) dhe neni (66) *ōShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveō*, pika (3); neni (67) *ōKlasifikimi ofertave*; neni (68) *ōRaporti përmbledhësō*; Kreu (VIII) *ōKushte të përgjithshme për zbatimō*; neni (73) *ōMungesa e konkurrencësō*, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *ōPër miratimin e rregullave të prokurimit publikō*, (me ndryshime).

#### **8. Z. O.V., me detyrë Specialist i Prokurimeve**

##### *Për shkeljet e konstatuara:*

Në cilësinë e anëtarit të NHDJT, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam*", me vlerë të prokuruar 34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Qendrës Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse*", me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e rrugëve rurale*", me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndriçim i rrugës Dhrale*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 6,466,820 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Përmirësim I sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë*", me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë*", me vlerë të prokuruar 41,666,379 lekë dhe vlerë kontrate 40,613,118 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Kopshteve*", me vlerë të prokuruar 4,164,160 lekë dhe vlerë kontrate 3,911,660 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë Xhepe Bolenë*", me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Urrës në lagjen Lenga Vranisht*", me vlerë të prokuruar 10,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 9,140,533 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Shërbimi i pastrimit për zonat turistike*", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 82,922,375 lekë dhe vlerë kontrate 78,282,827 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Piqeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Stefanel segmenti 1-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujësjiellësit Kallarar*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 të Kualifikimi ofertuesve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik (me ndryshime), neni 26 të Kontrata për punë publike, pika (5); neni 61 të Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika (2), paragrafi (2).

**9. Z. U.D.**, me detyrë Specialist i Buxhetit

Për shkeljet e konstatuara:

Në cilësinë e anëtarit të NHDJT, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse*", me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e rrugëve rurale*", me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndriçim i rrugës Dhrale*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 6,466,820 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Përmirësim I sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë*", me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Kopshteve*", me vlerë të prokuruar 4,164,160 lekë dhe vlerë kontrate 3,911,660 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë Xhepe Bolenë*", me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Urrës në lagjen Lenga Vranisht*", me vlerë të prokuruar 10,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 9,140,533 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Shërbimi i pastrimit për zonat turistike*", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 82,922,375 lekë dhe vlerë kontrate 78,282,827 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Piqeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Stefanel segmenti 1-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujësjellësit Kallarati*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 ÷ Kualifikimi ofertuesve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷ Për prokurimin publik (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (me ndryshime),

neni 26 òKontrata për punë publikeö, pika (5); neni 61 òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitö, pika (2), paragrafi (2).

-Në cilësinë e anëtarit të KVO, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: òBlerje Makineö me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 4,125,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam*", me vlerë të prokuruar 34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Qendrës Tërbar*", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje karburanti*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë*", me vlerë të prokuruar 41,666,379 lekë dhe vlerë kontrate 40,613,118 lekë

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) òAnulimi një procedure prokurimiö, pika (1), germa (ç); neni (46) òKualifikimi i ofertuesveö, pika (1); neni (53) òShqyrtimi ofertaveö, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) òKriteret e përcaktimit të ofertës fitueseö, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikö (me ndryshime) dhe neni (66) òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveö, pika (3); neni (67) òKlasifikimi ofertave; neni (68) òRaporti përmbledhësö; Kreu (VIII) òKushte të përgjithshme për zbatimö; neni (73) òMungesa e konkurrencësö, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö, (me ndryshime).

10.Z. A.G., me detyrë Specialist Inxhinier Ndërtimi

Për shkeljet e konstatuara:

Në cilësinë e Kryetarit të NHDJT, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndriçim i rrugës Dhrale*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 6,466,820 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Urrës në lagjen Lenga Vranisht*", me vlerë të prokuruar 10,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 9,140,533 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjetësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me neni 46 òKualifikimi ofertuesveö të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikö (me ndryshime); neni 15; 22 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö (me ndryshime),

neni 26 ÷Kontrata për punë publike, pika (5); neni 61 ÷Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika (2), paragrafi (2).

Në cilësinë e anëtarit të KVO, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) ÷Anulimi një procedure prokurimi, pika (1), germa (ç); neni (46) ÷Kualifikimi i ofertuesve, pika (1); neni (53) ÷Shqyrtimi ofertave, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) ÷Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik (me ndryshime) dhe neni (66) ÷Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika (3); neni (67) ÷Klasifikimi ofertave; neni (68) ÷Raporti përmbledhës; Kreu (VIII) ÷Kushte të përgjithshme për zbatim; neni (73) ÷Mungesa e konkurrencës, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, (me ndryshime).

**11. Z. A.B.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mirëmbajtjes

Për shkeljet e konstatuara:

Në cilësinë e Kryetarit të KVO, në procedura, konkretisht:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: ÷Blerje Makineë me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 4,125,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,133,768 lekë dhe vlerë kontrate 3,590,740 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimeve të ujerave të zeza dhe stacioni i pompimit, Lagja Potam*", me vlerë të prokuruar 34,868,272 lekë dhe vlerë kontrate 34,160,214 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Qendrës Tërbar*", me vlerë të prokuruar 4,166,667 lekë dhe vlerë kontrate 3,996,950 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje karburanti*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse*", me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e rrugëve rurale*", me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtimi i pusit të ri për ujë të pijshëm dhe instalim, Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 3,750,000 lekë dhe vlerë kontrate 3,715,000 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndriçim i rrugës Dhrale*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 6,466,820 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse*", me vlerë të prokuruar 8,345,612 lekë dhe vlerë kontrate 7,999,972 lekë,
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e rrugëve rurale*", me vlerë të prokuruar 4,992,053 lekë dhe vlerë kontrate 4,917,350 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje Shkollash*", me vlerë të prokuruar 4,166,118 lekë dhe vlerë kontrate 3,749,560 lekë

- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Përmirësim I sistemit të furnizimit me ujë të zonave Dhërmi, faza II, Gjilekë, Kondraq dhe Palasë*", me vlerë të prokuruar 166,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 164,298,352 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i godinës aktuale të Bashkisë*", me vlerë të prokuruar 41,666,379 lekë dhe vlerë kontrate 40,613,118 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Kopshteve*", me vlerë të prokuruar 4,164,160 lekë dhe vlerë kontrate 3,911,660 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i qendrës dhe rrugëve lidhëse Fshati Shën Vasil*", me vlerë të prokuruar 6,666,667 lekë dhe vlerë kontrate 5,350,140 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujerave të zeza dhe gropës septike Hundë Xhepe Bolenë*", me vlerë të prokuruar 4,162,186 lekë dhe vlerë kontrate 3,797,100 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Shërbimi i pastrimit për zonat turistike*", me vlerë të prokuruar 7,771,782 lekë dhe vlerë kontrate 7,573,020 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 82,922,375 lekë dhe vlerë kontrate 78,282,827 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi rural "Rrjeti kryesor i shpërndarjes në zonën Kuç"*", me vlerë të prokuruar 22,500,000 lekë dhe vlerë kontrate 22,457,670 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje Karburant*", me vlerë të prokuruar 8,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 8,333,333 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës dhe zgjerim i varrezave Piqeras*", me vlerë të prokuruar 5,825,642 lekë dhe vlerë kontrate 5,643,890 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i rrugës Stefanel segmenti I-2*", me vlerë të prokuruar 48,333,333 lekë dhe vlerë kontrate 48,092,585 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ujësjiellësit Kallarati*", me vlerë të prokuruar 8,179,354 lekë dhe vlerë kontrate 8,152,700 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ujësjiellësi i fshatit Tërbaç*", me vlerë të prokuruar 16,461,437 lekë dhe vlerë kontrate 16,444,444 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i Urrës në lagjen Lenga Vranisht*", me vlerë të prokuruar 10,000,000 lekë dhe vlerë kontrate 9,140,533 lekë
- Në procedurën e prokurimit me objekt "*Mirëmbajtje e kanaleve vaditëse dhe kulluese*", me vlerë të prokuruar 7,460,551 lekë dhe vlerë kontrate 7,222,222 lekë

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht me neni (24) *Anulimi një procedure prokurimi*, pika (1), germa (ç); neni (46) *Kualifikimi i ofertuesve*, pika (1); neni (53) *Shqyrtimi ofertave*, pika (3) dhe (5), germa (a); (c); neni (55) *Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*, pika (1), germa (a), të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *Për prokurimin publik* (me ndryshime) dhe neni (66) *Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, pika (3); neni (67) *Klasifikimi ofertave*; neni (68) *Raporti përmbledhës*; Kreu (VIII) *Kushte të përgjithshme për zbatim*; neni (73) *Mungesa e konkurrencës*, pika (1) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*, (me ndryshime).

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



